



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

**Informimi në gjuhët e pakicave
dhe përmbajtjet mbi kulturën dhe
tradiçen e popujve pakicë
në Shërbimin publik në Mal të Zi**

Monitorimi i të drejtave të njeriut në Mal të Zi

Podgoricë, 2009.



Fondacioni
“Instituti për Shoqërinë e hapur”



Iniciativa e të Rinjve
për të Drejtat e Njeriut – Mali i Zi



Fondi për pakica

MONITORIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË MAL TË ZI

**INFORMIMI NË GJUHËT E PAKICAVE
DHE PËRMBAJTJET MBI KULTURËN
DHE TRADITËN E POPUJVE PAKICË NË
SHËRBIMIN PUBLIK NË MAL TË ZI**

Podgoricë
Nëntor 2009

Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Mali i Zi
Nëntor 2009

Për botuesin
Boris Raoniq

Autorë të raportit
Boris Raoniq
Edina Hasanaga Çobaj
Millan Radoviq

Analiza juridike
Azra Jasaviq

Lektura dhe korrektura
Dimitrov Popoviq

Përkthimi
Leon Gjokaj

Dizajni dhe përgatitja për botim
Nikolla Milenkoviq

Shtypi
AP PRINT, Podgoricë
Tirazhi: 200

CIP – Kategorizimi në publikim,
Biblioteka Qendrore Popullore e Malit të Zi, Cetinjë
323.15:342.727(497.16)
341.231.14(497.16)
Raoniq, Boris
Informimi në gjuhët e pakicave dhe përmbajtjet
mbi kulturën dhe traditën e popujve pakicë
në shërbimet publike në Mal të Zi / [autor të raportit Boris
Raoniq, Edina Hasanaga Çobaj, Millan Radoviq
përkthimi Jellena Vukošllavoviq] . – Podgoricë :
Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, 2009
(Podgoricë : Llutrex) . - 38, 43 faqe. ë 25 cm
Titulli i përkthimit: Information on
Minority Languages and Contents on Culture and
Tradition of Minority Population on Public Services
in Montenegro. – Teksti në gjuhën malazeze dhe gjuhën angleze.
- Të dhënat për autorët janë marrë nga impresum.
- Të dy botimet janë shtypur në drejtime të kundërta
- Tirazhi 400. – Të dhënat krahas tekstit. -
Bibliografi a: faqe. 36-37 Bibliography: faqe.
41-42.
ISBN 978-9940-9015-4-7
1. Hasanaga-Çobaj, Edina [autore] 2. Radoviq, Milan [autor]
a) E drejta në informim – Pakicat nacionale -
Mali i Zi b) Të drejtat e Njeriut- Mali i Zi
COBISS.CG-ID 14968336

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
I Analiza juridike.....	7
II Shqiptarët	13
III Boshnjakët dhe myslimanët	23
IV Kroatët	29
V Romët	35
VI Serbët	41
VII Zbulimet e përgjithshme të sondazhit/hulumtimit.....	45
VIII Bibliografia	46

Hyrje

Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Mal të Zi (YIHR) ka realizuar sondazhin mbi të drejtat e popujve pakicë në informim në gjuhën amtare në periudhën prej marsit deri në nëntor të vitit. Sondazhi që ka realizuar ekipi prej pesë anëtarësh i Inicativës ka pasur për qëllim të bëjë analizën dhe të marrë informacione të sakta për respektimin e nenit 12 të Ligjit për të drejtat e pakicave dhe liritë.¹ Me këtë nen u garantohet e drejta pakicave në, numrin adekuat të orëve me qëllim të emitimit të programit informativ, kulturor, arsimor, sportiv dhe argëtues në gjuhët e pakicave dhe pjesëtarëve të tyre, si dhe përmbajtjeve programore që kanë të bëjë me jetën, traditën dhe kulturën e pakicave dhe sigurimin e mjeteve financiare për financimin e këtyre përmbajtjeve programore. Përmbajtjet që kanë të bëjnë me jetën, kulturën dhe identitetin e pakicave emitohen së paku njëherë në muaj, në gjuhën zyrtare, përmes shërbimeve publike² Ligji i njëjtë definon pakicat si në vijim: “Pakica, në bazë të këtij Ligji, është secili grup i shtetasve të Republikës, numerikisht më i vogël se popullata mbisunduese, e cila ka karakteristika të përbashkëta etnike, gjuhësore dhe fetare”.³ Në Guidën (Udhërrëfyesin) për OJQ-të e Evropës Juglindore pakicat kanë të bëjnë me “grupet jo dominuese etnike, nacionale, fetare dhe gjuhësore në shtet, pjesëtarët e së cilës tregojnë, ose vetëm nënkuptojnë, ndjenjën e solidaritetit në drejtim të ruajtjes së kulturës, traditës, fesë dhe gjuhës së tyre”.⁴

Në Mal të Zi ka 18 shërbime radio-difuzive dhe këto janë: Radio e Malit të Zi, Televizioni i Malit të Zi, Radio Tivari, Radio Bijello Pole, Radio Berane, Televizioni Budva, Radio Tivati, Radio Kotorri, Radio Plevla, Televizioni Plevla, Radio Herceg Novi, Radio Nikshiq, Televizioni Nikshiq, Radio Cetinja, Radio Danillovgradi, Radio Rozhaja, Radio Andrijevisa dhe Radio Ulqini.⁵

Të dhënat në sondazh janë grumbulluar duke shfrytëzuar me tepër teknika metodologjike, kurse vetë sondazhi ka pasur disa faza. Teknikat të cilat janë shfrytëzuar gjatë sondazhit janë: analiza e legjisllacionit, grupet e fokusit, pyetësorët dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Faza e parë ka përfshirë analizën e legjisllacionit dhe bisedat në grupe në

1 *Ligji mbi të Drejtat e pakicave dhe Liritë, shiko faqen e internetit të Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave <http://www.gov.me/minmanj/vijesti.php?akcija=vijesti&id=13716> i vizituar më 20 shtator 2009*

2 Neni 12 i Ligjit për të Drejtat e Pakicave dhe Liritë, shiko lart 1

3 Neni 2 i Ligjit për të Drejtat e Pakicave dhe Liritë, shiko lart

4 Përfaqësimi i të Drejtave të Pakicave, Guida (Udhërrëfyesi) për OJQ-të e Evropës Juglindore, botues Dragutin Çiçak, shtypur në Bosnjë e Hercegovinë, botimi i reviduar, janar 2008, faqe 13

5 Guida (Udhërrëfyesi) nëpër media në Mal të Zi, Ministria e Kulturës, Sportit dhe Medieve, Podgoricë 2006

kuadër të grupeve të fokusit me pjesëtarët nga rrahët e popujve pakicë. Janë organizuar pesë grupe të fokusit, në Podgoricë (me pjesëtarët e kombit rom), në Ulqin (me pjesëtarët kombit shqiptar), Plevlë (me përfaqësuesit e kombit serb), Rozhajë (me përfaqësuesit e kombit mysliman dhe boshnjak) dhe në Kotorr (me pjesëtarët e kombit kroat).

Fokus grupet e realizuara kanë tubuar tetë deri dymbëdhjetë pjesëmarrës të strukturave të balancuara për nga mosha, seksi dhe arsimimi. Faza e dytë, monitorimi ka qenë plotësimi i pyetësorit me politikanë, aktivistë të OJQ-ve të cilët merren me të drejtat e pakicave dhe përfaqësuesit e Këshillave Nacionale të Popujve Pakicë. Numri i pyetësorëve të realizuar është 43. Përmes pyetësorit unik kanë pasur rastin të shprehin mendimin e vet, vlerësojnë punën e shërbimeve publike dhe të ofrojnë rekomandime të caktuara.

Faza e tretë e monitorimit ka përfshirë intervistën me drejtorët dhe redaktorët e shërbimeve publike nacionale dhe lokale, të gazetarëve me ndikim më të madh dhe ekspertëve të kësaj fushe. Në kuadër të kësaj faze janë realizuar 25 intervista.

YIHR ka realizuar këtë sondazh me qëllim që në kontekstin e integriteteve evropiane dhe detyrimeve të Malit të Zi, të afirmojë të drejtat dhe integrimin e popujve pakicë në shoqëri e të tregojë se sa respektohet e drejta e informimit në gjuhën e vet, si një nga të drejtat me të cilën ruhet identiteti dhe ndalohet asimilimi i dhunshëm i pjesëtarëve të popujve pakicë.

Duke marrë parasysh specifikën, multikulturalitetin dhe shumë kombësinë e Malit të Zi edhe shërbimet publike mund të luajnë rol të rëndësishëm në rritjen dhe zgjerimin e kufijve të tolerancës dhe copëtimin e distancave etnike që shfaqen. Këtë rol e kanë vënë re edhe krijuesit e kushtetutës dhe ligjvënësit, çfarë e vërteton edhe fakti se ata kanë shkuar edhe një hap më tej, ndaj përmes ligjshmërisë vendore kanë detyruar shërbimet publike për respektimin e rregullave ndërkombëtare, zhvillimin e tolerancës dhe respektimin e identitetit të popujve pakicë.

Kështu Kushtetuta e Malit të Zi garanton të drejtën e informimit në gjuhën e vet me nenin 79, pika 11, ndërsa ligji për Të Drejtat dhe Liritë e Pakicave, krahas garantimit të drejtës së informimit në gjuhën e vet, detyron shërbimet publike dhe themeluesit e tyre për emitimin e përmbajtjeve që garantojnë ruajtjen e identitetit.

Ekipi hulumtues YIHR falënderon të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e vet me marrjen pjesë në këtë hulumtim, falënderojmë zyrat rajonale të YIHR dhe FOSI ROM për mbështetjen e shumëfishtë që na kanë dhënë si dhe Fondin për pakica i cili ka mundësuar që ky raport të perkthehet në gjuhën shqipe.

I Analiza juridike

Dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara

Në nenin 9 të Kushtetutës së Malit të Zi⁶ është përcaktuar se kontratat ndërkombëtare të vërtetuara dhe të shpallura dhe rregullat e përgjithshme të pranuar të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse të rendit juridik si dhe kanë përparësi ndaj legjislacionit vendas dhe zbatohen drejtpërdrejt kur marrëdhëniet i rregullojnë ndrysh nga legjislacioni i brendshëm.

Akti më i rëndësishëm juridik i Këshillit të Evropës që merret imtësisht me këtë problem është Konventa për mbrojtjen e pakicave kombëtare⁷, e cila me nenin 9 përcakton të drejtën e marrjes dhe transmetimit të informimit në gjuhën e pakicës.

Dispozita e nenit 9 të kësaj Konvente flasin për të drejtat në marrjen dhe transmetimin e informacioneve dhe ideve në gjuhën e pakicave. Me dispozita konstatohet që kjo e drejtë duhet të realizohet pa u përzier dhe pa u penguar nga organet shtetërore. Në këtë kuptim, precizohet konkretisht që shteti të mos pengojë themelimin dhe përdorimin e medieve të shtypura. Përcaktohet detyrimi i shtetit që të miratojë emetimin e programeve të radios dhe të televizionit pa diskriminim dhe në bazë të kriterëve objektive. Shteti ngarkohet gjithashtu për marrjen e masave të përshtatshme, mes të cilave edhe ato financiare për zhvillimin e politikës së caktuar që popujve pakicë t'ua lehtësojë qasjen ndaj informimit publik.

Sipas nenit 2 të Dokumentit Evropian për gjuhët rajonale ose të pakicave⁸ çdo vend me rastin e ratifikimit, ka mundësi të marrë vetëm disa nga detyrimet e përcaktuara në Dokument. Sipas nenit 2, pika 2 të Dokumentit të Evropës, në kuadër të informimit publik, Mali i Zi pranon zbatimin e nenit 11, pika 1 a (III), b (II), c (II), d, e (I), f (II), pika 2, pika 3 dhe si gjuhë të pakicave ka njohur gjuhën shqipe dhe rome.

6 Kushtetuta e Malit të Zi, sajti i qeverisë i “Gazetës zyrtare të Malit të Zi” <http://www.sllrcg.co.me/001-2007.pdf>, i vendosur me datën 15 shtator 2009.

7 Konventa për mbrojtjen e Pakicave kombëtare e Këshillit të Evropës, e ratifikuar që ka hyrë në fuqi më 1 shtator të vitit 2001, Gazeta Zyrtare e RFJ (kontratrat ndërkombëtare), nr. 6/98.

8 Mali i Zi ka pranuar Dokumentin e Evropës për gjuhët rajonale dhe të pakicave që në kohën e ekzistimit të shtetit federal Serbia dhe Mali i Zi më 22 mars të vitit 2005. Ky dokument është ratifikuar në Parlamentin e Federatës më 15 shkurt të vitit 2006 dhe ka hyrë në fuqi më 6 qershor 2006. Ligji për ratifikim e dokumentit evropian për gjuhët rajonale dhe të pakicave (“Gazeta zyrtare S e MZ- Kontratrat ndërkombëtare” nr. 18/2005)

Mali i Zi ka pranuar që në fushën e mjeteve të informimit publik të mundësojë dispozita përkatëse, falë të cilave treguesit e programit do tu ofronin përmbajtje në gjuhët rajonale dhe të pakicave; që të nxitë ose lehtësojë emetimin e rregullt të radio-programeve në gjuhët rajonale dhe të pakicave; që të nxitë dhe të lehtësojë prodhimin dhe shpërndarjen e audiove ose punimeve audiovizuale në gjuhët rajonale dhe të pakicave; të nxitë ose të ruajë së paku një gazetë në gjuhët rajonale ose të pakicave; të përkrahë masat financiare në prodhimin audiovizual në gjuhët rajonale dhe të pakicave.

Mali i Zi gjithashtu ka marrë detyrën që të garantojë lirinë e marrjes direkt të programit radioteleviziv nga vendet fqinje, në gjuhën e njëjtë ose të ngjashme me gjuhën e pakicave dhe rajonalet si dhe të mos u kundërvihet ri emetimit të programeve të radiotelevizionit të vendeve fqinje në atë gjuhë.

Në fund, Mali Zi do të përpiqet të mos vendosë asnjë lloj kufizimi, së pari në lirinë e të shprehurit dhe lëvizjes së lirë të informacioneve në kuadër të shtypit të shkruar në gjuhën që është e njëjtë me gjuhët rajonale ose të popujve pakicë. Të gëzuarit e këtyre lirive, meqë me vete mbajnë detyrat dhe përgjegjësitë, mund t'i nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose ndëshkimeve të cilat janë përcaktuar me ligj dhe të cilat janë të domosdoshme në shoqëritë demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, me qëllim të ndalimit të parregullsive dhe krimeve, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e autoritetit ose për mbrojtjen e informacioneve që janë pranuar në mirëbesim, ose për mbajtjen e autoritetit dhe paanshmërinë e gjykatave.

Mali i Zi po ashtu ka marrë detyrën të garantojë që interesat e përdoruesve të gjuhëve rajonale dhe të pakicës të jenë të përfaqësuara dhe të marra parasysh duke krijuar organe të përshtatshme, të cilat do të ishin në përshtatje me ligjin dhe përgjegjësitë që ekzistojnë kur janë të garantuara liria dhe pluralizmi i medieve.

Kuadri normativ i natyrës kushtetuese juridike

Neni 13 i Kushtetutës⁹ vërteton se gjuha zyrtare në Mal të Zi është ajo malazeze, ndërsa në përdorim zyrtar janë edhe gjuha serbe, boshnjake, shqipe dhe kroate. Më tej, neni 49 i Kushtetutës¹⁰ garanton lirinë e shtypit dhe formave të tjera të informimit publik. Garantohet e drejta se pa miratim, themelohen gazetatat dhe mjete të tjera të informimit publik, duke u regjistruar tek organi përkatës, ndërsa neni 50 parashikon ndalimin e censurës.

Neni 79, pika 1/11 e Kushtetutës¹¹ garanton të drejtën e pakicave për informim në gjuhën e vet.

⁹ Kushtetuta e Malit të Zi, shih lart 6.

¹⁰ Ibid

¹¹ Ibid

Kuadri juridiko – ligjor Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave¹²

Neni 12 i ligjit për Të drejta dhe liritë e pakicave parasheh që pakicave dhe pjesëtarëve të tyre t'u sigurohet liria e informimit në nivelin e standardeve të cilët janë në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njerëzve.

Pjesëtarët e pakicave kanë të drejtë në themelimin e lirë të medieve, punë të pa ndaluar të bazuar në lirinë e shprehjes, hulumtimit, grumbullimit, shpërndarjes, botimit dhe marrjes së informacioneve, qasje të lirë të gjitha burimeve të informacioneve, mbrojtjes së personalitetit të njeriut dhe dinjitetit të tij si dhe qarkullimit të lirë të informacioneve.

Organet përkatëse drejtuese të medieve, themelues i të cilave është Republika, sigurojnë një numër të caktuar orësh të emetimit të programit informativ, kulturor, arsimor, sportiv dhe dëfryes në gjuhët e pakicave dhe pjesëtarëve të tyre si dhe përmbajtje programore që lidhen me jetën, traditat dhe kulturën e pakicave dhe sigurojnë mjetet financiare për financimin e atyre përmbajtjeve programore.

Përmbajtjet që lidhen me jetën, kulturën dhe identitetin e pakicave emitohen së paku një herë në muaj, në gjuhën zyrtare, përmes shërbimeve publike.

Republika mund të sigurojë, në vartësi nga mundësitë e veta materiale, përkthimin nga gjuhët e pakicave në gjuhën zyrtare.

Qeveria mund të ndërmarrë edhe masa nxitëse që edhe në kuadër të programeve të tjera radio-televizive të sigurojë emetime të programeve të ndryshme nga paragrafi 3 i këtij neni.

Ligji për mediat¹³

Neni 1 i ligjit të medieve përcakton se mediet në Malin e Zi janë të lira, dhe është e ndaluar censura e medieve si dhe ajo që Mali i Zi garanton dhe siguron lirinë e informimit në nivelin e standardit që është sipas dokumenteve ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njerëzve (OKB, OEBS, Këshilli i Evropës, BE).

Gjithashtu, me këtë nen parashihet që ky ligj duhet të konsiderohet dhe zbatohet sipas parimeve të konventës së Evropës për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, duke shfrytëzuar përvojën e gjykatës së Evropës për të drejtat e njerëzve.

Me nenin 2 të Ligjit është përcaktuar që Mali i zi garanton të drejtën e formimit dhe punë të papenguar të medieve të bazuara në: lirinë e shprehjes, lirinë e hulumtimit, grumbullimit, shpërndarjes, botimit dhe marrjes së informacionit; qasje të lirë ndaj të gjitha burimeve të informacionit; mbrojtjes së dinjitetit dhe personalitetit të njeriut dhe qarkullimin e lirë të informatave. Mali i zi garanton pjesëmarrje të barabartë në informim si banorëve vendas, ashtu edhe të huajve, personave fizikë dhe juridikë, duke u mbështetur në këtë ligj dhe në ligjin për radio-difuzionin.

¹² Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave, shiko lart 1

¹³ Ligjin për mediet mund ta shikoni në sajtin e Qendrës për profesionalizimin e medieve <http://www.cpm.edu.yu/code/navigate.asp?Id=37>, të datës 28.10.2009

Sipas nenit 3 të Ligjit, Mali i Zi siguron një pjesë të financimit të mjeteve për realizimin me Kushtetutë dhe Ligj të të drejtave të garantuara të qytetarëve për informim, pa diskriminim, sipas bazës së përmbajtjes së programeve për informim në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e popujve të tjerë pakicë. Shuma e domosdoshme e mjeteve financiare në këtë nen vërtetohet me buxhetin e Republikës dhe mënyra e kushtet e shpërndarjes përcaktohen me aktin e administratës së organit të Republikës të ngarkuar për punët e informimit.

Ligji për shërbimet publike të radio-difuzionit në Malin e Zi¹⁴

Veprimtarinë e shërbimeve publike të radio-difuzionit të malit të Zi e kryejnë emetuesit, në përshtatje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe rregullat në këtë lëmë, sipas nenit 1 të ligjit mbi Shërbimet publike të radio-difuzionit të Malit të Zi.

Shërbimet publike të radio difuzionit të Malit të Zi, sipas nenit 2 të ligjit janë Radio e malit të Zi (RMZ) dhe Televizioni i Malit të Zi (TVCG-TVMZ).

Veprimtaria e shërbimeve publike është prodhimi dhe emetimi i programit, me të cilin plotësohen kërkesat demokratike, shoqërore, arsimore, kulturore dhe të tjera nevoja për interesa publike të shoqërisë malazeze, siguron realizimin e të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe subjekteve të tjera në fushën e informacionit, pavarësisht nga përkatësia politike, fetare, kulturore, racore ose gjinore dhe në kohë dhe me cilësi ofrojnë shërbime të ndryshme informative.

Me nenin 8 është paraparë mundësia e krijimit të Studimeve për emitimin e programeve radiotelevizive rajonale në atë mënyrë që RTMZ mundet, për nevoja të shërbimeve publike të veçanta, të krijojë studime radiotelevizive rajonale me detyrë të veçantë prodhimin dhe emetimin e programeve rajonale dhe programe në gjuhët e pakicave dhe bashkësive të tjera kombëtare në ato hapësira.

Detyra dhe përgjegjësia e RTMZ të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit, në mënyrën që parashihet se RTMZ është i detyruar, që krahas zbatimit të standardeve të larta të etikës profesionale dhe kualitetit, pa asnjë lloj forme diskriminimi ose dallimi shoqëror, të prodhojë dhe të emetojë përmbajtje programore

- që shërbejnë si pikë referuese në drejtim të forcimit të bashkësisë dhe integritetit shoqëror të gjithë individëve, grupeve dhe bashkësive;
- të cilët u janë kushtuar gjithë segmenteve të shoqërisë, veçanërisht duke pasur kujdes fëmijët dhe rininë, përfaqësuesve të popujve pakicë dhe bashkësive të tjera kombëtare, personave invalidë, të rrezikuarit shoqërorë dhe grupeve të tjera specifike;
- të cilët afirmojnë identitetin kombëtar e kulturor, identitetin kulturor dhe etnik të popujve pakicë dhe bashkësive të tjera nacionale, trashëgiminë kulturore evropiane dhe llojshmërinë kulturore;
- që afirmojnë pasurinë kulturore malazeze, nxisin dhe kujdesen për krijimtarinë kulturore artistike dhe përhapin njohuritë mbi kulturat e tjera të cilat përfaqësohen në Mal të Zi;

¹⁴ Ligji për shërbimet publike të radio-difuzionit (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 79/08, 23 dhjetor 2008.)

- që pasqyrojnë ide të ndryshme dhe besimet fetare në shoqëri, për forcimin e mirëkuptimit dhe të tolerancës dhe promovimit të karakterit multikulturor, multietnik dhe multifetar të Malit të Zi.

Mjetet për përmbajtjet qëllimore të parapara me nenin 17 të Ligjit çka nënkupton që me buxhetin e Malit të Zi siguron një pjesë të mjeteve financiare për realizimin e të drejtave të qytetarëve për informim, mbi bazën e përmbajtjeve programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e popujve pakicë.

Mënyra e shfrytëzimit të fondeve në nenin 17 përcaktohen në nenin 18 sipas të cilës organi i administratës shtetërore, i ngarkuar me punët e medie dhe RTMZ me marrëveshje rregullojnë të drejtat reciproke dhe detyrimet që lidhen me përdorimin e mjeteve nga neni 17 i këtij ligji, në afatin prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e Ligjit për Buxhetin e Malit të Zi për vitin e caktuar. Mënyra dhe kushtet e sigurimit të mjeteve nga buxheti i Malit të Zi nuk guxojnë të ndikojnë në pavarësinë redaksionale dhe qëndrimin e vet të RTMZ. PAGESA e mjeteve nga Buxheti i Malit të Zi bëhet në katër pjesë të barabarta, duke u mbështetur në ligjin për buxhetin. Kontrata sipas pikës I e këtij neni botohet në organin mbi punën e RTMZ dhe u jepet për shqyrtim organit rregullues të pavarur për përmbajtjet e programeve.

Këshilli i RTMZ, sipas nenit 22, paragr.1 pika 11 dhe 16 jep dakortësinë në kontratën për përfundimin e mjeteve të siguruar me buxhetin e Malit të Zi për krijimin dhe emetimin e përmbajtjes së programeve nga neni 17 i këtij ligji dhe emëron e shkarkon Komisionin për përmbajtjet e programeve në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e pakicave të tjera.

Ligji për radio-difuzionin¹⁵

Në pajtim me nenin 1 ligji për radio-difuzionin redakton kryerjen e veprimtarisë radio-difuzive në Malin e Zi në përshtatje me Ligjin për Mediet dhe nivelin e standardeve të përcaktuara në dokumentet ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë e Njerëzve (OKB, OEBS, Këshilli i Evropës, BE etj).

Me ligj është e ndaluar çdo formë censure dhe përzjerje e paligjshme në punën e medie elektronike (Neni 3, paragr, 1, pika 2).

Sipas kuptimit të nenit 4, paragr, 1, pika 2 të Ligjit, emiteri është person fizik ose juridik, që është regjistruar për prodhimin, transmetimin dhe emetimin e programit radio-difuziv (në radio ose televizion) dhe të cilit sipas ligjit i është dhënë leja për transmetimin edhe emetimin e sinjalit radio-difuziv. Në bazë të nenit 34 të Ligjit personi fizik ose juridik që është i regjistruar për prodhimin, transmetimin dhe emetimin të programit të radios ose televizionit, me fitimin e lejes për transmetim dhe emetim të sinjalit radio-televiziv, fiton status e emiterit, në kuptim të këtij ligji.

Emiteri mund të kryejë veprimtari prodhimi, transmetimi dhe emetimi të programit radio-televiziv si:

¹⁵ Ligji për radio-difuzionin ("Gaz. Zyrtare RMZ" nr. 51/02, 62/02, 46/04, 56/04, 77/06, "Gazeta zyrtare e MZ" nr. 50/08, datë 19.08.2008, 79/08 datë 23.12. 2008, 53/09 datë 07.08.2009.)

- shërbimi publik radiodifuziv i Republikës;
- shërbimi publik lokal radiodifuziv;
- shërbimi radiodifuziv komercial.

Në pajtim me nenin 95 të Ligjit, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm në fushën e informimit dhe radio-difuzionit, emiterët e shërbimeve radio difuzive publike:

krijojnë dhe emitojnë programe që i kushtohen të gjitha segmenteve të shoqërisë, pa diskriminim, duke u kushtuar kujdes të veçantë grupeve specifike shoqërore siç janë fëmijët dhe rinia, grupet pakicave etnike, handikapatët, të rrezikuarit shoqërisht dhe nga ana shëndetësore etj.

krijojnë dhe emitojnë programe që shprehin identitetin kulturor të popullit, grupeve kombëtare dhe etnike;

krijojnë dhe emitojnë programe në gjuhën amtare të popujve pakicë në hapësirat ku jetojnë;

bashkëpunojnë mes veti, shkëmbejnë përmbajtjet e programeve që u interesojnë qytetarëve të Republikës.

Në pajtim me nenin 100 emiterët e shërbimeve radiodifuzive publike fitojnë të ardhurat nga parapagesat dhe burime të tjera në pajtim me ligjin dhe aktin themelues. Me buxhetin republikan, gjegjësisht të njësive të vetëqeverisjes lokale sigurohet një pjesë e mjeteve financiare për realizimin me kushtetutë dhe ligj të të drejtave të garantuara të qytetarëve për t'u informuar, pa diskriminim, mbi bazën e përmbajtjeve të programit që janë të rëndësishme për zhvillimin e shkencës dhe të arsimit, zhvillimin kulturës, informimin e personave që vuajnë nga të parit dhe të dëgjuarit.

Për arsye të garantimit të drejtave nga neni paragrafi i mëparshëm, republika, gjegjësisht njësia vetëqeverisëse, siguron një pjesë të mjeteve financiare për përmbajtjet e programeve në gjuhët amtare të popujve pakicë.

Organi i administratës i ngarkuar me punën e informimit, në emër të qeverisë së Malit të Zi, gjegjësisht organi kompetent në njësinë vetadministruese lokale dhe emiteri i shërbimit publik të radio-difuzionit rregullojnë me marrëveshje të drejtat dhe detyrimet mes veti të lidhura me shfrytëzimin e mjeteve për përmbajtjet e programeve në gjuhët amtare të popujve pakicë.

Në rastin kur në buxhetin e Republikës ose të njësive vetëqeverisëse mjetet e përcaktuara nuk janë të mjaftueshme për kryerjen e detyrimeve të emiterëve të shërbimeve radio-difuzive publike për përmbajtjet e programeve në gjuhët amtare të popujve pakicë, mjetet që mungojnë sigurohen me fondet e republikës, gjegjësisht të buxhetit të njësisë vetëqeverisëse lokale, me kushtin që tek humbjet nuk kanë ardhur nga mosshfrytëzimi si duhet i mjeteve të siguruara. Mënyra dhe kushtet e sigurimit të mjeteve për përmbajtjet programore në gjuhët amtare të popujve pakicë nuk mund të ndikojnë në pavarësinë redaksionale dhe pavarësinë e emiterit të të shërbimit të radio difuzionit publik.

Kontratat që nënshkruajnë organi i administratës i ngarkuar për punët e informimit publik, në emër të Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, gjegjësisht organi i ngarkuar i pushtetit ekzekutiv në njësinë vetadministruese lokale dhe emiteri i shërbimit të radiodifuzionit publik shpallen në mënyrën e përcaktuar në aktin themeltar të emiterit dhe i jepet për shqyrtim Agjencisë.¹⁶

II Shqiptarët

Sipas regjistrimeve të fundit, në malin e Zi ka 31.163 shqiptarë, ose 5,03%.¹⁷ Më shumë shqiptarë jetojnë në Bar 7,61%, Plavë 19,70%, Podgoricë 5,5%, Rozhajë 4,44%, Ulqin 72,14%.¹⁸ Në komunat e tjera në Mal të Zi ka më pak se 1%. Emisioni i parë në gjuhën shqipe ka filluar në Televizionin e Malit të Zi (TVMZ) që në vitin 1992.¹⁹ Atëherë emisioni ka qenë njëherë në javë nga tridhjetë minuta dhe është titulluar “Në fund të javës”.²⁰ Në vitin 1998 është shfaqur dëshirë më e madhe dhe gatishmëri e redaksisë së TVMZ për zgjerimin e programit dhe në atë mënyrë është formuar redaksia në gjuhën shqipe. Deri atëherë vetëm një gazetar me kombësi shqiptare ka punuar në realizimin e emisionit “Lajmet”²¹ me kohëzgjatje 15 minuta, derisa emisioni javor i të shtunës “Mozaiku 60” ka pasur karakter informativ muzikor.²² Sot ky emision që ka zgjatur 60 minuta është shkurtuar në 40 minuta dhe quhet “Mozaiku”. Sipas mendimit të redaktorit të emisionit në gjuhën shqipe, shkaku u kësaj shkurtese nuk është i karakterit financiar, sepse i njëjti numër njerëzish punon edhe versionin e shkurtuar të emisionit. “Kur kemi kërkuar që të mos na bëhet versioni i shkurtuar, kemi marrë përgjigjen nga redaktorja kryesore se ashtu duhet të jetë dhe se një rast i tillë është bërë me të gjitha emisionet”²³ - ka thënë Fran Camaj, redaktori i programit në gjuhën shqipe të TV të Malit të Zi.

Pyetjes se sa të punësuar ka në atë redaksi, Camaj ka thënë se një pjesë të punës e kryejnë njerëzit që nuk janë të lidhur ngushtë me redaksinë, siç janë kameramani, montuesi, realizuesi etj. Në redaksinë e gjitha emisioneve në gjuhën shqipe punojnë tre redaktorë, një gazetar nga Ulqini, sekretari i redaksisë, ndërsa me kontratë punojnë dy udhëheqëset dhe një gazetar si edhe bashkëpunëtorët e jashtëm nga Plava, Rozhaj dhe Ostrosi që mbulojnë Barin, Prishtinën dhe Shkupin.²⁴

Përveç emisionit informativ “Lajmet” dhe emisionit javor “Mozaiku”, TV i Malit të Zi shfaq edhe emisionin për Vitin e Ri. Emisioni i Vitit të Ri zgjat një orë e gjysmë dhe jepet me 31 dhjetor nga ora 17 00. Në RTMZ gjatë të gjithë vitit jepen tri emisione në gjuhën shqipe dhe këto janë “Lajmet”, “Mozaiku” dhe emisioni për Vitin e Ri.

17 Enti i Statistikës i Malit të Zi në sajtin <http://www.monstat.org/Popis.htm>, i cili është vizituar më 22 tetor 2009.

18 *Ibid*

19 *Nga intervista me Fran Camaj, redaktorin e programit ne gjuhën shqipe ne TVCG, nga 02.10.2009, e cila ndodhet ne arkivin e Inicijatives*

20 *Ibid*

21 *Ibid*

22 *Ibid*

23 *Ibid*

24 *Ibid*

Të gjithë gazetarët e redaksisë në gjuhën shqipe të RTMZ kanë kaluar në aftësi, ka thënë redaktori Camaj²⁵ sipas planeve që i ka njoftuar hulumtuesit të Iniciativës, është në plan të hapet redaksia në Ulqin.²⁶

Ka rreth një vit që në lajmet kryesore të TVMZ, çdo javë në emisionin e orës 19.30 emitohet nga një pjesë në gjuhën shqipe ose gjuhët e pakicave, kurse titl²⁷shkon në gjuhën malazeze.²⁸

Në RCG redaksia e programit në gjuhën shqipe ekziston që në vitin 1965.²⁹ Atëherë në RMZ ka pasur redaktorin, gazetarin dhe spikerin dhe është emituar një emision javor prej 45 minutash.³⁰ Redaksia sot ka të punësuar 7 punonjës dhe punon çdo ditë.³¹ Gjashtë ditë në javë, me përjashtim të ditës së diel, në kuadër të programit të mëngjesit emitohen Lajmet dhe Ditari në ora 17.30 në gjuhën shqipe.³² Çdo të shtunë emitohet emisioni “Në fund të javës” i cili zgjat 30 minuta ku jepen episode rreth ngjarjeve në hapësirat e banuara nga shqiptarët.³³ Në Ulqin, qytetarët me kombësi shqiptare, krahas RTMZ mund të ndjekin edhe shërbimin lokal publik. Në bisedë me hulumtuesin e Iniciativës, Drejtori i Radio Ulqinit është shprehur se programi emitohet në dy gjuhë, shqipe dhe malazeze. Përveç radios, është marrë vendimi që të fillojë edhe televizioni në kuadër të shërbimit publik lokal.³⁴ Rreth 70% e programit jepet në gjuhën shqipe dhe 30% në gjuhën malazeze, çfarë i përshtratet përfaqësimit në përqindje të banorëve në atë qytet.

Emisionet informative jepen në të dy gjuhët në çdo orë. Programi i mëngjesit jepet po ashtu në të dyja gjuhët³⁵ si dhe programet për bujqësinë, rininë, turizmin etj.³⁶

Drejtori i radios theksoi se ekzistojnë vështirësi financiare. Megjithatë me hapjen e televizionit pritet se do të shkojë çdo gjë më mirë.³⁷

Në fokus të grupit që mori pjesë me 24 prill 2009³⁸ ata me kombësi shqiptare³⁹ kanë shprehur qëndrimin e vet për informimin në gjuhën amtare. Shumica e pjesëmarrësve të grupit fokus kanë theksuar se më shumë ndjekin mediet e shtypura(gazetat). Shumica e tyre

25 *Ibid*

26 *Ibid*

27 Mendohet për përkthimin

28 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me Bogiq Rakoçeviqin , redaktorin e programit të parë të TVMZ, të mbajtur me 9 tetor 2009 dhe gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

29 Nga intervista me Pjetër Lucajn, redaktorin e programit në shqip RMZ, datë 5 shtator 2009, që gjendet në dokumentacionin e Iniciativës.

30 *Ibid*

31 *Ibid*

32 *Ibid*

33 *Ibid*

34 Nga intervista me Esad Mehmetin, drejtor i Radio Ulqinit datë 24 shtator 2009.

35 Programi i mëngjesit nga 8 00 deri 10 00 emitohet në gjuhën shqipe, ndërsa nga ora 10 deri në 11 në gjuhën malazeze.

36 Nga intervista me Esad Mehmetin, shiko lart 34

37 *Ibid*

38 Raportim për grupin fokus, i cili me 24 prill 2009 u mbajt në Ulqin. Ky material ndodhet në dokumentacionin e Iniciativës.

39 *Ibid*, Struktura, moshë dhe arsimimi janë të shënuara në raportim.

konsideron se në atë mënyrë informohen më mirë. Pjesëmarrësit më të rinj thonë se më shumë përdorin internetin, përmes të cilit informohen plotësisht dhe më lehtë. Megjithatë, për sa u takon Shërbimeve publike, pjesëmarrësit kanë thënë se ndjekin përmbajtjet në shërbimet publike deri dy orë në ditë.⁴⁰

Pjesëmarrësit e grupit fokus kanë thënë se më shumë përcjellin emisionet informative të TVMZ dhe emisionet që u kushtohen kulturës dhe pakicave. Nga gjashtëmbëdhjetë pjesëmarrës vetëm dy kanë thënë se ndjekin shtypin në gjuhën shqipe.⁴¹ Përveç Shërbimit publik, të gjithë pjesëmarrësit ndjekin edhe programet e tjera sepse mendojnë se kështu informohen më mirë. “Plotësoj nevojat e duhura, ato kryesoret, përmes RTMZ, por ndjek edhe programet nga stacionet televizive të Shqipërisë. Mendoj se do ish më mirë të tregonin më shumë për territoret ku jetojnë pakicat, sepse ashtu do të shmangeshin paragjykimet që kanë të tjerët, dhe njëkohësisht do të promovoheshin pasuritë, potencialet, territoret ku jetojnë pakicat. Për këtë arsye mendoj se do të ishte mirë që RTMZ, së paku njëherë në javë t’u kushtonte në mënyrë të vazhdueshme shqiptarëve. Nuk ka materiale në gjuhën shqipe, dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse roli i medieve është shumë i madh. “Është me rëndësi të madhe Shërbimi publik në gjuhën shqipe, por ka shumë rëndësi që të tregohen kultura dhe zhvillimi ekonomik i shqiptarëve, si edhe veçoritë e tyre, jo vetëm në televizionin lokal ose në gjuhën shqipe, por edhe në televizionin kombëtar” - ka thënë njëri nga pjesëmarrësit.

Shumica e pjesëmarrësve mendon se informacionet që japin shërbimet lokale nuk janë të mjaftueshme dhe japin minimumin në raport me nevojat e qytetarit të thjeshtë. Për sa i takon medieve kombëtare dhe informacioneve që ofrojnë në gjuhën shqipe, pjesëmarrësit thonë se nuk plotësojnë kërkesat e tyre sepse ato informacione janë të përkthyer, ku edhe përkthimet janë shpesh shumë të dobëta. Gjithashtu kur është fjala për emisionet për kulturën e shqiptarëve, pjesëmarrësit shprehen se ato kanë prezantim gjysmak dhe se nga mënyra si prezantohen janë jo profesionale.⁴²

Për ne është më interesat një ngjarje që ka ndodhur në hapësirën e Ulqinit dhe për të cilin RTMZ nuk ka interesim. Në çdo rast presim që televizioni shtetëror të emitojë përmbajtje më cilësore në kohën e parashikuar për emisionet në gjuhën shqipe në raport me radio Ulqinin, sepse është televizion kombëtar dhe ka kapacitete për të plotësuar këto nevoja. Mendoj se deri tani kjo nuk është e mjaftueshme. Ekzistojnë emisione në gjuhën shqipe, por ato nuk janë të mjaftueshme që përmes tyre të mësojmë çfarë ndodh në vetë Ulqinin, por edhe në Mal të Zi dhe në rajon. Për këtë arsye duhet të ndiqen mediet dhe në gjuhën malazeze ose mediet nga Shqipëria” – është shprehur njëri nga pjesëmarrësit.

Shumica e pjesëmarrësve, nevojat e veta për informim i plotëson me shfrytëzimin e internetit dhe përcjelljen e medieve nga rajoni përmes antenave digjitale. “Mendoj se mediet lokale janë më tërheqëse, sepse marrim informacione nga mjedisi ynë dhe që nuk janë në RTMZ ose në mediet e tjera komerciale dhe gazetatat ditore” – ka theksuar njëri nga pjesëmarrësit.

40 Ibid

41 Ibid

42 Ibid

Të gjithë pjesëmarrësit kanë rënë dakord që “Mozaiku”, i vetmi emision në gjuhën shqipe që emiton TVMZ, nuk i plotëson kërkesat dhe nevojat e tyre. Informacionet dhe përmbajtja e vetë emisionit janë me cilësi të dobët, mendojnë pjesëmarrësit. Gjithashtu, informacionet janë të vjetruara, të koncipuara për të treguar disa tradita të vjetra dhe mënyrën e vjetër të jetesës së shqiptarëve. Emisioni nuk ofron sa duhet informacione që u takojnë të rinjve si dhe mungon gazetaria hulumtuese.

Njëri nga pjesëmarrësit ka thënë se është shumë e rëndësishme që gjatë atij emisioni të promovohen vlerat dhe kultura e të gjithë qytetarëve të Malit të Zi, kështu edhe të shqiptarëve,

sepse “televizioni dhe mediet në përgjithësi janë një mekanizëm i fuqishëm në bazën e të cilit formohet figura e njohjes publike për ju si përfaqësues i një populli të caktuar”.⁴³

Shumica e pjesëmarrësve merr informacionet në gjuhën shqipe nga televizioni privat lokal⁴⁴ dhe programeve private shqiptare. Lajmet në gjuhën shqipe në orën 17 00 janë përkthim nga lajmet e televizionit shtetëror, kështu që nuk sjellin asgjë të re sepse sjellin të njëjtën përmbajtje, pasi shumica e shqiptarëve dinë edhe gjuhën malazeze dhe kështu ndodh që shumica e shqiptarëve t’i dëgjojnë lajmet dy herë. Si qyteti ku shqiptarët përbëjnë shumicën dërmuese, pjesëmarrësit mendojnë se Ulqini dhe qytetarët e tij nuk gëzojnë kujdesin e merituar në Shërbimin publik. Si problem i kualitetit të përmbajtjeve ata kanë theksuar mungesën e kuadrit që do të ndikonte në cilësinë e emisionit. Përveç emisioneve në gjuhën shqipe, është e domosdoshme e nevojshme të jepen sa më shumë emisione në gjuhën malazeze si p.sh. “Kronika e Ulqinit, e Tuzit etj.”⁴⁵

Sipas mendimeve të pjesëmarrësve, “Mozaiku”, i vetmi emision në gjuhën shqipe në TVMZ,

duhet të transformohet. Ata kanë vlerësuar se emisioni nuk mund të jetë informativ, sepse jepet një herë në fund të javës, të shtunën, dhe kështu informacionet janë të vjetruara. Ata kanë theksuar që ky emision do të duhej të kish karakter edukativo-kulturor.

Pjesëmarrësit nuk e kanë vlerësuar në mënyrë pozitive as përmbajtjen e gazetës “Koha Javore”. Sipas mendimit të tyre, shkaku janë problemet financiare. Ata mendojnë se problemi qëndron në atë se gazeta del në kuadrin e gazetës ditore “Pobjeda” dhe nuk është gazetë e pavarur. Vendi i redaksisë që drejton këtë gazetë është gjithashtu diçka që duhet ndërruar. Zyra e punës është në Podgoricë, ndërsa njerëzit që punojnë si gazetarë, shkojnë çdo ditë prej Ulqini dhe atje (në Podgoricë) kalojnë kohën e punës. D.m.th. i vetmi organ në gjuhën shqipe nuk ka asnjë zyrë në Ulqin, ku ata gazetarë do të punonin⁴⁶ ka thënë njëri nga pjesëmarrësit e grupit fokus.

Qytetarët me kombësi shqiptare kanë rastin të shikojnë mediet nga shteti amë përmes transmetimit me satelit dhe atij kabllor. Për shumicën e qytetarëve, në varësi se ku jetojnë, ekzistojnë mundësi që nëpërmes antenave të zakonshme tokësore të shikojnë televizionin kombëtar shqiptar TVSH.

43 *Ibid*

44 Është fjala për televizionin lokal “Teuta”

45 Raportimi nga grupi fokus i mbajtur në Ulqin, shih lart 38

46 *Ibid*

Edhe pse ato medie kanë rrallë përmbajtje dhe informacione që lidhen me Malin e Zi, qytetarët me kombësi shqiptare informohen përmes atyre medieve në gjuhën e vet për lajmet nga rajoni, për kulturën moderne, arsimimin, religjionin dhe tema të tjera.

Për një program më cilësor në Shërbimin publik më të përgjegjshmit janë gazetarët.⁴⁷ Do të thotë së pari gazetari duhet të dijë të konceptojë emisionin dhe programin e vet. Duhet më shumë mund dhe krijimtari, të dijë se cilat informacione të paraqesë. Domethënë, do të duhej të merrej më shumë me hulumtimet gazetareske⁴⁸, - ka thënë njëri prej pjesëmarrësve. Si një nga problemet e mundshme, pjesëmarrësit shohin jo stabilitetin financiar, inkompetencën, pasivitetin e vetë anëtarëve të redaksisë si dhe mungesa e krijimtarisë. Do të ishte e nevojshme të kalonin në kurse të tjera kualifikimi, që programi të jetë më cilësor.⁴⁹

“Konsideroj se hapja e zyrës për Kohën Javore” në Ulqin me siguri do të rregullonte situatën. Gjithashtu mendoj se do të ishte me leverdi që të hapet edhe një studio e RTMZ në Ulqin. Shohim se ekzistojnë kronika të disa qyteteve në Mal të Zi. Nuk shoh arsye që të mos ekzistojë edhe Kronika e Ulqinit⁵⁰ - ka thënë njëri nga pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit nuk shohin përmirësim të përmbajtjeve në Shërbimin publik dhe mendojnë se është i njëjtë me para pesë vjetësh. Krijohet përshtypja se emisionet përsëriten ose të shihni të njëjtin gjatë gjithë kohës. Kryetari i Këshillit të shqiptarëve në Malin e Zi, Tahir Tahiri i ndjek rregullisht mediet dhe shtypin në gjuhën shqipe, por thotë se përmbajtjen nuk i kënaqin nevojat e tija.⁵¹ Për këtë arsye më shumë ndjek mediet e shtypit dhe internetin. “Mendoj se në Malin e Zi, programet për pakicat janë pak të përfaqësuara në shërbimin publik të RTMZ, dhe kur është fjala për pakicat shqiptare, ato programe as për së afërmi nuk i plotësojnë nevojat e shqiptarëve në Malin e Zi. Çdo informacion është i përkthyer dhe nuk ekziston asnjë përmbajtje që do t'i tërhiqte vëmendjen një shikuesi mesatar”, ka thënë Tahiri.⁵² Sipas fjalëve të tij as emisionet e tjera nuk i përgjigjen nevojave të shqiptarëve në Malin e Zi. Përmbajtjet që lidhen me kulturën, besimin, mënyrën e jetesës të shqiptarëve duhet të kenë përparësi për realizimin e emisioneve në gjuhën shqipe.⁵³

Si pakicë specifike që flet një gjuhë që ndryshon krejtësisht nga gjuhët e tjera të pakicave, kryetari i Këshillit kombëtar të shqiptarëve konsideron se shqiptarët do të meritonin një trajtim më të mirë në Shërbimet publike.⁵⁴

Ministri për Mbrojtjen e të Drejtave njerëzore dhe të Pakicave Ferhat Dinosh⁵⁵ ka thënë se ka pak përmbajtje programore në gjuhën shqipe. Duke marrë parasysh që “Shqiptarët janë pakicë gjuhësore e vetme në Malin e Zi, mendoj se do të ishte i nevojshëm një program

47 Ibid

48 *Ibid*

49 Konkluzioni i pjesëmarrësve të grupit fokus.

50 Ibid

51 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me kryetarin e këshillit kombëtar të shqiptarëve, Tahir Tahirin, e cila gjendet në dokumentacionin e Iniciativës.

52 Ibid

53 Ibid

54 Ibid

55 Përgjigje në pyetësin e Ferhat Dinoshës, 1 korrik 2009, gjendet në dokumentacionin e Iniciativës.

gjatë gjithë ditës në një kanal të veçantë televiziv në gjuhën shqipe”⁵⁶ - ka thënë ministri Dinosha.

Si mangësi të medieve lokale dhe shërbimeve publike Dinoshka ka cekur karakterin lokalistik të tyre, ndërsa për televizionin kombëtar mendon se nganjëherë nuk janë sa duhet kombëtarë.

“Konsideroj se programi i pakicave dhe për pakicat nuk janë sa duhet të përfaqësuar në Shërbimin publik të RTMZ. Programet që lidhen me pakicën kombëtare shqiptare më shumë janë të përfaqësuar nga të tjerët, por me gjithat jo sa duhet të pranishëm. Të gjitha pakicat nuk janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në shërbimet publike. Mundet të jetë më e madhe prania e programit për shqiptarët e kushtëzuar nga specifika gjuhësore e pakicave kombëtare shqiptare.”⁵⁷ – vuri në pah ministri.

Ministri ka theksuar se oferta e vlerës kulturore të pakicave në media, në gjuhën malazeze duhet të jetë më e madhe. Gazetari i “Kohës Javore” Ismet Kallaba ka vënë në pah se ka shumë kohë që flitet për zgjerimin e atij programi, por në vend të kësaj gjeje ka ardhur ngushtimi.⁵⁸

Deputeti Genci Nimanbegu⁵⁹ nuk është i kënaqur me mediet lokale dhe nacionale. Sipas mendimit të tij, programet për pakicat kombëtare përfaqësohen dobët në Shërbimin publik të RTMZ, si në strukturën organizative, ashtu edhe në vetë programin e shërbimit publik.

“Gazetarët e punësuar dhe redaksitë e tyre nuk kanë treguar gatishmëri që në mënyrë cilësore dhe kritike të përcjellin temat për të cilat raportojnë. Në këtë mënyrë këto shërbime (radio dhe televizioni i Malit të Zi) kthehen në medie që nuk meritojnë kujdesin e shikuesit dhe dëgjuesit mesatar”⁶⁰ – ka thënë Nimanbegu. Përmbajtjet të cilave duhet t’u përkushtohet ky shërbim janë informacionet mbi pozitën shoqërore, sociale, ekonomike dhe kulturore të shteteve fqinje dhe ato informacione do të duhej t’u ishin të paraqitura edhe banorëve të Malit të Zi që nuk flasin shqip.

Duke folur për emisionin “Mozaiku” Nimanbegu theksoi se nuk është i kënaqur me përmbajtjen e emisionit, se është i shkurtuar në krahasim me periudhën e mëparshme dhe se ekzistenca vetëm e një emisioni në javë është shumë pak. Sipas mendimit të tij ka kuadro të mjaftueshëm që do të mund të siguronin një program më me kualitet dhe më interesant në gjuhën shqipe.⁶¹ Nimanbegu ka treguar se është e domosdoshme një redaksi e përhershme e RTMZ në Ulqin.

“Gjithsesi do të duhej të bëhej një organ punues ose këshill i përbërë nga përfaqësues të pakicave, funksioni i të cilit do të ishte kujdesi për një përfaqësim cilësor dhe të barabartë të gjitha pakicave në nivel të Malit të Zi. Do të ishte mirë që anëtarët e atij këshilli të ishin

56 Ibid

57 Ibid

58 Përgjigje në pyetësin e Ismet Kallabës, datë 10 korrik 2009, gjendet në dokumentacionin e Iniciativës.

59 Përgjigje në pyetësin e Genc Nimanbegut, 30 qershor 2009, ndodhet në dokumentacionin e Iniciativës.

60 Ibid

61 Ibid

persona të pavarur politikisht, gjegjësisht persona që zgjidhen mbi bazën e aftësive të tyre profesionale dhe jo përkatësive politike”⁶² – është shprehur Nimanbegu.

Përveç emisioneve në gjuhën shqipe, në programin e rregullt muzikor të Shërbimit publik, krahas emisioneve muzikore me muzikë angleze, italiane, kroate, duhet të jetë prezente edhe muzika në gjuhën shqipe.⁶³ Programet filmike duhet të japin edhe filma shqiptarë në skemat e veta programore.⁶⁴

Sipas mendimit të drejtorit të TV “Teuta” në Ulqin, Dino Ramoviq⁶⁵ shërbimet publike shtetërore ose lokale, sipas karakterit të vet, do të duhej të ishin shtëpi informative, kulturore dhe arsimore, në të cilat ka vend për të gjithë qytetarët e Malit të Zi, pavarësisht nga përcaktimi i tyre politik, kombëtar apo fetar, sepse të gjithë qytetarët, si pagues taksash, drejtpërdrejt financojnë edhe ato shtëpi të mediejeve. Megjithatë, sipas fjalëve të zotëri Ramoviqit, shërbimet publike këtë detyrë nuk e kryejnë aq mirë si duhet.⁶⁶

“Shërbimet publike lokale janë gabime të sistemit. Ato janë dora e shtrirë e partive në pushtet në bashkësinë lokale dhe vendi për kuadrot e “merituara” Partiake pa përvojë profesionale në këtë lëmë. Me një numër të madh të punësuarish dhe pagesën e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe personelit që drejton

Shërbimet publike lokale po bëhen “një lojë” e shtrenjtë për buxhetet e varfra të bashkësive lokale. Veç kësaj ato nuk sillen sipas ligjeve të ekonomisë së tregut, nuk i kushtojnë kujdes llogaritjes së të ardhurave të veta, sepse i kanë të siguruara mjetet financiare përmes buxhetit të komunës. Ndoshta edhe për këtë nuk krijojnë programe që dalin në tregun e mediejeve. Nga ana tjetër, mediet komerciale, dhe veçanërisht ato lokale, shumë herë më shumë sillen si shërbime publike, sepse vetëm ashtu mund edhe të ekzistojnë. Janë më racionale dhe më efikase, më shumë të shikuara dhe të dëgjura, me profesionistët e vërtetë në punë”, - ka thënë Ramoviqi.

Si zgjidhje që të funksionojë Shërbimi publik lokal, zotëri Ramoviq, si të vetmen mënyrë që të gjallërohet kjo ide ka thënë se me Ligjin e ri për mediet elektronike krijohet mundësia për partneritet publik dhe privat. Sipas mendimit të tij, për këtë ekzistojnë modele të ndryshme – që nga nënshkrimi i bashkëpunimit programor dhe tekniko-profesional i administratës lokale dhe i një medie komerciale, e cila për llogari të komunës do të krijonte programe të caktuara, deri tek blerja e një përqindje të caktuar të një medie komerciale për llogari të komunës. “Sipas njohurive të miya, interesimi për një model të tillë bashkëpunimi ekziston në Budvë, Nikshiq, Bijello Pole, Podgoricë dhe Ulqin”,- ka thënë Ramoviqi.

62 Ibid

63 Ibid

64 Ibid

65 Përgjigje në pyetësin e Dino Ramoviqit, 9 tetor 2009, gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

66 Ibid

Përfundimet

- RTMZ si shërbim publik, në gjuhën shqipe emiton çdo ditë emisionin informativ “Lajmet”, njëherë në javë emisionin “Mozaiku” dhe emisionin e Vitit të Ri. Krahas emisioneve të rregullta të çdo jave, gjatë emisionit kryesor informativ jepet shtesa në gjuhën shqipe me përkthimin në gjuhën malazeze.
- Në Ulqin, si shërbim publik lokal funksionon vetëm Radio Ulqini, programi i të cilit në gjuhën shqipe emitohej në proporcion me strukturën e banorëve të atij qyteti. Krahas radios është marrë vendimi që së shpejti të fillojë punën edhe televizioni lokal në kuadër të Shërbimit publik.
- N.P. “Pobjeda” një herë në javë boton gazetën në gjuhën shqipe “Koha javore”.
- Pjesëmarrësit e grupit fokus vërejnë se për arsye të gjuhës së vet specifike nuk ka mjaft përmbajtje në gjuhën shqipe.
- Shumica e pjesëmarrësve ka vlerësuar se informacionet që ofrojnë shërbimet lokale nuk janë të mjaftueshme dhe kënaqin vetëm nevojat minimale të qytetarit mesatar. Për sa u përket medieve kombëtare dhe informacioneve që ofrojnë në gjuhën shqipe, pjesëmarrësit mendojnë se nuk i plotësojnë kërkesat e tyre sepse ato janë kryesisht informacione të përkthyer nga emisioni kryesor informativ që emitohej në orën 19:30.
- Kur është fjala për emisionet për kulturën e shqiptarëve, pjesëmarrësit mendojnë se ato paraqiten gjysmë-gjysmë dhe se janë joprofesionale nga mënyra se si prezantohen. Të gjithë pjesëmarrësit janë të një zëri se emisioni i vetëm “Mozaiku” që emiton RTMZ nuk i plotëson kërkesat dhe nevojat e tyre. Informacionet dhe përmbajtja e vetë emisionit janë me kualitet të dobët. Gjithashtu informacionet janë vjetruar shumë, janë të menduara ashtu që të tregojnë disa zakone të vjetra dhe mënyrën e vjetër të jetesës tek shqiptarët. Emisioni nuk jep informacione të mjaftueshme që u takojnë të rinjve si edhe mungon gazetaria hulumtuese.
- Shumica e pjesëmarrësve të grupit fokus plotëson kërkesat për informim duke përdorur internetin dhe mediet nga rajoni, përmes programeve satelitore dhe programeve private të Shqipërisë.
- Meqenëse popullata shqiptare në Ulqin përbën shumicën, pjesëmarrësit e grupit fokus vërejnë se qytetarët e këtij qyteti nuk fitojnë kujdesin e merituar në shërbimin nacional. Si problem të përmbajtjes cilësore, pjesëmarrësit kanë nxjerrë mungesën e kuadrove, që do të ndikonin në kualitetin e programeve. Përveç emisioneve në gjuhën shqipe është e domosdoshme të jepen edhe emisione në gjuhën malazeze si për shembull “Kronika e Ulqinit, Tuzit etj”.

Rekomandimet

- Është e nevojshme që RTMZ të emitojë më shumë përmbajtje në gjuhën shqipe. Duhet të futen emisione të veçanta për kulturën, arsimin, turizmin etj.
- Emisioni “Mozaiku” do të duhej t’i kushtohej përmbajtjeve kulturore dhe të mos jetë e karakterit informativ.
- RTMZ do të duhej të emitonte më shumë përmbajtje që lidhen me letërsinë dhe historinë shqiptare të shoqëruara me muzikë urbane shqiptare. Përmbajtjet do të duhej të jenë të përgatitura ashtu që të jenë interesante jo vetëm për shqiptarët, por edhe për popujt e tjerë në Malin e Zi. Përveç kësaj ka rëndësi të informohet populli i Malit të Zi për pakicën shqiptare, për jetën e tyre, zakonet, kulturën, besimin me qëllim që të tejkalohet distanca etnike.
- Si qytet ku shumicën e bëjnë shqiptarët, Ulqini do të duhej të ishte më prezent në Shërbimin publik dhe do të ish mirë të organizoheshin më shumë aktivitete kulturore dhe turistike. Në këtë mënyrë do të pakësoheshin paragjykimet që ekzistojnë.
- Është e nevojshme edhe ekzistenca e një gazete ditore cilësore në gjuhën shqipe ose nënftetë e njëres nga këto që janë. “Koha javore” do të duhej të ndahej si subjekt i pavarur, me të cilin do të krijoheshin kushtet për transformimin e saj dhe një gazetë me kualitet.

III Boshnjakët dhe myslimanët

Në bazë të regjistrimit të popullsisë së vitit 1991, myslimanët kanë përbërë 14,57%. Pas ngjarjeve të caktuara shoqërore dhe politike, pjesëtarët deri atëherë të njëjtit grup etnik në regjistrimin e vitit 2003 janë deklaruar myslimanë (3,97%) dhe boshnjakë (7,77%)⁶⁷. Sipas regjistrimit të fundit, në Tivar jetojnë 919 (2,30%) boshnjakë dhe 2 575 (6,43%) myslimanë, në Beranë 5 662 (16,15%) boshnjakë dhe 2 301 (6,56%) myslimanë, në Bijello Pole 11 375 (22,63%) boshnjakë dhe 7 936 (15,78%) myslimanë, në Budvë 24 (0,15%) boshnjakë dhe 204 (1,28%) myslimanë, në Nikshiq 148 (0,20%) boshnjakë dhe 695 (0,92%) myslimanë, në Plavë 6 809 (49,32%) boshnjakë dhe 788 (5,71%) myslimanë, në Plevlë 1 865 (5,21%) boshnjakë dhe 2 913 (8,14%)

myslimanë, në Podgoricë 2 307 (1,36%) boshnjakë dhe 4 399 (2,60%) myslimanë, në Rozhajë 18 628 (82,09%) boshnjakë dhe 1 510 (6,65%) myslimanë, në Ulqin 297 (1,46%) boshnjakë dhe 681 (3,36%) myslimanë. Këto komunitete përbëjnë shumicën në Rozhajë dhe Plavë.

Gazetari i TV “Vijesti” Adnan Prekiq deklaroi: ”Në Shërbimin Publik TVMZ nuk ekzistojnë fare programe për pakicat. Programet që në RTMZ si programe mbi pakicat dhe për pakicat nuk mundën sipas asnjë standardi të fitojnë këtë epitet. Redaksitë që punojnë këto programe nuk janë të pavarura në çështjet më elementare të redaktimit, shumë pak njerëz punojnë në këto programe dhe çka është më e rëndësishme, të gjitha këto programe të komunitetit pakicë reduktohen në nivelin e folklorit dhe argëtimit, kështu që në Shërbimin Publik asnjëherë deri tani nuk është punuar një projekt serioz për popujt pakicë”⁶⁸. Profeshori Sherbo Rastoder, nga Këshilli i Boshnjakëve, ka theksuar se në gjuhën e vet amtare përcjell shumë pak përmbajtje, sepse janë të pakta ose nuk ka fare.

“Nuk mund të flasim mbi programet për pakicat në përgjithësi, sepse situata është e tillë që një pakicë është e favorizuar në krahasim me pakicat e tjera, edhe pse jam i mendimit se as atyre nuk u jepet shumë. Mirëpo, në krahasim me ne, që nuk marrim pothuajse asgjë ose ndoshta një lloj minimumi, ata janë megjithatë të përfaqësuar në masë të mjaftuar. Pra, nga komenti paraardhës mund të konkludohet se përfaqësimi i pakicës sime nacionale është papranueshmërisht e vogël “,- shtoi Rastoder⁶⁹. Ngjashëm mendon edhe gazetari Sabria Vuliq, i cili theksoi se janë të përfaqësuar programet për komunitetin nacional shqiptar,

67 Hulumtuesit e Iniciativës për këtë arsye kanë vendosur që boshnjakët dhe myslimanët t'i trajtojnë së bashku për traditën dhe kulturën e njëjtë

68 Përgjigjet e Adnan Prekiqit në pyetësor, të datës 26 qershor 2009 ndodhen në dokumentacionin e Iniciativës

69 Përgjigjet e Sherbo Rastoderit në pyetësor, të datës 16 korrik 2009 ndodhen në dokumentacionin e Iniciativës

përderisa për të tjerat nuk janë.⁷⁰ Vulliç deklaroi se myslimanët në Mal të Zi nuk janë mjaft të përfaqësuar në programin e Shërbimit Publik dhe se trajtohen në kundërtënie me Kushtetutën kur përdoret termi “boshnjakët/myslimanët“, krahas faktit se këto janë dy pakica nacionale të ndryshme sipas regjistrimit të fundit.⁷¹

Gazetari i Radio “Evropa e Lirë”, Sead Sadikoviç është i mendimit se emisionet ekzistuese për informim në shërbimet publike, sipas formës, kënaqin nevojat e qytetarëve të cilët gjuhë amtare kanë gjuhën malazeze, serbe, boshnjake ose kroate dhe se përjashtim bëjnë shqiptarët, të cilëve duhet t’u kushtohet kujdes i veçantë.⁷² “Ajo në çka duhet punuar“, sipas Sadikoviç, “është krijimi i përmbajtjeve që flasin për kulturën, traditën dhe jetën e pakicave, me cilat do të njohim më mirë njëri-tjetrin.”⁷³

Pjesëmarrësit e grupit të fokusit, e cila është realizuar në Rozhajë më 29 mars 2009, janë të mendimit se boshnjakët dhe myslimanët nuk janë fare të përfaqësuar në shërbimet publike.⁷⁴ Këtë poashtu e ndërlihdin me numrin e vogël të punësuarve nga radhët e boshnjakëve dhe myslimanëve në RTMZ⁷⁵. Një pjesëmarrës ka deklaruar se nuk ekziston nevojë e madhe për ekzistimin e emisioneve informative në gjuhën boshnjake në masë sa ekziston nevoja për emisione që të flasin për jetën e boshnjakëve dhe myslimanëve.⁷⁶

Pjesëmarrësi tjetër deklaroi se ekziston nevoja për përmbajtje në gjuhën boshnjake, edhe pse është mjaft e ngjashme me gjuhën malazeze dhe theksoi se kjo është një ndër mënyrat që të ruhet gjuha.⁷⁷

Redaktori i Programit të Parë të RTMZ Bogiq Rakoçeviq theksoi se në RTMZ, boshnjakëve dhe myslimanëve u jepet hapësirë përmes përmbajtjeve të ndryshme. Kështu Rakoçeviq deklaroi: “Ne, gjithsesi, merremi me problematikën e tyre përmes emisioneve ekzistuese, edhe nëse është fjala mbi kronikat e qyteteve.

Kujdes i veçantë, kur është fjala për myslimanët dhe boshnjakët i kushtohet edhe përmes programit arsimoro-shkencor. Në strukturë të këtij programi gjithmonë kemi përmbajtje speciale që u dedikohen zakoneve/dokeve, kulturës, religjionit dhe gjërave të tjera që janë të lidhura me këtë komunitet nacional.

Një serial me titull “Xhamitë në Mal të Zi“, ka zgjatur pothuajse dy vjet dhe është emituar pothuajse çdo javë. Pra, do të thotë, këtu kemi trajtuar dhe kyçur edhe historinë në mënyrë gjithëpërfshirëse. Bashkëbiseduesit kanë qenë njerëz kompetentë. Përmes programit arsimoro-shkencor kemi pasur përsëri një serial të tërë mbi urat që janë punuar në frymën e kësaj kulture dhe arkitekture dhe që kanë mbetur ende.

Pastaj, gjithmonë përcjellim autorët boshnjakë/myslimanë, mirëpo kur është fjala për artin, këto janë kategori universale dhe do të ishte keq që tani t’i ndajmë në baza nacionale. Arti u

70 Përgjigjet e Sabria Vuliçit në pyetësor, të datës 23 qershor 2009 ndodhen në dokumentacionin e Iniciativës

71 *Ibidi*

72 Përgjigjet e Sead Sadikoviçit, të datës 3. tetor 2009 gjinden në dokumentacionin e Iniciativës

73 *Ibidi*

74 Raporti nga grupi i fokusit i mbajtur në Rozhajë, më 29 mars 2009 gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

75 *Ibidi*

76 *Ibidi*

77 *Ibidi*

takon të gjithëve dhe ai është mbinacional. Në çdo rast, tentojmë të ruajmë balancën me sa është kjo e mundur, mirëpo në këtë ndikojnë edhe vetë ngjarjet dhe aktivitetet e organizatave të caktuara joqeveritare që merren me të drejtat e komuniteteve pakicë. Pra, kemi më shumë, nëse ato kanë më shumë programe dhe përmbajtje të tilla. Ekziston sidoqoftë një kontinuitet mjaft i kënaqshëm dhe është prezent përmes segmenteve programore të ndryshme, duke u nisur nga Programi i mëngjesit deri tek Ditari 3. Kemi emisione të veçanta, mirëpo këto nuk janë emisione të rregullta. Shpesh punojmë emisione nga Petnjica, si dhe nga komunat ku ata janë shumicë, çka do të thotë se për ta dhe kulturën e tyre kemi emisione nga Plava dhe Gucia në gjuhën malazeze. Një herë në muaj kemi emisione të tilla, në të cilat flitet për kulturë, ekonomi, etj. të cilat u dedikohen këtyre njerëzve dhe përmes tyre pasqyrojmë mundësitë ekonomike, gjë që intereson njerëzit të cilët jetojnë atje.⁷⁸

Avdul Kurpejoviq nga Amësia e Myslimanëve tha: „Historia, kultura, tradita, zakonet dhe identiteti nacional i myslimanëve pothuajse fare nuk janë prezent në përmbajtjet programore të shërbimit publik, edhe pse kjo është detyrim ligjor.“⁷⁹ Kurpejoviq është i mendimit se RTMZ duhet të lirohet nga ndikimi i pushtetit, i cili kryhet përmes funksionarëve, që TVMZ duhet të ketë në fokus qytetarët, të lirohet nga politika e përditshme dhe politikanët⁸⁰.

Siç mund të shohim, nuk ekziston pajtueshmëri në mes pjesëmarrësve të grupit të fokusit dhe përfaqësuesve të partive politike, aktivistëve të organizatave joqeveritare nga njëra anë dhe përfaqësuesve të shërbimit publik nga ana tjetër. Sulo Mustafiq ka vlerësuar se puna e shërbimit publik do të ishte më kualitative nëse përfaqësuesit e komuniteteve pakicë do të ishin në Këshillin e shërbimit publik dhe sikur gazetarët dhe redaktorët nga radhët e pakicave do të merrnin pjesë në hartimin e programit për pakicat⁸¹. Pjesëmarrësit e grupit të fokusit kanë theksuar se zgjidhja e këtij problemi duhet të nisët nga ajo që pjesëtarët e pakicave të jenë të përfaqësuar në mënyrë proporcionale në shërbimin publik, të ekzistojë një numër i caktuar i gazetarëve, redaktorëve dhe personave të tjerë.⁸²

Gjithashtu, në grup të fokusit është theksuar se, duke pasur parasysh numrin e boshnjakëve dhe myslimanëve në shoqëri, do të duhej të ekzistonte edhe redaksia e programit për boshnjakët dhe myslimanët.⁸³ Një nga pjesëmarrësit ka thënë: “Sigurisht që duhet shumë më tepër hapësirë t’u jepet boshnjakëve dhe myslimanëve në shërbimet publike, duke filluar nga përfaqësimi si gazetarë, e pastaj edhe në disa funksione më të larta në Shërbimin Publik dhe në përgjithësi në Ministrinë kompetente për media dhe pakica. Mendoj se boshnjakët dhe myslimanët thjeshtë janë të harruar dhe të humbur nga këndvështrimi dhe mendoj se Shërbimi Publik është mundësi e mirë që përmes tij gjërat të fillojnë të ndryshojnë. Më tepër nga radhët e pakicave do të duhej të kishte në shërbimet publike “.⁸⁴

78 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me Bogiq Rakoçeviqin, redaktorin e programit të parë të TVMZ, shiko lart 28

79 Përgjigjet e Avdul Kurpejoviq në pyetësor, datë 25 qershor 2009 ndodhen në dokumentacionin e Iniciativës

80 *Ibidi*

81 Përgjigjet e Sulo Mustafiq në pyetësor, të datës 23. qershor 2009. ndodhën në dokumentacionin e Iniciativës

82 Raporti nga grupi i fokusit nga Rozhaja i datës 29 mars 2009, shiko lart 74

83 *Ibidi*

84 *Ibidi*

Kur është fjala për punën e shërbimit publik lokal, Radio Rozhajës, pjesëmarrësit e vlerësojnë pozitivisht.⁸⁵ Janë të mendimit se Radio Rozhaja kënaq nevojat kur është fjala për informimin lidhur me ngjarjet në Rozhajë, mirëpo, kjo radio nuk mund të kënaqë nevojat për informim lidhur me ngjarjet në shtet, rajon dhe botë.⁸⁶ Pjesëmarrësit kanë vlerësuar se gazetarët në Radio Rozhajë janë të arsimuar dhe se punojnë më së miri, duke pasur parasysh mundësitë.⁸⁷ Një nga pjesëmarrësit ka theksuar se krahas një televizioni, dy stacioneve të radios në Rozhajë është e nevojshme të hapet edhe një televizion, me çka do të kënaqeshin nevojat e qytetarëve të Rozhajës.⁸⁸ Sipas mendimit të pjesëmarrësit tjetër, ka shumë pak emisione që flasin për kulturën, traditën dhe jetën e boshnjakëve dhe myslimanëve në Radio Rozhajë.⁸⁹ Drejtori i radio Rozhajës, Zllatko Tutiq, tha se Radio Rozhaja është e hapur për të gjithë.⁹⁰

Ai theksoi se gjithmonë përcillen të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me jetën, kulturën dhe religionin në Rozhajë përmes programit të përditshëm.⁹¹

Sipas fjalëve të Tutiqit, kjo radio së paku një herë në muaj emiton emisione për pakicat, kulturën dhe traditën e tyre. Problem më të madh paraqet sigurimi i bashkëbiseduesve për arsye se temat vetëm se janë shfrytëzuar dhe për këtë një numër i madh i emisioneve përsëritet.⁹²

Përfundimet

- Në RTMZ nuk janë të koncipuara qartë dhe dukshëm programet për boshnjakët dhe myslimanët si programe për pakica. Nuk ekziston pajtueshmëria e përfaqësuesve të këtyre pakicave dhe shërbimeve publike lidhur me çështjen e sasisë dhe karakterit të përmbajtjeve programore.

- Në shërbimet publike nuk ekziston emisioni informativ në gjuhën boshnjake. Mendimet për nevojën e ekzistimit të përmbajtjeve programore në gjuhën boshnjake janë të ndara. Për shkak të ngjashmërisë së madhe me gjuhën malazeze, një pjesë e pjesëmarrësve në hulumtim mendojnë se emisionet e tilla nuk janë të nevojshme, derisa pjesa tjetër e pjesëmarrësve mendojnë se kjo është mënyra për të ruajtur gjuhën boshnjake dhe kulturën boshnjake në Mal të Zi.

- Kur është fjala për vlerësimin e shërbimeve publike, pjesëmarrësit kanë vlerësuar pozitivisht punën e shërbimit publik lokal të Rozhajës, përderisa kjo nuk ka vlejtur për shërbimin publik nacional RTMZ.

85 *Ibidi*

86 *Ibidi*

87 *Ibidi*

88 *Ibidi*

89 *Ibidi*

90 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me Zllatko Tutiqin, drejtorin e Radio Plavës, të realizuar më 17 shtator 2009, gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

91 *Ibidi*

92 *Ibidi*

Rekomandimet

- Në shërbimet publike lokale dhe nacionale duhet filluar me emetimin e emisioneve të veçanta që do të prezantonin në mënyrë kulturologjike dhe historike boshnjakët dhe myslimanët në Mal të Zi. Me rastin e prodhimit të këtij programi është e domosdoshme të përfshihen përfaqësuesit e boshnjakëve dhe myslimanëve, specialistët e këtyre fushave dhe programi duhet të njihet si program për pakicat nacionale.

- Kur është fjala për përmbajtjet programore në gjuhën boshnjake, ministrinë gjegjëse dhe themeluesit e shërbimeve publike, krahas pjesëmarrjes së subjekteve të tjera, siç janë Këshillat Nacionale, duhet të nisnin debatin publik mbi mënyrën e kënaqjes së dispozitave ligjore në këtë fushë.

- Në shërbimin publik RTMZ duhet të futen rregullisht emisione mbi kulturën dhe traditën e popullit mysliman dhe boshnjak, çka do çojë deri tek zvogëlimi i distancës etnike.

- Në punën e shërbimeve publike duhet në mënyrë të organizuar dhe profesionale të përfshihen pjesëtarët e popullit mysliman dhe boshnjak, përmes punësimit të numrit të caktuar të gazetarëve, redaktorëve dhe të tjerëve nga radhët e pakicave.

IV Kroatët

Në Mal të Zi jetojnë 6 811 (1,10%) kroatë. Nga ky numër, në Tivat jetojnë 2 663 (19,54%) kroatë, në Kotorr 1 762 (7,68%), në Herceg Novi 798 (2,42%), në Podgoricë 709 (0,42%), Tivar 259 (0,65%), Budvë 178 (1,12%), Nikshiq 132 (0,18%) derisa në komunat e tjera jetojnë më pak se njëqind kroatë.

Gazetari Nikolla Donçiq theksoi se mediet, duke përfshirë këtu edhe shërbimet publike në Mal të Zi, nuk kanë përmbajtje në gjuhën kroate. Donçiq deklaroi se përmbajtjet programore në gjuhën amtare i përcjell ekskluzivisht përmes medieve nga Republika e Kroacisë. Ai vlerësoi se mediat në Mal të Zi nuk kanë përmbajtje programore në gjuhën kroate, derisa përfaqësimi i komunitetit kroat në mediat malazeze është pothuajse fare mospërfillës.⁹³

Ngjashëm mendon edhe kryetarja e Iniciativës Qytetare Kroate (HGI) Marija Vuçinoviç, e cila tha se RTMZ nuk emiton program për pakicën kroate si emisione të veçanta dhe se pakica kroate përmendet eventualisht në kontekst me përmbajtjet e tjera.⁹⁴

Redaktori i programit të parë të TVMZ Bogiq Rakoçeviq nuk pajtohet me qëndrimet në fjalë, pastaj shprehet: “Kroatët kanë hapësirë kur është fjala për shërbimin publik TVMZ. Para së gjithash mendoj në Kronikën e Kotorrit. Ky është emision i përhershëm. Përmes këtij emisioni kemi raportet për aktivitetet e komunitetit kroat në Bokën e Kotorrit. Ne rregullisht përcjellim pakicën kroate përmes këtij emisioni dhe pastaj edhe përmes emisioneve të tjera, para së gjithash përmes emisioneve informative. Gjithashtu, përmes programit arsimor-shkencor japim një vështrim të veçantë, kemi shumë emisione të specializuara, duke filluar nga “Škrinje (Arkët)” e cila në mënyrë gjithëpërfshirëse trajton kulturën, adetet dhe historinë e njerëzve nga rajoni i Bokës së Kotorrit, ku kroatët janë më së tepërmi të koncentruar. Përmbajtje të tilla kemi të paktën dy deri tri herë në muaj vetëm përmes programit arsimor, por edhe programeve të tjera”.⁹⁵ Në kuadër të programit të parë të RTMZ, mes tjerash, ekziston programi për pakica që përmban dy redaksi. Njëra është redaksia e programit në gjuhën shqipe, kurse tjetra është redaksia e programit në gjuhët e komuniteteve të tjera pakicë.⁹⁶

Në fokus grupin, të mbajtur në Kotorr më 20 maj 2009, shumica e pjesëmarrësve kanë qenë të pakënaqur me punën e RTMZ dhe hapësirën e cila u jepet kroatëve. Një nga pjesëmarrësit ka thënë se “kur punohen emisionet për Kotorrin, askund nuk përmendet

93 Përgjigjet e Nikolla Donçiq në pyetësor, datë 23 qershor 2009 ndodhen në dokumentacionin e Iniciativës

94 Përgjigjet e Maria Vuçinoviç, datë 9 korrik 2009 ndodhen në dokumentacionin e Iniciativës

95 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me Bogiq Rakoçeviqin, shiko lart 28

96 *Ibidi*

pakica kroate, pa marrë parasysh se ajo ka pasur një rol të madh në zhvillimin e kësaj kulture. Nuk përmendet populli kroat. Thjeshtë, e gjithë kjo pakëtohet si kulturë malazeze. Kur përmendet muzeu, thuhet “muzeu malazez” dhe çfarëdo tjetër që përmendet dhe, nëse ka të bëjë me kroatët, vendoset në kuadër të ndonjë “kulture malazeze”. Sidoqoftë do të duhej që të përmendeshim edhe ne.⁹⁷

Mirëpo, janë dëgjuar edhe qëndrime të kundërta. Një nga pjesëmarrësit ka thënë: “Mund të gjejmë mjaft vërejtje dhe lëshime, për secilin gjithëherë ka diçka që e intereson. Mendoj se tematikat janë të përgjithshme dhe se fitohen profile të ndryshme. Ekziston shkëmbimi i informacioneve në mes të televizionit të Kroacisë dhe TVMZ dhe mund të ri programohen gjëra të caktuara nga të dy anët. Përvoja jonë flet se kjo është e mundshme, sepse kemi nisur me disa emisione në TVMZ dhe nuk kemi hasur në pengesa”.⁹⁸

Kur është fjala për besueshmërinë ndaj Radio Kotorrit, pjesëmarrësit kanë vlerësuar pozitivisht këtë shërbim publik lokal, duke theksuar se kënaq nevojat e tyre dhe se është i hapur për të gjitha idetë dhe mendimet.

Gazetarja në këtë shërbim publik, Radio Kotorr, Jellena Klajiq i deklaroi hulumtuesit të Iniciativës se në këtë radio janë në përdorim gjuha malazeze, rome, italiane dhe se radioja ka një redaksi të përgjithshme.⁹⁹ Klajiq ka përmendur se emisionet që Radio Kotorri është i obliguar t’i realizojë: “Çdo ditë pune kemi nga një emision të Shërbimit publik. Këto janë emisionet që jemi të detyruar t’i realizojmë. Pra, të hënave kemi emisionin për sportin, të martave për kulturën, të mërkurave kemi emisionin për administratën, i cili u dedikohet shërbimeve të komunës, të enjteve kemi emisionin nga bota e shkencës, të premteve “Svetlost zvuka (Ndriçimi i zërit)”, që u dedikohet personave të verbër, të shtunave kemi emisionin për arsimin dhe të dielave kemi emisionin që u dedikohet fëmijëve të moshës parashkollore, emisionin për ekologjinë dhe disa emisione të karakterit zbavitës. Çdo ditë emitojmë emisionin ‘Grad i vi (Qyteti dhe ju)’ në programin e të cilit lidhen dëgjuesit, shpalosin problemet e veta dhe shtrojnë pyetje, kurse në pastaj ftojme personat përgjegjës dhe vërtetojmë se a do t’i zgjidhin këto probleme dhe kur.”¹⁰⁰

Në pyetjen se a ekziston në Radio Kotorr emision i posaçëm që flet për kulturën, traditën dhe mënyrën e jetës së pakicave, Klajiq u përgjegj: “Kemi emisionin ‘Boka në zemrën time’, i cili emitohet të shtunave prej orës dhjetë dhe zgjat rreth gjysmë ore. Emisioni merret me kulturën dhe traditën e Bokës së Kotorrit. Pakicat nuk janë motivi kryesor i këtij emisioni, por kjo çështje gërshetohet përmes tërë emisionit. Më tepër ka të bëjë me traditën e Bokës, se sa është e lidhur me pakicat. Mirëpo, bëhet fjalë edhe për këtë. Pastaj, kemi emisionin për komunitetin italian në Kotorr dhe emisionin për romët, të cilin e punojmë në bashkëpunim me Qendrën demokratike të romëve. Më parë edhe ne vetë kemi realizuar emisionin për romët”.¹⁰¹

97 Raporti nga grupi i fokusit i mbajtur në Kotor më 20 maj 2009

98 *Ibidi*

99 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me Jellena Klajiq, gazetare e radio Kotorrit, e realizuar më 24 shtator 2009 gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

100 *Ibidi*

101 *Ibidi*

Krahas shërbimit lokal publik, Radio Kotorit, në Kotor ekziston edhe radioja private, Radio Skalle. Mendimet e pjesëmarrësve kanë qenë divergjente me rastin e krahasimit të këtyre dy radiove lokale. Përderisa Radio Kotorri në të gjitha krahasimet është vlerësuar pozitivisht, qëndrimet ndaj radios private, Radio Skalle kanë qenë divergjente, prej pozitive deri negative.¹⁰²

Kur është fjala për besueshmërinë ndaj shërbimit publik nacional RTMZ, si konkurrent kryesor është përmendur Televizioni “Vijesti”, të cilit pjesëmarrësit i besojnë më shumë. Ata kanë theksuar se rregullisht përcjellin Radio Televizionin Kroat (HRT).

Qortimi më i madh i cili në grup të fokusit i është drejtuar shërbimit publik RTMZ është ndikimi dhe pjesëmarrja në ‘nxitjen e luftës’ në vitet nëntëdhjetë. Kanë theksuar nevojën që vetë shërbimi publik i RTMZ të nisë aktivitetet që do të kishin për qëllim të përcaktojnë se kush është përgjegjës për politikën e tillë të këtij mediumi, në mënyrë që udhëheqësit e sotëm të distancohen nga kjo periudhë dhe veprimtari e tillë e RTMZ, por edhe të garantohet se një gjë e ngjashme askurrë më nuk do të ndodhë.¹⁰³

Megjithatë, pjesëmarrësit vënë re përparime teknike, kadrovike dhe programore në punën e RTMZ në pesë vitet e fundit.¹⁰⁴ Vërehet edhe vullneti i mirë që pakicat të prezantohen në shërbimet publike, por shtohet se edhe pa këtë vullnet, ligjet dhe aktet e tjera obligojnë në një gjë të tillë.¹⁰⁵

Si një nga arsyet pse nuk ka përmbajtje të mjaftuara për kroatët, është përmendur mes tjerash se edhe vetë kroatët nuk janë mjaft të interesuar të fitojnë atë që u takon me ligj.¹⁰⁶ Mungesa e aktivizimit të vetë kroatëve, sipas mendimit të njërit nga pjesëmarrësit, është bile edhe arsyeja më e rëndësishme e një situatë të tillë.¹⁰⁷

Ai theksoi se do të duhej që ata t’u sigurojnë shtëpive mediatike bashkëbiseduesit dhe temat, kurse mediat nuk do të refuzojnë këtë dhe shtoi:”mendoj se jemi ne ata që duhet të luftojmë për të drejtat e veta dhe për hapësirë në shërbimet publike“.¹⁰⁸

Përgjigjet në pyetjen “A është për momentin , i nevojshëm emisioni informativ në gjuhën kroate apo emisioni për kulturën, historinë, traditën dhe mënyrën e jetës së kroatëve në shërbimin publik?“, kanë qenë të ndara.¹⁰⁹ Gjysma e pjesëmarrësve kanë theksuar se ka shumë kohë që dëshirojnë emisionin informativ në gjuhën e vet dhe se duhet futur. Gjysma tjetër e pjesëmarrësve kanë deklaruar se për ta janë më të rëndësishme emisionet për kulturën, historinë dhe traditën e kroatëve duke u nisur nga arsyeja se gjuha kroate është e ngjashme (e afërt) me gjuhën malazeze dhe se në këtë mënyrë mund të informohen pa pengesa.¹¹⁰ Pjesëmarrësit kanë qenë të vendosur, se sikur të fillohet me emitimin e një

102 *Ibidi*

103 Raporti nga fokus grupi i mbajtur ne Kotor, shih 97

104 *Ibidi*

105 *Ibidi*

106 *Ibidi*

107 *Ibidi*

108 *Ibidi*

109 *Ibidi*

110 *Ibidi*

emisioni të tillë në RTMZ, do të ishte mirë të ishte kualitative ose më mirë përndryshe edhe të mos ekzistonte fare.¹¹¹

Nikolla Donçiq porositi: “Të gjithë popujt pakicë në Mal të Zi, kur është fjala për vullnetin e drejtuesve të shërbimeve të medieve publike, janë të përfaqësuar në mënyrë të njëjtë, e kjo do të thotë – në masë të pamjaftueshme. Situata është e qartë, nëse ekziston vullneti për avancimin e përfaqësimit mediatik të popujve pakicë, shërbimet mediatike publike, duke zbatuar praktikën e komuniteteve të zhvilluara evropiane, duhet vetëm të shfrytëzojnë mundësitë ekzistuese teknike dhe financiare me qëllim që të krijohen përmbajtje programore më kualitative “.¹¹²

Përfundimet

- Nuk ekziston pajtueshmëria e përfaqësuesve të popullit kroat në Mal të Zi dhe pjesëmarrësve të grupit të fokusit, nga njëra anë dhe redaksisë së RTMZ lidhur me karakterin, kualitetin dhe sasinë e programeve që ofrohen për kroatët, nga ana tjetër. Në shërbimet publike nuk ekziston emision i veçantë për kroatët, por përmbajtjet që kanë të bëjnë me ata emitohen në kontekst me përmbajtjet e tjera.

- Në shërbimet publike nuk ekziston emisioni informativ në gjuhën kroate. Gjysma e pjesëmarrësve të grupit të fokusit kanë vlerësuar se emisioni i tillë duhet të ekzistojë.

- Pjesëmarrësit kanë vlerësuar pozitivisht punën e shërbimit publik lokal, Radio Kotorit, për arsye se janë të mendimit se ky medium është i hapur për mendime, ide dhe vlera të ndryshme. Në Radio Kotor ekzistojnë emisione për Romën dhe Italianë, por jo edhe për kroatët, që përbëjnë një numër të konsideruar të banorëve të Kotorrit.

- Vlerësimi i përgjithshëm është se ekziston përparim në punën e RTMZ në pesë vitet e fundit. Si kritikë më të madhe pjesëmarrësit kanë theksuar faktin se RTMZ vetë nuk ndërmerr iniciativë të hapë çështjen e përgjegjesisë për ndikimin në veprimet veta gjatë luftërave të viteve nëntëdhjetë.

111 *Ibidi*

112 Përgjigjet e Nikolla Donçiqit në pyetësor, shiko lart 93

Rekomandimet

- Në shërbimet publike lokale dhe nacionale duhet të fillojë emitimi e emisioneve të veçanta të cilat në mënyrë kulturologjike dhe historike do të prezantonin kroatët në Mal të Zi. Në përpilimin e emisioneve të tilla duhen konsultuar specialistët e këtyre fushave, si dhe përfaqësuesit e kroatëve në Mal të Zi.
- Themeluesit e shërbimeve publike, posaçërisht atyre në komuna në të cilat jeton një numër i konsideruar i kroatëve, duhet të marrin parasysh nevojat reale për informim në gjuhën kroate në Mal të Zi përmes komunikimit me popullatën kroate, me rastin e marrjes së vendimeve për financimin e përmbajtjeve informative.
- Radio Kotori duhet të fillojë emetimin e emisioneve të veçanta për kroatët dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në integrimin më të mirë të popullatës kroate në Komunën e Kotorrit dhe në tërë Malin e Zi.
- Shërbimet publike duhet t'i kushtojnë më tepër kujdes programeve dhe raporteve nga fusha e ballafaqimit me të kaluarën.

V Romët

Në Mal të Zi gjithsej ka 2 601 (0,42 %) romë¹¹³. Më shumë romë jetojnë në Podgoricë 1 389 (0,82%), pastaj në Nikshiq 335 (0,44%), Herceg Novi 198 (0,60%), Cetinjë 129 (0,70%), Ulqin 115 (0,57%), Bijello Pole 133 (0,26%), Beranë 119 (0,34%), Budvë 39 (0,25%) dhe Kotor 48 (0,21%). Në qytetet e tjera numri i romëve është më i vogël se 0.20%. Numri i romëve që janë persona të zhvendosur në Mal të Zi është 4 458,¹¹⁴ gjegjësisht dyfish më i madh se sa numri i romëve vendas.

Senad Sejdiviq, i vetmi rom i cili është i angazhuar me honorar në TVMZ, theksoi se problemi më i madh është mungesa e kuadrove nga radhët e romëve, prandaj kjo gjë i shkakton vështirësi të mëdha në realizimin e përmbytjeve në gjuhën rome.¹¹⁵

Hulumtuesi i shkëljes së të drejtave të njeriut Goran Miletqi, në intervistën me hulumtuesin e Iniciativës, tha se problemi i mungesës së kuadrove ekziston një kohë të gjatë dhe se situata ka qenë e njëjtë edhe në vitin 2003, kur ka bërë hulumtimin në Mal të Zi.¹¹⁶

Në TVMZ realizohet një emision në radio, kurse prej 4 muajsh edhe një emision televiziv.¹¹⁷ Radio emisioni emetohet çdo pesëmbëdhjetë ditë, përderisa emisioni në televizion shkon çdo të premte të parë në muaj. Këto emisione flasin për pozitën materiale të romëve, por edhe për kulturën e tyre, traditën dhe mënyrën e jetesës. Në radio emisionet emitohen në dy gjuhët, më shpesh në varësi se a është bashkëbiseduesi dikush që nuk është rom dhe nuk e di gjuhën rome. Për emisionin në TVMZ është siguruar tili.¹¹⁸

Sejdiviq tha se nuk ka emision informativ në gjuhën rome, por një herë në muaj, në ditarin kryesor të TVMZ, që fillon në 19:30, emitohet një përmbytje në gjuhën rome, e cila përkthehet me titël në gjuhën malazeze.¹¹⁹

Sejdiviq është i mendimit se është me interes të madh fillimi i emitimit të emisionit informativ në Shërbimin Publik të RTMZ

Drejtori i Radio Antena M, që emiton emisionin “Romët flasin“, Darko Shukoviq, mendon se për romët kjo nuk është çështje notore, por nevojë e cila është shumë më

113 Enti i Statistikës i Malit të Zi, shiko lart 17

114 Sondazhi/ Hulumtimi mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Mal të Zi, UNHCR, Podgoricë, maj 2009

115 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me gazetarin e RTMZ, Senad Sejdiviqin, datë 15 tetor 2009 gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

116 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me Goran Miletqin, datë 16 shtator 2009, gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

117 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me gazetarin e RTMZ, Senad Sejdiviqin, shiko lart 115

118 Ibidi

119 Ibidi

tepër e theksuar se sa tek bashkësitë e tjera dhe shton: „Në ofertën e dobët duhet me kujdes të veçantë të zgjidhen kuadrot që kanë nivel të nevojshëm të arsimimit dhe dëshirë të sinqertë të kontribuojnë në përparimin e komunitetit.¹²⁰

Shukoviq deklaroi se pjesa më e madhe e përmbajtjeve duhet të jetë në gjuhën rome, mirëpo është e vështirë të mënjanohet, nëse fare duhet, segmentet e caktuara në gjuhën malazeze. “Programi duhet koncipuar ashtu, që të paktën pjesërisht, të jetë interesant edhe për komunitetet e tjera, sepse me një gjë të tillë kontribuohet në mirëkuptimin dhe bashkëjetesën më të mirë me popullatë REA. Muzika, filmat të cilët kanë për temë jetën e romëve, zakonet, historinë, personalitetet me famë e të cilët kanë prejardhje rome, të kombinuara me edukimin, problemet sociale dhe ekonomike, histori nga jeta e përditshme e romëve, paraqesin një kornizë për program të mirë, i cili mund t’i shërbejë realizimit të qëllimit”, - tha Shukoviq.¹²¹

Kryetari i OJQ-së Qendra Demokratike e Romëve, Ivan Toskiq, tha se nën organizimin e kësaj Qendre emitohe radio emisione në gjuhën rome në shërbimet publike lokale, RadioTivar, Radio Tivat, Radio Kotor dhe Radio Nikshiq, si dhe në kuadër të programit të Radio Cool nga Podgorica.¹²²

Këto emisione po ashtu flasin për problemet e romëve, kulturën e tyre, traditën, arsimin, punësimin dhe mënyrën e jetesës. Në grupin e fokusit, i cili është mbajtur më 11 maj 2009 në Podgoricë, kanë marrë pjesë pjesëtarët e kombësisë rome. Pjesëmarrësit e grupit të fokusit në nivel mesatar përcjellin programet e shërbimeve publike, prej një deri në katër orë. Pjesëmarrësit kanë theksuar se shumë më tepër përcjellim Televizionin e Malit të Zi (TVMZ). Si motiv, kanë përmendur se TVMZ, për vetë faktin se televizioni është më interesant se radioja, ka emisione më të mira, por edhe për faktin se në RMZ nuk ka muzikë rome, të cilën do të dëshironin të dëgjojnë. Një nga pjesëmarrësit ka thënë: “Unë më tepër dëshiroj të shikoj emisionet për romët. Pastaj shikoj ditarin. Prej një deri dy orë në ditë shikoj TVMZ, përderisa RMZ e dëgjoj shumë pak. Kam dëshirë të dëgjoj muzikën tonë. Mirëpo, në RMZ nuk ka muzikë nga e jona”.¹²³

Një nga pjesëmarrësit ka thënë se kur është fjala për romët, mediet flasin vetëm për pozitën sociale dhe materiale në shoqëri, përmes prizmit të romëve që janë refugjatë dhe situata e tyre materiale është më e pavolitshme në raport me romët vendas, pa marrë parasysh vlerat e romëve si popull, por vetëm statusin e tyre material. Është e nevojshme të emitohe emisione të cilat flasin për kulturën, traditën dhe jetën e Romëve, të cilat mund t’i prezantojnë në mënyrë më të mirë dhe të zvogëlojnë paragjykimet e popujve të tjerë ndaj tyre. Kështu, njëri nga pjesëmarrësit ka thënë: “Shikoj ditarin dhe kam dëshirë të shikoj emisione për natyrën. Përveç kësaj, më interesojnë emisionet për romët, edhe pse shumë shpesh emisionet e tilla më shkaktojnë dhimbje, sepse tregojnë romët në një mënyrë shumë të keqe. Pasqyrojnë vetëm romët më të varfër. Fëmijët i lëshojnë lakuriq të lozin nëpër baltë para kamerave. Tregojnë mbeturinat përreth shtëpive tona. Mendoj që mediumet, qofshin ato të shkruara apo elektronike, do të

120 Përgjigjet e Darko Shukoviqit të datës 13 tetor 2009 të cilat gjenden në dokumentacionin e Iniciativës

121 *Ibidi*

122 Përgjigjet e Ivan Toskiqit në pyetësorin e dorëzuar më 6 korrik 2009, i cili gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

123 Raporti nga grupi i fokusit të mbajtur në Podgoricë, më 11 maj 2009

duhej të transmetonin përmbajtje më të mira për ne. Ekzistojnë shumë shembuj të mirë dhe pozitivë për t'u treguar, e jo vetëm ato më të shëmtuarat dhe ata çdo herë. Tregojnë romët të cilët janë refugjatë, njerëzit që kanë lënë çdo gjë që kanë pasur dhe kanë ardhur këtu pa asgjë. Ata nuk mund të mos jenë të varfër, dhe kjo më shkakton dhimbje dhe më ofendon.¹²⁴

Pjesëmarrësi tjetër ka thënë: “Do të dëshiroja që në TVMZ të emitohen emisione për romët, të cilat do zgjatnin të paktën njëzet minuta dhe që gjithherë nuk do të na trajtonte në kontekst negativ, sepse për ne ka shumë gjëra pozitive. Ne kemi kulturë të bukur. Unë vërej një mëvetësi të kësaj shoqërie, të tillë që thjeshtë nuk na lë hapësirë që të afirmohemi“.¹²⁵

Përmbajtjet që pjesëmarrësit e këtij grupi të fokusit përcjellin dhe dëshirojnë t'i përcjellin dallojnë nga interesimet e pjesëmarrësve të fokus grupeve të tjera, për faktin se të gjithë pjesëmarrësit, pa marrë parasysh strukturën e moshës, tregojnë interesim për programin zbavitës të bazuar në traditën e tyre. Kështu një nga pjesëmarrësit ka deklaruar: „Kënga dhe vallëzimi është diçka prej së cilës romët jetojnë, ky është për ta ushqimi i shpirtit, por gjëra të tilla nuk ka ose prezantohen shumë pak“.¹²⁶

Besueshmërinë ndaj medimeve, pjesëmarrësit e kanë matur në bazë të asaj se sa përmbajtje dhe hapësirë u jepet atyre si komunitet dhe në bazë të kësaj medimet kënaqin interesimet e tyre.

Kanë vlerësuar se televizioni “Atlas” ka realizuar një emision të mirë me rastin e festës së romëve, ditës së Shën Gjergjit dhe kanë vendosur këtë televizion para TVMZ. Një nga pjesëmarrësit ka thënë: “TV Atlas ka emituar emisionin për romët me rastin e ditës së Shën Gjergjit dhe e ka emituar dy herë. Shumë mirë e kanë punuar dhe për këtë kam më shumë besim në këtë televizion se sa në shërbimin publik“.¹²⁷

Pjesëmarrësit kanë theksuar se më tepër përcjellin televizionet komerciale se sa shërbimin publik për arsye se kanë program argëtues më të mirë dhe ndër to, vendin më të rëndësishëm zë TV Pink. Përmes satelitit (operatorëve me kablllo) pjesëmarrësit përcjellin medimet nga vendet e rajonit në të cilat informohen në gjuhën rome. Si shembuj kanë përmendur medimet nga Serbia, Maqedonia dhe Bullgaria. Pjesëmarrësit kanë theksuar se TVMZ mund të kontribuojë në integrimin e tyre më të shpejtë në shoqëri, përmes realizimit të emisioneve për studentët romë, kulturën rome, traditën dhe përmbajtje të tjera me të cilat, sipas mendimit të pjesëmarrësve, do të zvogëloheshin paragjykimet për ta.¹²⁸

Pjesëmarrësit janë të mendimit se në integrimin e tyre në shoqëri dhe posaçërisht procesin e arsimimit, TVMZ mund të luajë një rol të rëndësishëm, dhe me këtë të lehtësojë të gjitha vështirësitë konkrete me të cilat nga dita në ditë ballafaqohen. TVMZ mund të luajë këtë rol në mënyrën më të mirë përmes komunikimit me popullatën rome, mendojnë pjesëmarrësit. Një nga pjesëmarrësit ka thënë: “Më shumë u besoj medimeve private, kurse mendoj se njerëzit do të duhej më tepër t'i besonin televizionit shtetëror. Shteti deri më tani nuk i kthehet mjaft popullatës rome përmes këtij televizioni dhe mendoj se numri më i madh i romëve do t'u besojë më tepër medimeve private se sa televizionit shtetëror. Ajo çka do të dëshironin romët

124 *Ibidi*

125 *Ibidi*

126 *Ibidi*

127 *Ibidi*

128 Distanca etnike në Mal të Zi, CEDEM. Podgoricë, prill 2007

të shikojnë, nuk është prezent në TVMZ, çka do të thotë se nuk jemi të përfaqësuar në shoqëri dhe në asnjë segment¹²⁹.

Pjesëmarrësit kanë theksuar se duhet bërë dallimi mes kategorive siç janë pakicat nacionale dhe refugjatët me rastin e realizimit të përmbajtjeve të caktuara në shërbimin publik, sepse me këtë më shpesh përmbajtjet kanë të bëjnë me kushtet e vështira të jetesës së romëve, të cilët kanë ardhur në Mal të Zi refugjatë për shkak të luftës në Kosovë. Është e nevojshme që të sigurohet më tepër hapësirë për përmbajtjet që flasin për kulturën, traditën dhe mënyrën e jetesës së romëve. Romët mendojnë se TVMZ duhet t'i kushtojë më shumë kujdes fëmijëve dhe grave të tyre. Një nga pjesëmarrësit mendon se duhet të ketë më shumë emisione për fëmijët romë të cilat do t'i nxisinin të regjistrojnë dhe frekuentojnë shkollën. Sipas fjalëve të tyre, emisionet e tilla do të ishin shumë të shikuara nga popullata rome, posaçërisht, nëse flasin për atë se si dhe çka mund të punojnë, se si mund të kenë jetën e vet dhe kur të mbarojnë shkollën si të fitojnë punën.¹³⁰

Pjesëmarrësit kanë vlerësuar se Shërbimi Publik RTMZ ka përparuar në raport me pesë vite më parë dhe mendojnë se duhet punuar më shumë në përmirësimin e situatës kur është fjala për romët, para se gjithash në drejtim të informimit në gjuhën e tyre amtare. Qortimi më i madh ka të bëjë me atë se kryesisht të gjitha emisionet për ta çojnë në paraqitjen e kushteve të tyre të vështira të jetesës, prandaj sipas mendimit të tyre, në këtë mënyrë edhe më shumë rritet distanca. Ata sidoqoftë janë të kënaqur me raportin e RTVMZ, sepse asnjëherë nuk kanë dëgjuar fjalë fyese, siç ka qenë rasti me një televizion privat.

Një pjesëmarrës ka shprehur pakënaqësinë dhe dyshimin se është ndryshuar diçka në punën e RTVMZ dhe ka shtuar se këtë televizion gjërat do të jenë të njëjta derisa të mos fillojnë të punësohen fëmijët e tyre.¹³¹

Vesel Beganaj nga Koalicioni i OJQ-ve, është i mendimit se përparimi është arritur, por duhet punuar edhe më shumë me qëllim përfaqësimi më të mirë të përmbajtjeve për pakicat. Beganaj tha: “Përveç pakicës shqiptare në Mal të Zi, asnjë pakicë nuk mund të jetë e kënaqur me Shërbimin Publik të RTMZ, e posaçërisht pakica rome, e cila plotësisht është e anashkaluar nga i tërë ky proces”.¹³²

Kryetari i Këshillit të romëve dhe egjiptianëve Isen Gashi, ka theksuar se vihet re përparimi i RTMZ në kohën e fundit, mirëpo ende ofrohen shumë pak përmbajtje. “Fatkeqësisht, ende asnjë medium nuk kënaq nevojat tona, konkretisht, kemi një emision prej gjysmë ore çdo pesëmbëdhjetë ditë në Radion e Malit të Zi, çka nuk mjafton për të afirmuar identitetin nacional dhe kulturor të romëve në Mal të Zi”, -deklaroi Gashi.¹³³

Ai shtoi se pakicat duhet të jenë të përfshira në mënyrë aktive në punën e shërbimit publik përmes pjesëmarrjes në Këshillim e RTMZ, me qëllim që në mënyrë më të mirë të hartohet strategjia për mënyrën e raportimit mbi pakicat.

129 Raport nga grupi i fokusit të mbajtur në Podgoricë, 11 maj 2009, shiko larë 123

130 *Ibidi*

131 *Ibidi*

132 Përgjigjet e Vesel Beganajt në pyetësorin e datës 23 qershor 2009, gjenden në dokumentacionin e Iniciativës

133 Përgjigjet e Isen Gashit në pyetësorin e datës 23 qershor 2009, gjenden në dokumentacionin e Iniciativës

Përfundimet

- Në shërbimet publike në Mal të Zi nuk ekziston programi informativ në gjuhën rome. Në RTMZ dhe një numër të shërbimeve publike lokale Radio Tivar, Radio Tivat, Radio Kotor dhe Radio Nikshiq emitojnë emisionet për kulturën, traditën dhe jetesën e romëve çdo pesëmbëdhjetë ditë.

- Asnjë gazetar i kombësisë rome nuk ka punësim të përhershëm në shërbimet publike. Një gazetar është i punësuar si bashkëpunëtor me honorar në RTMZ. Problemin më të madh e paraqet mungesa e kuadrove mes romëve ose gazetarëve, të cilët në mënyrë aktive flasin gjuhën rome.

- Kur është fjala për emisionet dhe përmbajtjet që flasin për romët, theksi më shpesh vihet në pozitën materiale, çka edhe më tepër shton distancën etnike ndaj këtij komuniteti nacional.

Rekomandimet

- Themeluesit e Shërbimit Publik Nacional të RTMZ dhe shërbimet publike lokale në ato komuna ku romët jetojnë në numër të konsideruar, duhet me kontratën për financim të përfshijnë edhe emisionet informative në gjuhën rome.

- Institucionet kompetente shtetërore duhet të investojnë mjete shtesë për edukimin e kuadrove, pjesëtarëve të pakicës rome, në mënyrë që të kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve të gazetarëve. Shërbimet publike duhet të parashikojnë me sistematizim një numër të caktuar vendesh pune për gazetarët pjesëtarë të popullatës rome. Në redaksitë për programin në gjuhët e pakicave është e nevojshme që të përfshihen edhe përfaqësuesit romë. Nevojitet një aksion i më i gjerë i shtetit, i cili do të drejtohej në drejtim të krijimit dhe të rritjes së kapaciteteve, të cilat do të prodhonin programe për romët dhe në gjuhën rome.

- Përmbajtjet programore të cilat janë të parapara për romët duhet të flasin më shumë për kulturën, arsimin, traditën, sportin dhe argëtimin me qëllim të zvogëlimit të distancës etnike në Mal të Zi e cila sipas sondazheve relevante është më e madhe në raport me romët.

VI Serbët

Në Mal të Zi ka 198 414 ose 31,99% serbë. Pothuajse në të gjitha qytetet, serbët përbëjnë më shumë se 20% të popullatës, përveçse kur është fjala për qytetet si: Cetinjë, Ulqin, Rozhajë dhe Plavë.

Kur është fjala për këtë pjesë të hulumtimit, hulumtuesit e Iniciativës kanë vendosur të hulumtojnë se a janë serbët të përfaqësuar mjaft në shërbimet publike, edhe pse përfaqësuesit e këtij komuniteti nacional në parlament janë të mendimit se nuk u takojnë pakicave në Mal të Zi. Mirëpo, për shkak të formimit të Këshillit Nacional Serb, sipas Ligjit për të Drejtat e dhe Liritë e Pakicave, të cilin e ka formuar secila pakicë nacionale në Mal të Zi, kemi bërë hulumtimin për arsye se tregon në faktin se një pjesë e qytetarëve të kombësisë serbe e shohin vetën si pakicë në Mal të Zi. Në intervistën, që hulumtuesi i Iniciativës ka bërë me kryeredaktorin dhe redaktorin përgjegjës të RTV Plevla, Milivoje Iriq, ai ka deklaruar se RTV Plevla funksionon si shërbim radiodifuziv publik prej vitit 2006. Ky medium ka rreth 35 të punësuar.¹³⁴

Kur është fjala për përmbajtjet, Iriq tha se RTPV përcjell ngjarjet që kanë të bëjnë me ngjarjet politike, kulturë, sport dhe shoqëri. Gjithashtu, rregullisht përcillen edhe ngjarjet e të gjitha komuniteteve fetare në Plevlë. Sa i përket kërkesave të veçanta të ndonjërit nga komunitetet pakicë në Plevlë, Iriq tha se nuk ka pasur interesim dhe kërkesa të veçanta, por RTPV përcjell përmbajtjet e të gjitha komuniteteve nacionale në Plevlë. “Pohoj se shikueshmëria jonë është shumë e madhe dhe këtë e di si profesionist. Nëse dikujt diçka nuk i ka pëlqyer, menjëherë kemi pasur telefonatë. Kemi pasur raste që shikuesve diçka nuk u ka pëlqyer dhe menjëherë na kanë marrë në telefon dhe kanë reaguar. Ne jemi të kënaqur, sepse shikueshmëria, për mediumet, është gjithçka. Nuk shkojmë me çdo kusht në senzacion të lirë, nuk kemi pasur raste që dikush të ngrrejë padi kundër nesh. Ndoshta nuk i pëlqen se si e kemi paraqitur ndonjë ngjarje dhe nuk kemi pasur rezultate të hulumtimeve, por nga përvoja dimë se emisioni ynë informativ që shkon në ora 19⁰⁰ është i shikuar shumë dhe njerëzit reagojnë. Njerëzit paraqiten nëse diçka u ka pëlqyer ose nuk u ka pëlqyer, çka për profesionin tonë është me rëndësi të madhe - sepse kemi shikueshmëri të madhe” - tha Iriq.

Në grupin e fokusit të mbajtur në Plevlë¹³⁵, pjesëmarrësit kanë theksuar se më shumë përcjellin TV programet e tjera, për arsye se janë më kualitative se sa ato në shërbimet publike. Sidoqoftë, prej shërbimeve publike më së tepërmi përcjellin TV Plevla, kurse në

134 Nga intervista e hulumtuesit të Iniciativës me Milivoje Iriqin, kryeredaktorin e dhe redaktorin përgjegjës të RTV të Plevlës, datë 18 shtator 2009, i cili gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

135 Raporti nga grupi i fokusit në Plevlë, mbajtur më 25 maj 2009, gjendet në dokumentacionin e Iniciativës

veçanti Kronikën e Plevlës. Sa i përket programit të TVMZ edhe pse pak, pjesëmarrësit më shpesh përcjellin emisionet informative, politike, sportive dhe emisionet me karakter arsimor.¹³⁶

Pjesëmarrësit kanë deklaruar se shumë pak u besojnë medimeve në Mal të Zi, por sidoqoftë, më tepër u besojnë medimeve private dhe atyre lokale, për arsye se janë më pak nën kontrollin e pushtetit. Mediumet lokale në Plevlë financiarisht varen nga fondet shtetërore, prandaj një nga pjesëmarrësit është i mendimit se nuk ka gazetari kritike dhe raporte kualitative.

“Edhe unë kam më shumë besim në mediumet lokale. Të gjithë ne jemi nga pak patriotë. Ne nuk mund të ndikojmë në politikën redaktuese as të njërave, as të tjerave, mirëpo sidoqoftë diçka më tepër mund të ndikojmë në mediumet lokale sesa në ndonjë medium shtetëror”, - theksoi njëri nga pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit kanë vlerësuar se mungon programi kualitativ dhe gazetaria kritike edhe TVMZ ka shumë më tepër gazetarë në krahasim me mediumet e tjera në Mal të Zi. Kur është fjala për kishën, serbët dhe Mitropolia Malalezezo- Bregdetare, sipas mendimit të njërit nga pjesëmarrësit, janë të papërfillura, të lëna pas dore, diskriminuara dhe kundër tyre tregohet urrejtje në shërbimin publik. Kur është fjala për fushat e tjera, serbët po ashtu janë të lënë pas dore. As letërsia dhe format e tjera të kulturës nuk paraqiten, si dhe ngjarjet nga skena e muzikës. Pjesëmarrësit janë shumë më të kënaqur me shërbimin publik të Serbisë RTS, se sa me radion dhe televizionin e Malit të Zi, sepse mendojnë se RTS prodhon emisione më kualitative, seriale siç janë kuizet, emisionet me karakter edukativ dhe se mediumet nga rajoni janë më objektive. Përmes futjes së ngjarjeve edukative, gazetarisë së pavarur dhe ndryshimit të politikës redaktuese do të përmirësohej kualiteti dhe shikueshmëria e RTMZ.

Redaktori i web-portalit In4S Gojko Raiçević theksoi se në shërbimin publik nuk janë prezent krijuesit e komunitetit nacional serb. “Situata është e ngjashme dhe kur flasim për kohën që u dedikohet grupeve nacionale. Komuniteti shqiptar ka, në përputhje me numrin e tyre, pak hapësirë në RTMZ, por përsëri më shumë në krahasim me serbët, që janë prezent me një numër më të madh”, - theksoi Raiçević. Struktura e Këshillit të TV dhe organeve që vendosin për realizimin e programit nuk të lë përshtypje se situata do të përmirësohet.

Kryetari i Këshillit Nacional Serb të Malit të Zi, Momçillo Vuksanović deklaroi se serbët nuk janë të përfaqësuar në programet e shërbimit publik dhe se çdo vështrim në komunitetin nacional serb transmetohet në kontekst negativ.¹³⁷

“Përfaqësimi nacional nuk do të duhej ishte kriter i sukseseve të TVMZ, por do të duhej të ishte respektimi i standardeve profesionale”, - tha Sllavisha Guberiniq.¹³⁸

136 *Ibidi*

137 Përgjigjet e Momçillo Vuksanovićit në pyetësin e datës 6 korrik 2009, ndodhet në dokumentacionin e Iniciativës

138 Përgjigjet e Sllavisha Guberiniqit në pyetësin e datës 7 korrik 2009, gjenden në dokumentacionin e Iniciativës

Përfundimet

- Përfaqësuesit e komunitetit nacional serb, që kanë marrë pjesë në hulumtim kanë deklaruar se nuk kanë besim në RTVMZ. Prej shërbimeve publike më tepër kanë në RTV Plevla
- Me qëllim që të plotësojnë nevojat për informim, pjesëmarrësit e grupit të fokusit kanë theksuar se përcjellin programet televizive të shteteve fqinje, sidomos të Serbisë.
- Të anketuarit janë të mendimit se Kisha ortodokse serbe dhe kultura serbe janë të lëna pas dore dhe se janë të diskriminuara.

Rekomandimet

- RTVMZ do të duhet të rrisë besueshmërinë e komunitetit nacional serb në Mal të Zi përmes informimit më objektiv të opinionit.
- Shërbimet publike do të duhej të emitojnë më shumë emisione për kulturën, religjionin dhe zakonet e pjesëtarëve të komunitetit nacional serb.
- Diskriminimi në bazë të fesë dhe nacionalitetit nuk duhet të jetë prezent në Shërbimet publike në Mal të Zi, por duhet tentuar që Shërbimet publike të jenë shërbime për të gjithë qytetarët e Malit të Zi.

VII Zbulimet e përgjithshme të sondazhit/hulumtimit

- Legjislacioni malazez, Kushtetuta e Malit të Zi, Ligji për të Drejtat e Pakicave dhe Liritë, Ligji për mediumet, Ligji për Shërbimet Radio-difuzive dhe Ligji për Radio-difuzionin ofrojnë bazë relativisht të mirë për respektimin e standardeve evropiane në këtë fushë. Mirëpo, kur është fjala për praktikën, gjegjësisht zbatimin e këtyre normave, atëherë realiteti është shumë i ndryshëm.

- Në Mal të Zi nuk ka institucion që bën monitorimin e respektimit të rregullave ligjore të kësaj fushe. ARD-ja duhet në punën e vet të fillojë me aktivitetet në këtë drejtim.

- Shteti duhet të kontribuojë me më shumë përpjekje dhe mjete për të realizuar të drejtën e informimit në gjuhët e pakicave dhe mbi kulturën dhe traditën e popujve pakicë.

- Të gjitha shërbimet publike duhet kontribuojnë me më shumë përpjekje në hartimin e programit mbi kulturën dhe traditën e pakicave.

- RTMZ emiton përmbajtje në gjuhën shqipe dhe rome, përderisa emisione në gjuhët e pakicave të tjera nuk janë të përfaqësuara. Mirëpo, pjesëmarrësit në hulumtim kanë treguar pakënaqësi lidhur me kualitetin e përmbajtjeve programore në gjuhët e tyre dhe kulturën e tyre, traditën dhe mënyrën e jetesës si dhe me punësimin e një numri të caktuar të gazetarëve, redaktorëve dhe profesionesh të tjera me pjesëtarët e popujve pakicë, sepse përfaqësimi momental i pakicave është në nivel të pakënaqshëm.

- Si arsye pse nuk ka emisione në gjuhët e pakicave të tjera, përfaqësuesit e RTMZ kanë përmendur ngjashmërinë me gjuhën malazeze.

- RTMZ emiton çdo ditë emisione informative në gjuhën shqipe, përderisa në gjuhën rome emiton deri dy herë në muaj vetëm emision për kulturën, traditën dhe jetën e romëve.

- Në nivelin lokal, shërbimet publike nuk kanë përmbajtje programore të veçanta dhe redaksi për pakicat. Përfundim bën Radio Ulqini, i cili emiton programin në përputhshmëri me strukturën e banorëve.

- Shërbimet publike lokale janë vlerësuar më mirë në raport me Shërbimi Publik Nacional, RTMZ. Informacionet, gjegjësisht përmbajtjet që emitojnë radio stacionet dhe televizionet lokale janë më interesante, kanë treguar vlerësimet e grupeve të fokusit.

- Ekziston pakënaqësi e madhe lidhur me përmbajtjen e emisioneve të cilat emitojnë Shërbimet Publike për pakicat.

Arsyet për këtë janë informacionet e vjetruara kur është fjala për programin informativ (pakica shqiptare) dhe informacionet që përforcojnë paragjykimet (pakica rome).

- Popujt pakicë në Mal të Zi kënaqin nevojat për informim edhe përmes përcjelljes së shërbimeve publike rajonale dhe programeve private.

- Këshillat nacionale fitojnë prej shtetit shuma të konsideruara të dedikuara për këtë qëllim, prandaj do të duhej që në vend të themelimit të mediumeve të reja të vendosin bashkëpunim me Shërbimin publik, me qëllim të përgatitjes së programit, i cili do t'u përgjigjej nevojave të pjesëtarëve të popujve pakicë.

VIII Bibliografia

Lista e librave dhe e raporteve të shfrytëzuara

Distanca etnike në Mal të Zi, CEDEM, Podgoricë, prill 2007

Karta evropiane mbi gjuhët rajonale dhe gjuhët e pakicave, Sfidat e zbatimit efektiv, Këshilli i Evropës, Beograd 2006

Hulumtime mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Mal të Zi, UNHCR, Podgoricë, maj 2009

Të drejtat e njeriut në Mal të Zi – 2007; Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Podgoricë, 2008

Të drejtat e pjesëtarëve të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore, Komiteti jugosllav i juristëve, Beograd 2001

Të drejtat e Serbëve në Mal të Zi, IGAM, Beograd, 2006

Rekomandimet e Llundit për pjesëmarrjen aktive të pakicave nacionale në jetën publike me arsyetimet, shtator 1999

Udhërrëfyes/Guidë nëpër medime në Mal të Zi, Ministria e Kulturës, Sportit dhe Medimeve – Sektori i medimeve, Podgoricë, 2006

Promovimi i të drejtave të pakicave, Udhërrëfyes/Guidë për OJQ-të e Evropës Juglindore, botuar në Bosnjë e Hercegovinë, botimi i reviduar, janar 2008

Lista e akteve juridike të shfrytëzuara si burim

Karta evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave

Konventa Kuadër për mbrojtjen e të drejtave të pakicave e Këshillit të Evropës, e ratifikuar dhe hyrë në fuqi me 1 shtator 2001, Gazeta zyrtare e RSJ (kontratrat ndërkombëtare) numër 6/98

Kushtetuta e Malit të Zi; faqja e internetit e Gazetës Zyrtare të Malit të Zi://www.sllrcg.co.me/001-2007.pdf, e vizituar më 15 shtator 2009

Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave; faqja e internetit e Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave <http://www.gov.me/minmanj/vijesti.php?akcija=vijesti&cid=13716>, e vizituar më 20 shtator 2009

Ligji mbi ratifikimin e Kartës Evropiane për gjuhët rajonale dhe gjuhët e pakicave (“Gazeta zyrtare SMZ – Kontratrat ndërkombëtare”, nr. 18/2005)

Ligji për mediumet, faqja e internetit e Qendrës për Profesionalizim të Medimeve <http://www.cpm.edu.yu/code/navigate.asp?Id=37>, e vizituar më 2. tetor 2009

Ligji mbi shërbimet radio-difuzive të Malit të Zi (“Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, nr. 79/08

e datës 23. 12. 2008)

Ligji për radiodifuzionin (“Gazeta zyrtare RMZ” nr. 51/02, 62/02, 46/04, 56/04, 77/06, “Gazeta zyrtare e Malit të Zi” nr. 50/08 e datës 19. 08. 2008, 79/08 e datës 23. 12. 2008, 53/09 e datës 07. 08. 2009

Lista e faqeve të internetit të shfrytëzuara si burim

Qendra për Profesionalizim të Medimeve <http://www.cpm.edu.yu>

Qendra për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut www.cedem.co.me

Instituti për medime i Malit të Zi <http://www.mminstitute.org/IN4S> <http://in4s.net/x/>

Ministria e Drejtësisë në Qeverinë e Malit të Zi <http://www.pravda.gov.me/>

Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave në Qeverinë e Malit të Zi <http://www.gov.me/minmanj>

Gazetat e para elektronike malazeze <http://www.pcnen.com/>

Radio Evropa e Lirë <http://www.slobodnaevropa.org/>

Gazeta zyrtare e Malit të Zi <http://www.sllrcg.co.me>

Qeveria e Malit të Zi www.gov.me

Enti i Statistikës i Malit të Zi <http://www.monstat.org>

Shtojcë :

**KUSHTETUTA E MALIT TË ZI
DEKLARATA E PERGJITHSHME
MBI TE DREJTAT E NJERIUT**

Duke u bazuar në:

vendimin e qytetarëve të Malit të Zi për të jetuar në shtetin e pavarur dhe sovran të Malit të Zi, të marrë në referendumin e datës 21 maj 2006; - përcaktimin e qytetarëve të Malit të Zi për të jetuar në shtetin në të cilin vlera themelore janë liria, paqja, toleranca, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, multikulturaliteti, demokracia dhe pushteti i së drejtës; vendosmërinë që si qytetrë të lirë dhe të barabartë, pjesëtarë të popujve dhe të pakicave kombëtare që jeotjnë në Malin e Zi: malazezët, serbët, boshnjakët, shqiptarët, myslimanët, kroatët dhe të tjerët, i janë përkushtua Malit të Zi demokratik dhe qytetar; bindjen se shteti është përgjegjës për ruajtjen e natyrës, të mjedisit të shëndetshëm të jetesës, të zhvillimit të qëndrueshëm, të zhvillimit të baraspeshuar të të gjitha rajoneve të tij dhe për vendosjen e drejtësisë sociale; përkushtimin ndaj bashkëpunimit mbi baza të barabarta me popujt dhe shtetet e tjera dhe me integritet europian dhe euroatlantik,

Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi në seancën e tretë të sesionit të dytë të rregullt në vitin 2007, më 19 tetor 2007 miraton

KUSHTETUTËN E MALIT TË ZI

PJESA E PARË

DISPOZITAT THEMELORE

Shteti

Neni 1

Mali i Zi është shtet i pavarur dhe sovran, me formë republikane të pushtetit.

Mali i Zi është shtet civil, demokratik, ekologjik dhe shtet i drejtësisë sociale, i bazuar në pushtetin e së drejtës.

Sovraniteti

Neni 2

Mbartës i sovranitetit është qytetari i cili ka shtetësi malazeze.

Qytetari ushtron pushtetin drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirish.

Nuk mund të konstituohet as të njihet pushteti që nuk buron nga vullneti i lirë i qytetarëve, i shprehur në zgjedhjet demokratike, në përputhje me ligjin.

Territori shtetëror

Neni 3

Territori i Malit të Zi është i pandashëm dhe i patjetërsueshëm.

Simbolet shtetërore

Neni 4

Mali i Zi ka stemën, flamurin dhe himnin.
Stema e Malit të Zi është shqiponja dykrenore me luanin në gjoks.
Flamuri i Malit të Zi ka ngjyrë të kuqe, me stemë në mes dhe me qendrisje të artë.
Himni i Malit të Zi është “Oj svijetla majska zoro”.

Kryeqyteti dhe Kryeqendra

Neni 5

Kryeqyteti i Malit të Zi është Podgorica.
Kryeqendra e Malit të Zi është Cetina.

Të drejtat dhe liritë e njeriut

Neni 6

Mali i Zi garanton dhe mbron të drejtat dhe liritë e njeriut.
Të drejtat dhe liritë e njeriut janë të pacenueshme.
Çdokush është i detyruar t'i respektojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Ndalimi i mbjelljes së urrejtjes

Neni 7

Ndalohet mbjellja apo nxitja e urrejtjes ose intolerancës mbi çfarëdo baze.

Ndalimi i diskriminimit

Neni 8

Ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë mbi çfarëdo baze.
Nuk do të konsiderohen diskriminim dispozitat ligjore dhe aplikimi i masave të posaçme që janë të përqendruara në krijimin e kushteve për realizimin e barazisë nacionale, gjinore

dhe barazisë së gjithmbarshme dhe të mbrojtjes së personave të cilët mbi çfarëdo baze janë në pozitë të pabarabartë.

Masat e posaçme mund të zbatohen vetëm derisa të jenë realizuar qëllimet për të cilat janë ndërmarrë.

Rendi juridik

Neni 9

Traktatet ndërkombëtare të konfirmuara dhe të publikuara dhe rregullat konsensuale të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e rregullimit të brendshëm juridik, kanë epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm dhe zbatohen drejtpërsëdrejti kur me to marrëdhëniet rregullohen ndryshe nga legjislacioni i brendshëm.

Kufijtë e lirive

Neni 10

Në Mal të Zi lejohet çdo gjë që nuk është ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj. Çdokush është i detyruar që t'i përmbahet Kushtetutës dhe ligjit.

Ndarja e pushtetit

Neni 11

Pushteti është i rregulluar mbi parimin e ndarjes së pushtetit: në pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Pushtetin legjislativ e ushtron Kuvendi, pushtetin ekzekutiv e ushtron Qeveria, kurse atë gjyqësor e ushtron gjykata.

Pushteti është i kufizuar me Kushtetutë dhe me ligj.

Marrëdhëniet midis pushtetasve mbështeten në baraspeshën dhe kontrollin reciprok.

Malin e Zi e përfaqëson Presidenti i Malit të Zi.

Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria mbrohen nga Gjykata Kushtetuese.

Ushtria dhe shërbimet e sigurimit janë nën kontrollin demokratik dhe civil.

Shtetësia malazeze

Neni 12

Në Mal të Zi ekziston shtetësia malazeze.

Mali i Zi mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve malazezë.

Shtetasi malazias nuk mund të përndjeket as t'i ekstradohet ndonjë shteti tjetër, me përjashtim të rasteve që janë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Malit të Zi.

Gjuha dhe shkrimi

Neni 13

Gjuhë zyrtare në Mal të Zi është gjuha malazeze.
Shkrimi cirilik dhe latin janë të barabartë.
Në përdorim zyrtar janë edhe gjuha serbe, boshnjake, shqipe dhe kroate.

Ndarja e bashkësive fetare nga shteti

Neni 14

Bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti.
Bashkësitë fetare janë të barabarta dhe të lira në kryerjen e riteve fetare dhe të punëve fetare.

Marrëdhënia me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare

Neni 15

Mali i Zi bashkëpunon dhe zhvillon marrëdhënie miqësore me shtetet e tjera dhe me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare mbi parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare.
Mali i Zi mund të aderojë në organizatat ndërkombëtare.
Kuvendi vendos mbi mënyrën e aderimit në Bashkimin Europian.
Mali i Zi nuk mund të hyjë në pakt me ndonjë shtet tjetër me të cilin humb pavarësinë dhe subjektivitetin e plotë ndërkombëtar.

Legjislacioni

Neni 16

Me ligj, në përputhje me Kushtetutën, rregullohen:

- 1) mënyra e realizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për realizimin e tyre;
- 2) mënyra e realizimit të të drejtave të posaçme të pakicave;
- 3) mënyra e themelimit, struktura organizative dhe kompetenca e organeve të pushtetit dhe procedura para këtyre organeve, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për funksionimin e tyre;
- 4) sistemi i vetëqeverisjes lokale;
- 5) çështjet e tjera me interes për Malin e Zi.

P J E S A E D Y T Ë

TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT

1. DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Baza juridike dhe barazia

Neni 17

Të drejtat dhe liritë e njeriut realizohen në bazë të Kushtetutës dhe të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

Të gjithë janë të barabartë para ligjit, pavarësisht nga çfarëdo veçantie apo cilësie personale.

Barazia gjinore

Neni 18

Shteti garanton barazinë e femrës dhe të mashkullit dhe ndjek politikën e mundësive të barabarta.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave

Neni 19

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë të të drejtave dhe lirive të veta.

Mjeti juridik

Neni 20

Çdokush gëzon të drejtën e mjetit juridik kundër vendimit me të cilin vendoset mbi të drejtën e tij apo mbi interesin e bazuar në ligj.

Ndihma juridike

Neni 21

Çdokush gëzon të drejtën e ndihmës juridike.

Ndihmën juridike e jep avokatia, si profesion i pavarur dhe autonom dhe shërbimet e tjera.

Ndihma juridike, në përputhje me ligjin, mund të jetë falas.

E drejta për vetëqeverisje lokale

Neni 22

Garantohet e drejta për vetëqeverisje lokale.

Mjedisi i jetesës

Neni 23

Çdokush gëzon të drejtën për një mjedis jetësor të shëndetshëm.

Çdokush gëzon të drejtën e informimit të plotë dhe në kohë për gjendjen e mjedisit të jetesës, për mundësinë e ndikimit me rastin e vendosjes mbi çështjet e rëndësishme për mjedisin e jetesës dhe për mbrojtjen juridike të këtyre të drejtave.

Çdokush, e sidomos shteti, ka për detyrë ta ruajë dhe ta avancojë mjedisin e jetesës.

Kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut

Neni 24

Të drejtat dhe liritë e garantuara të njeriut mund të kufizohen vetëm me ligj, në vëllimin të cilin e lejon Kushtetuta, në masën që është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe të lirë demokratike të realizohet qëllimi për shkak të të cilit është lejuar kufizimi.

Kufizimet nuk mund të aplikohen për qëllime të tjera jashtë atyre për shkak të të cilave janë caktuar.

Kufizimi i përkohshëm i të drejtave dhe lirive të njeriut

Neni 25

Gjatë kohës së gjendjes së shpallur të luftës apo të gjendjes së jashtëzakonshme mund të kufizohet realizimi i të drejtave dhe lirive të veçanta të njeriut, në vëllimin e domosdoshëm.

Kufizimi nuk mund të bëhet mbi bazën e gjinisë, kombësisë, racës, besimit, gjuhës, prejardhjes etnike apo shoqërore, bindjes politike apo bindjes tjetër, gjendjes pasurore apo çfarëdo cilësie tjetër personale.

Nuk mund të kufizohen të drejtat: e jetës; e mjetit juridik dhe ndihmës juridike; e dinjitetit dhe respektimit të personalitetit; e gjykimit të drejtë dhe publik dhe parimi i ligjshmërisë; e supozimit të pafajësisë; e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit; e lidhjes së martesës.

Nuk mund të suprimohen ndalesat: e mbjelljes ose nxitjes së urrejtjes apo intolerancës; diskriminimit; gjykimit të sërishëm dhe dënimit për të njëjtën veprë penale; e asimilimit të dhunshëm.

Masat e kufizimit nuk mund të vlejnë më shumë se derisa të zgjatë gjendja e luftës apo gjendja e jashtëzakonshme.

2. TË DREJTAT DHE LIRITË PERSONALE

Ndalimi i dënimit me vdekje

Neni 26

Në Mal të Zi ndalohet dënimi me vdekje.

Biomjekësia

Neni 27

Garantohet e dejta e njeriut dhe dinjiteti i qenies njerëzore përkitazi me aplikimin e biologjisë dhe mjekësisë.

Ndalohet çdo ndërhyrje që ka për qëllim krijimin e qenies njerëzore e cila në pikëpamje gjenetike është identike me qenien njerëzore, të gjallë a të vdekur.

Ndalohet që në qenien njerëzore pa lejen e tij të kryhen eksperimente mjekësore dhe eksperimente të tjera.

Dinjiteti dhe paprekshmëria e personalitetit

Neni 28

Garantohet dinjiteti dhe siguria e njeriut.

Garantohet paprekshmëria e integritetit fizik dhe psikik të njeriut, e privatësisë së tij dhe e të drejtave të tij personale.

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës apo veprimit çnjerëzor ose poshtërues.

Askush nuk guxon të mbahet në robëri apo në pozitë robërie.

Heqja e lirisë

Neni 29

Çdokush gëzon të drejtën e lirisë personale.

Heqja e lirisë lejohet vetëm nga shkaqet dhe në procedurën e parashikimit me ligj.

Personi të cilit i është hequr liria duhet të njoftohet menjëherë për shkaqet e heqjes së lirisë, në gjuhën e vet amtare apo në gjuhën të cilën e kupton.

Personi të cilit i është hequr liria njëkohësisht duhet të njoftohet se nuk është i detyruar të japë kurrëfarë deklarate.

Me kërkesën e personit të privuar nga liria organi kompetent është i detyruar që lidhur

me heqjen e lirisë ta njoftojë menjëherë mbrojtësin të cilin e cakton personi i privuar nga liria.

Personi të cilit i është hequr liria ka të drejtë që në marrjen e tij në pyetje të marrë pjesë avokati të cilin e zgjedh ai.

Heqja antiligjore e lirisë është e dënueshme.

Paraburgimi

Neni 30

Personi për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale, në bazë të vendimit të gjykatës kompetente, mund të paraburgoset dhe të mbahet në arrest vetëm nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale.

Personit të paraburgosur duhet t'i dorëzohet arsyetimi i aktvendimit në momentin e paraburgimit ose jo më vonë se brenda 24 orëve nga paraburgosja.

Kundër aktvendimit mbi paraburgosjen personi i arrestuar ka të drejtë ankese, lidhur me të cilën gjykata vendos brenda 48 orëve.

Kohëzgjatja e paraburgimit duhet të reduktohet në kohëzgjatje e mundshme minimale.

Në bazë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj nga dita e arrestimit paraburgimit, kurse me vendimin e gjykatës së lartë, ky afat mund të zgjatet edhe për tre muaj të tjerë.

Nëse deri me skadimin e këtyre afateve nuk ngritet aktpadia, i pandehuri lirohet nga burgimi.

Paraburgimi i të miturve nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë.

Respektimi i personalitetit

Neni 31

Garantohet respektimi i personalitetit dhe dinjitetit të njeriut në procedurën penale apo në çfarëdo procedure tjetër, në rastin e heqjes, respektivisht të kufizimit të lirisë dhe gjatë kohës së vuajtjes së dënimit.

Ndalohet dhe dënohet çdo dhunim dhe veprim çnjerëzor ose poshtëruës ndaj personit të cilit i është hequr apo i është kufizuar liria dhe çdo nxjerrje me dhunë e pranimit dhe deklaratave.

Gjykimi i drejtë dhe publik

Neni 32

Çdokush gëzon të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm para gjykatës së pavarur, asnjansë dhe të themeluar sipas ligjit.

Parimi i ligjshmërisë

Neni 33

Askush nuk mund të dënohet për veprën e cila, para se të jetë bërë, nuk ka qenë parashikuar me ligj apo me dispozitën e bazuar në ligj si vepër e dënueshme, as që mund t'i jepet dënimi që nuk ka qenë parashikuar për një vepër të tillë.

Ligji më i butë

Neni 34

Veprat penale dhe veprat e tjera të dënueshme sanksionohen dhe dënimet për to jepen sipas ligjit, që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës, përveç në qoftë se ligji i ri është më i butë për autorin e veprës.

Supozimi i pafajësisë

Neni 35

Çdokush konsiderohet i pafajshëm përderisa fajësia e tij të mos konstatohet me vendimin e formës së prerë të gjykatës.

I pandehuri nuk është i detyruar ta dëshmojë pafajësinë e vet.

Dyshimin lidhur me fajësinë gjykata është e detyruar ta interpretojë në favor të të pandehurit.

Ne bis in idem

Neni 36

Askush nuk mund të gjykohe sërish as nuk mund të dënohet sërish për të njëjtën vepër të dënueshme.

E drejta e mbrojtjes

Neni 37

Çdokujt i garantohet e drejta e mbrojtjes e sidomos: që në gjuhën amtë apo në gjuhën të cilin e kupton të njihet me aktakuzën kundër tij; t'i jepet kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe të mbrohet personalisht apo nëpërmjet avokatit të cilin e zgjedh vetë.

Dëmshpërblimi për shkak të veprimit të paligjshëm

Neni 38

Personit të cilit i është hequr liria apo është gjykuar në mënyrë kundërligjore apo të pabazë ka të drejtë dëmshpërblimi nga shteti.

Lëvizja dhe selitja

Neni 39

Garantohet liria e lëvizjes dhe e selitjes, si dhe e drejta e braktisjes së Malit të Zi.

Liria e lëvizjes, selitjes dhe braktisjes së Malit të Zi, mund të kufizohet vetëm nëse një gjë e tillë është e nevojshme për zhvillimin e procesit penal, për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse apo për shkaqe të sigurisë së Malit të Zi.

Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve rregullohet me ligj.

E drejta e privatësisë

Neni 40

Çdokush gëzon të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare.

Paprekshmëria e banesës

Neni 41

Banesa është e paprekshme.

Askush nuk mund të hyjë në banesë apo në ambiente të tjera kundër vullnetit të mbajtësit të tyre dhe në to të kryejë bastisjen pa vendimin e gjykatës.

Bastisja bëhet në prani të dy dëshmitarëve.

Personi zyrtar mund të hyjë në banesën e huaj apo në ambientet e tjera edhe pa vendimin e gjykatës dhe të bëjë bastisjen pa praninë e dëshmitarëve nëse kjo është e domosdoshme për parandalimin ekzyrtës së verpës penale, për kapjen e drejtpërdrejtë të autorit të veprës penale apo për shpëtimin e jetës së njerëzve dhe të pasurisë.

Fshehtësia e korrespondencës

Neni 42

Është e pacenueshme fshehtësia e korrespondencës, e bisedave telefonike dhe mjeteve të tjera të komunikimit.

Nga parimi i pacenueshmërisë së fshehtësisë së korrespondencës, të bisedave telefonike dhe të mjeteve të tjera të komunikimit mund të bëhet shmangje vetëm në bazë të vendimit

të gjykatës, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale apo për shkaqe të sigurisë së Malit të Zi.

Të dhënat mbi personalitetin

Neni 43

Garantohet mbrojtja e të dhënave mbi personalitetin.

Ndalohet përdorimi i të dhënave mbi personalitetin jashtë qëllimit për të cilin janë mbledhur ato.

Çdokush ka të drejtë të njihet me të dhënat që janë mbledhur për personalitetin e tij dhe të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të keqpërdorimit të tyre.

E drejta e strehimit politik

Neni 44

I huaji i cili druan me arsye nga përndjekja për shkak të racës, gjuhës, besimit të vet apo të përkatësisë ndonjë kombi apo grupimi apo për shkak të bindjeve politike, mund të kërkojë strehim politik në Mal të Zi.

I huaji nuk mund të përzëhet nga Mali i Zi atje ku për shkak të racës, besimit, gjuhës apo përkatësisë nacionale i kanoset gjykimi me dënim me vdekje, e torturimi, përrulja çnjerëzore, persekutimi apo me shkelja serioze të të drejtave të cilat i garanton kjo kushtetutë.

I huaji mund të përzëhet nga Mali i Zi vetëm në bazë të vendimit të organit kompetent dhe sipas procedurës së parashikuar me ligj.

3.TË DREJTAT DHE LIRITË POLITIKE

E drejta e votimit

Neni 45

Të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur e gëzon shtetasi i Malit të Zi i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka vendbanim në Mal të Zi të paktën dy vite.

E drejta e votimit realizohet në zgjedhje.

E drejta e votimit është e përgjithshme dhe e barabartë.

Zgjedhjet janë të lira dhe të drejtpërdrejta, kurse votimi është i fshehtë.

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e besimit

Neni 46

Çdokujt i garantohet e drejta e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit, si dhe

e drejta për ta ndërruar fenë ose bindjen dhe liria që ai vetë apo në bashkësi me të tjerët ta shfaqë publikisht apo privatisht besimin ose bindjen e vet me anë të lutjeve, predikimeve, adeteve apo riteve fetare.

Askush nuk është i detyruar që të deklarohet për bindjet e veta fetare apo bindjet e tjera.

Liria e shfaqjes së bindjeve fetare mund të kufizohet vetëm nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të rendit dhe qetësisë publike, si dhe të të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë.

Liria e të shprehurit

Neni 47

Çdokush gëzon të drejtën e lirisë së të shprehurit me anë të të folurit, të fjalës së shkruar, të pikturës apo në ndonjë mënyrë tjetër.

E drejta e lirisë së të shprehurit mund të kufizohet vetëm me të drejtën e tjetrit për dinjitet, prestigj dhe nder dhe nëse rrezikohet morali publik apo siguria e Malit të Zi.

Kundërshtimi nga ndërgjegjshmëria

Neni 48

Çdokush gëzon të drejtën e kundërshtimit nga ndërgjegjshmëria.

Askush nuk është i detyruar që kundër besimit apo bindjes së vet ta përmbushë detyrimin ushtarak apo detyrimin tjetër që nënkupton përdorimin e armëve.

Liria e shtypit

Neni 49

Garantohet liria e shtypit dhe e formave të tjera të informimit publik.

Garantohet e drejta që, pa leje, të themelohen gazeta dhe mjete të tjera të informimit publik, kundrejt regjistrimit pranë organit kompetent.

Garantohet e drejta e përgjigjes dhe e drejta e korigjimit të së pavërtetës, të informacionit jo të plotë dhe jo të saktë me të cilin është cenuar e drejta apo interesi i ndokujt dhe e drejta e dëmshpërblimit e shkaktuar nga publikimi i të dhënës apo njoftimit jo të saktë.

Ndalimi i censurës

Neni 50

Në Mal të Zi nuk ka censurë.

Gjykata kompetente mund të ndalojë përhapjen e informacioneve dhe të ideve me anë të mjeteve të informimit publik vetëm nëse një gjë e tillë është e domosdoshme me qëllim

të parandalimit të thirrjes për rrënimin me dhunë të rendit të përcaktuar me Kushtetutë; të ruajtjes së integritetit territorial të Malit të Zi; të parandalimit të propagandimit të luftës apo të nxitjes së dhunës ose të kryerjes së veprës penale; të parandalimit të propagandimit të urrejtjes apo të diskriminimit racial, nacional dhe fetar.

Shfrytëzimi i lirshëm i informacioneve

Neni 51

Çdokush gëzon të drejtën e shfrytëzimit të lirshëm të informacioneve në dispozicion të organeve shtetërore dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike.

E drejta e shfrytëzimit të lirshëm të informacioneve mund të kufizohet nëse një gjë e tillë është në interesin e: mbrojtjes së jetës; të shëndetit publik; të moralit dhe të privatësisë; zhvillimit të procesit penal; të mbrojtjes dhe sigurisë së Malit të Zi; të politikës së jashtme, asaj monetare dhe ekonomike.

Liria e tubimit

Neni 52

Garantohet liria e tubimit të qetë, pa leje, kundrejt paraqitjes paraprake tek organi kompetent.

Liria e tubimit të qetë mund të kufizohet përkohësisht me vendimin e organit kompetent me qëllim të parandalimit të trazirave ose të kryerjes së veprës penale, të rrezikimit të shëndetit, të moralit apo të sigurisë së njerëzve dhe të pasurisë, në përputhje me ligjin.

Liria e bashkimit

Neni 53

Garantohet liria e bashkimit politik, sindikal dhe e bashkimit dhe e veprimtarisë tjetër, pa leje, kundrejt regjistrimit tek organi kompetent.

Askush nuk mund të detyrohet për të qenë anëtar i ndonjë shoqate.

Shteti i ndihmon shoqatat politike dhe shoqatat e tjera, kur për një gjë të tillë ekziston interesi publik.

Ndalimi i organizimit

Neni 54

Ndalohet organizimi politik në organet shtetërore.

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari, prokurori shtetëror, Mbrojtësi i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, anëtar i Këshillit të Bankës Qendrore, anëtar i Senatit të Institucionit Revizor të Shtetit, pjesëtari profesionist i Ushtrisë, Policisë dhe i shërbimeve të tjera të

sigurimit, nuk mund të jetë anëtar i organizatës politike.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik i të huajve dhe organizatave politike, selia e të cilave ndodhet jashtë Malit të Zi.

Ndalimi i veprimit dhe themelimit

Neni 55

Ndalohet veprimi i organizatave politike dhe organizatave të tjera, që është i përqendruar në rrënimin me dhunë të rendit kushtetues, në rrezikimin e tërësisë territoriale të Malit të Zi, në shkeljen e lirive dhe të drejtave të garantuara apo në mbjelljen e urrejtjes dhe intolerancës nacionale, raciale, fetare etj.

Ndalohet themelimi i organizatave subverzive sekrete dhe i ushtrive të parregullta.

E drejta për t'iu drejtuar organizatave ndërkombëtare

Neni 56

Çdokush gëzon të drejtën për t'iu drejtuar organizatave ndërkombëtare me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të veta, të garantuara me Kushtetutë.

E drejta për t'iu drejtuar organeve

Neni 57

Çdokush gëzon të drejtën për t'iu drejtuar organit shtetëror apo organizatës që ushtron autorizime publike dhe të marrë përgjigje.

Askush nuk mund të thirret në përgjegjësi as të vuajë pasoja të tjera të dëmshme për shkak të qëndrimeve të paraqitura gjatë të drejtuarit këtyre organeve, përveç në qoftë se me një veprim të tillë ka kryer vepër penale.

4. TË DREJTAT DHE LIRITË EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

E drejta e pronësisë

Neni 58

Garantohet e drejta e pronësisë.

Askujt nuk mund t'i merret apo t'i kufizohet e drejta e pronësisë, përveç kur një gjë e tillë kërkohet nga interesi publik, me një shpërblim të drejtë.

Pasuritë natyrore dhe të mirat në përdorim të përgjithshëm janë në pronësi të shtetit.

Liria e sipërmarrjes

Neni 59

Garantohet liria e sipërmarrjes.

Liria e sipërmarrjes mund të kufizohet vetëm nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, të mjedisit të jetesës, të pasurive natyrore, të trashëgimisë kulturore apo të mbrojtjes dhe të sigurisë së Malit të Zi.

E drejta e trashëgimisë

Neni 60

Garantohet e drejta e trashëgimisë.

Të drejtat e të huajve

Neni 61

Shtetasi i huaj mund të jetë subjekt i së drejtës së pronësisë, në përputhje me ligjin.

E drejta e punës

Neni 62

Çdokush gëzon të drejtën për punë, për zgjedhjen e lirë të profesionit dhe të punësimit, për kushte të drejta dhe humane të punës dhe për mbrojtje sociale gjatë kohës së papunësisë.

Ndalimi i punës së dhunshme

Neni 63

Ndalohet puna e dhunshme.

Punë e dhunshme nuk konsiderohet: puna e rëndomtë në kuadër të vuajtjes së dënimit të heqjes së lirisë; kryerja e shërbimit të natyrës ushtarake apo të shërbimit që kërkohet në vend të tij; puna që kërkohet në rast të krizës apo të fatkeqësisë që i kanoset jetës së njerëzve apo pasurisë.

Të drejtat e të punësuarve

Neni 64

Të punësuarit gëzojnë të drejtën e pagës përkatëse.

Të punësuarit gëzojnë të drejtën për orar të kufizuar të punës dhe për pushim me pagesë.

Të punësuarit gëzojnë të drejtën e mbrojtjes në punë.

Të rinjtë, femrat dhe invalidët gëzojnë mbrojtje të posaçme në punë.

Këshilli social

Neni 65

Pozita sociale e të punësuarve harmonizohet në Këshillin Social.
Këshilli Social përbëhet nga përfaqësuesit e Sindikatës, të punëdhënësve dhe të Qeverisë.

Greva

Neni 66

Të punësuarit kanë të drejtë greve.
E drejta e grevës mund t'u kufizohet të punësuarve në ushtri, në polici, në organet shtetërore dhe në shërbimin publik me qëllim të mbrojtjes së interesit publik, në përputhje me ligjin.

Sigurimi social

Neni 67

Sigurimi social i të punësuarve është i detyrueshëm.
Shteti i garanton sigurinë materiale personit që është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete për jetesë.

Mbrojtja e personave invalidë

Neni 68

Garantohet mbrojtja e posaçme e personave invalidë.

Mbrojtja shëndetësore

Neni 69

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes shëndetësore.
Fëmija, gruaja shtatzënë, personi i moshuar dhe personi invalid gëzojnë të drejtën e mbrojtjes shëndetësore nga të ardhurat publike, në qoftë se këtë të drejtë nuk e realizojnë mbi ndonjë bazë tjetër.

Mbrojtja e konsumatorëve

Neni 70

Shteti mbron konsumatorin.

Ndalohen veprimet me të cilat prishet shëndeti, siguria dhe privatësia e konsumatorit.

Martesa

Neni 71

Martesa mund të lidhet vetëm me pëlqimin e lirë të femrës dhe të mashkullit.

Martesa bazohet në barazinë e bashkëshortëve.

Familja

Neni 72

Familja gëzon mbrojtje të posaçme.

Prindërit janë të detyruar të përkujdesen për fëmijët, t'i edukojnë dhe t'i shkollojnë.

Fëmijët janë të detyruar që të kujdesen për prindërit e vet të cilëve u nevojitet ndihma.

Fëmijët e lindur jashtë martese gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse fëmijët e lindur në martesë.

Mbrojtja e nënës dhe fëmijës

Neni 73

Nëna dhe fëmija gëzojnë mbrojtje të posaçme.

Shteti ka për detyrë të krijojë kushte me të cilat nxitet lindja e fëmijëve.

Të drejtat e fëmijës

Neni 74

Fëmija gëzon të drejtat dhe liritë, që i përshtaten moshës dhe pjekurisë së tij.

Fëmijës i garantohet mbrojtja e posaçme nga çfarëdo lloj shfrytëzimi apo keqpërdorimi psikik, fizik dhe ekonomik.

Shkollimi

Neni 75

Garantohet e drejta e shkollimit në kushte të barabarta.
Shkollimi fillor është i detyrueshëm dhe falas.
Garantohet autonomia e universitetit, e institucioneve universitare dhe shkencore.

Liria e krijimtarisë

Neni 76

Garantohet liria e krijimtarisë shkencore, kulturore dhe artistike.
Garantohet liria e botimit të veprave shkencore dhe artistike, e zbulimeve shkencore dhe shpikieve teknike, kurse autorëve të tyre u garantohen të drejtat morale dhe pasurore.

Shkenca, kultura dhe arti

Neni 77

Shteti stimulon dhe ndihmon zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, arteve, sportit, kulturës fizike dhe teknike.
Shteti i mbron vlerat shkencore, kulturore, artistike dhe historike.

Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Neni 78

Çdokush është i detyruar ta ruajë trashëgiminë natyrore dhe kulturore me interes të përgjithshëm.
Shteti mbron trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

5. TË DREJTAT E POSAÇME TË PAKICAVE

Mbrojtja e identitetit

Neni 79

Pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera minoritare u garantohen të drejtat dhe liritë që mund t'i shfrytëzojnë individualisht apo së bashku me të tjerët:

- 1) e drejta e shprehjes, e ruajtjes, e zhvillimit dhe manifestimit publik të veçantisë kombëtare, etnike, kulturore dhe fetare;
- 2) e drejta e zgjidhjes, e përdorimit dhe e ngritjes së simboleve kombëtare dhe e shënimit të festave kombëtare;
- 3) e drejta e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të vet në përdorim privat, publik dhe zyrtar;
- 4) e drejta e shkollimit në gjuhën dhe shkrimin e vet në institucionet shtetërore dhe që programet mësimore të përfshijnë edhe historinë dhe kulturën e pjesëtarëve të pupujve pakicë dhe të bashkësive të tjera minoritare;
- 5) që në mjediset me pjesëmarrje të rëndësishme të pakicave në popullatën e përgjithshme, organet e vetëqeverisjes lokale, organet shtetërore dhe gjyqësore të zhvillojnë procedurën edhe në gjuhën e popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera minoritare;
- 6) që të themelojnë shoqata arsimore, kulturore dhe fetare, kundrejt ndihmës materiale të shtetit;
- 7) që emrin dhe mbiemrin e vet ta regjistrojnë dhe ta përdorin në gjuhën dhe shkrimin e vet në dokumentet zyrtare;
- 8) që në mjediset me pjesëmarrje të rëndësishme të pakicave në popullatën e përgjithshme, emërtimet tradicionale lokale, emërtimet e rrugëve dhe qendrave të banura, si dhe shenjat topografike të shkruahen edhe në gjuhën e popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera minoritare;
- 9) e drejta e përfaqësimit autentik në Kuvendin e Malit të Zi dhe në kuvendet e njësive të vetëqeverisjes lokale, ku ata përbëjnë pjesë të rëndësishme të popullatës, në përputhje me parimin e aksionit afirmativ;
- 10) e drejta e përfaqësimit përpjesëtimor në shërbimet publike, në organet shtetërore të pushtetit dhe të vetëqeverisjes lokale;
- 11) e drejta e informimit në gjuhën e vet;
- 12) e drejta e vendosjes dhe e mbajtjes së kontakteve me qytetarët dhe me shoqatat jashtë Malit të Zi, me të cilat i lidh prejardhja e përbashkët nacionale dhe etnike, trashëgimia kulturore-historike, si dhe bindjet fetare;
- 13) e drejta e themelimit të këshillave për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të posaçme.

Ndalimi i asimilimit

Neni 80

Ndalohet asimilimi i dhunshëm i pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera minoritare.

Shteti është i detyruar t'i mbrojë pjesëtarët e popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera minoritare nga të gjitha format e asimilimit të dhunshëm.

6. MBROJTËSI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT

Neni 81

Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut i Malit të Zi është organ i pavarur i cili merr masa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut e ushtron funksionin në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe traktateve të ratifikuara ndërkombëtare, duke iu përmbajtur parimeve të ligjshmërisë dhe të drejtësisë.

Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut emërohet me mandat prej gjashtë vitesh dhe mund të shkarkohet në rastet e parashikuara me ligj.

PJESA E TRETË

RREGULLIMI I PUSHTETIT

1 KUVENDI I MALIT TË ZI

Kompetenca

Neni 82

Kuvendi:

- 1) miraton Kushtetutën
- 2) nxjerr ligje;
- 3) nxjerr dispozita të tjera dhe akte të përgjithshme (vendime, konkluzione, rezoluta, deklarata dhe rekomandime);
- 4) shpall gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme;
- 5) nxjerr buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;
- 6) miraton strategjinë e sigurisë kombëtare dhe strategjinë e mbrojtjes;
- 7) miraton planin zhvillimor dhe planin hapësinor të Malit të Zi;
- 8) vendos për përdorimin e njësiteve të Ushtrisë së Malit të Zi në forcat ndërkombëtare;
- 9) rregullon sistemin e administratës shtetërore;
- 10) ushtron mbikëqyrjen e Ushtrisë dhe të shërbimeve të sigurimit;
- 11) shapll referendumin shtetëror;
- 12) zgjedh dhe shkarkon kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë;
- 13) zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Gjykatës Supreme, kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- 14) emëron dhe shkarkon: kryeprokurorin e shtetit dhe prokurorët e shtetit, Mbrojtësin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Guvernatorin e Bankës Qendrore,

kryetarin dhe anëtarët e Senatit të Institucionit Revizor të Shtetit dhe mbarëtësit e tjerë të funksioneve të përcaktuara me ligj;

- 15) vendos për të drejtat e imunitetit;
- 16) jep amnistinë;
- 17) ratifikon traktatet ndërkombëtare;
- 18) shpall huatë publike dhe vendos për debitimin e Malit të Zi;
- 19) vendos për disponimin e pasurisë shtetërore mbi vlerën e përcaktuar me ligj;
- 20) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë ose me ligj.

Përbërja e Kuvendit

Neni 83

Kuvendi përbëhet nga deputetët që zgjedhen drejtpërsëdrejti në bazë të së drejtës së përgjithshme dhe të barabartë të votimit dhe me vota të fshehta.

Kuvendi ka 81 deputetë.

Mandati i Kuvendit

Neni 84

Mandati i Kuvendit zgjatë katër vite.

Kuvendit mund t'i pushojë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur me shpërndarjen apo me shkurtimin e mandatit të Kuvendit.

Në qoftë se Kuvendit i skadon mandati gjatë kohës së gjendjes së luftës apo të gjendjes së jashtëzakonshme, atij i zgjatet mandati jo më shumë se 90 ditë pas zhdukjes së rrethanave që kanë shkaktuar këtë gjendje.

Me propozimin e Presidentit të Malit të Zi, të Qeverisë apo të paktën 25 deputetëve, Kuvendi mund të shkurtojë mandatin e vet.

Të drejtat dhe detyrimet e deputetëve

Neni 85

Deputeti përcaktohet dhe voton sipas bindjes së vet.

Deputeti ka të drejtë që funksionin e deputetit ta ushtrojë në formë profesioni.

Imuniteti

Neni 86

Deputeti gëzon imunitet.

Deputeti nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose në përgjegjësi tjetër apo të

paraburgoset për mendimin e shfaqur apo për votimin gjatë ushtrimit të funksionit të vet si deputet.

Kundër deputetit nuk mund të ngrihet proces penal as të caktohet arresti, pa lejen e Kuvendit, me përjashtim kur është kapur duke kryer vepër penale për të cilën parashikohet dënimi me burg në kohëzgjatje mbi pesë vjet.

Imunitet të njëjtë me deputetin gëzojnë: Presidenti i Malit të Zi, Kryeministri dhe anëtarët e Qeverisë, kryetari i Gjykatës Supreme, kryetari dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Kryeprokurori i shtetit

Pushimi i mandatit të deputetit

Neni 87

Deputetit i pushon mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur:

1. me paraqitjen e dorëheqjes;
2. nëse me vendimin e formës së prerë të gjykatës është gjykuar me dënim me burg pa kusht prej të paktën gjashtë muajve;
3. nëse me vendimin e formës së prerë është privuar nga zotësia për të vepruar.
4. me humbjen e shtetësisë malazeze

Konstituimi i Kuvendit

Neni 88

Seancën e parë të legjislaturës së porsazgjedhur të Kuvendit e thërret kryetari i Kuvendit të legjislaturës paraprake dhe mbahet jo më vonë se 15 ditë nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Kryetari dhe nënkryetari I Kuvendit

Neni 89

Kuvendi ka kryetarin dhe një apo disa nënkryetarë, të cilët i zgjedh nga përbërja e vet me mandat prej katër vitesh.

Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, thërret seancat e Kuvendit dhe i kryeson ato, kujdeset për zbatimin e Rregullores së punës të Kuvendit, shpall zgjedhjet për Presidentin e Malit të Zi dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë, me ligj dhe me Rregulloren e punës të Kuvendit.

Nënkryetari e zëvendëson kryetarin e Kuvendit në kryerjen e punëve kur ai është penguar apo kur ia beson që ta zëvendësojë.

Sesionet e Kuvendit

Neni 90

Kuvendi punon në sesione të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Sesioni i rregullt mbahet dy herë në vit.

Sesioni i parë i rregullt fillon ditën e parë të punës në mars dhe zgjatë deri në mbarim të korrikut, kurse i dyti ditën e parë të punës në tetor dhe zgjatë deri në mbarim të dhjetorit.

Sesioni i jashtëzakonshëm thirret me kërkesën e Presidentit të Malit të Zi, të Qeverisë apo të paktën nga një e treta e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Vendosja

Neni 91

Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm në seancën në të cilën marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve, në qoftë se me Kushtetutë nuk është caktuar ndryshe.

Me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, Kuvendi miraton ligje me të cilat rregullohen: mënyra e realizimit të lirive dhe të drejtave të qytetarëve; shtetësia malazeze; referendumi; detyrimet materiale të qytetarëve; simbolet shtetërore si dhe përdorimi dhe shfrytëzimi i simboleve shtetërore; mbrojtja dhe siguria; ushtria; themelimi, bashkimi dhe suprimimi i komunave; shpallet gjendja e luftës dhe gjendja e jashtëzakonshme; miratohet plani hapësinor; nxirret Rregullorja e punës së Kuvendit; vendoset për shpalljen e referendumit shtetëror; vendoset për shkurtimin e mandatit; vendoset për shkarkimin e Presidentit të Republikës; zgjedhet dhe shkarkohet Kryeministri dhe anëtarët e Qeverisë dhe vendoset për votëbesimin ndaj Qeverisë; zgjedhet dhe shkarkohet kryetari i Gjykatës Supreme, kryetari dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese; emërohet dhe shkarkohet Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave të votave të të gjithë deputetëve për ligjet me të cilat rregullohet sistemi elektoral dhe të drejtat pronësore të të huajve.

Në votimin e parë me shumicën e dy të tretave dhe në votimin e dytë me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Kuvendi jo më parë se pas tre muajve vendos lidhur me ligjet me të cilat rregullohet mënyra e realizimit të të drejtave të fituara të pakicave dhe përdorimi i njësive të Ushtrisë në forcat ndërkombëtare.

Shpërndarja e Kuvendit

Neni 92

Kuvendi shpërndahet në qoftë se nuk e zgjedh Qeverinë brenda 90 ditëve nga data kur Presidenti i Malit të Zi propozon për herë të parë mandtorin.

Në qoftë se Kuvendi nuk i ushtron për një periudhë të gjatë kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë, Qeveria, pasi të ketë dëgjuar mendimin e kryetarit të Kuvendit dhe të

kryetarëve të klubeve të deputetëve në Kuvend, mund ta shpërndajë Kuvendin.

Kuvendi shpërndahet me dekretin e Presidentit të Malit të Zi.

Kuvendi nuk mund të shpërndahet gjatë kohës së gjendjes së luftës apo të gjendjes së jashtëzakonshme, në qoftë se është ngritur procedura e votimit të mosbesimit ndaj Qeverisë, si dhe as brenda tre muajve të parë nga konstituimi dhe tre muaj para skadimit të mandatit.

Presidenti i Malit të Zi shpall zgjedhjet ditën e parë pas shpërndarjes së Kuvendit.

Propozimi i ligjeve dhe i akteve të tjera

Neni 93

Të drejtën e propozimit të ligjeve dhe të akteve të tjera e gëzojnë Qeveria dhe deputeti.

Të drejtën e propozimit të ligjeve e gëzojnë edhe gjashtë mijë zgjedhës, nëpërmjet deputetit të cilin e autorizojnë.

Propozimin për shpalljen e referendumit shtetëror mund ta paraqesin: të paktën 25 deputetë, Presidenti i Malit të Zi, Qeveria dhe 10 % e qytetarëve që kanë të drejtë votimi.

Shpallja e ligjeve

Neni 94

Presidenti i Malit të Zi është i detyruar për ta shpallur ligjin brenda shtatë ditëve nga data e miratimit të ligjit, respektivisht brenda afatit prej tri ditëve në qoftë se ligji është miratuar me procedurë të shpejtë apo kur ligji i kthehet Kuvendit për rishqyrtim.

Presidenti i Malit të Zi është i detyruar për ta shpallur ligjin e votuar sërish.

2. PRESIDENTI I MALIT TË ZI

Kompetenca

Neni 95

Presidenti i Malit të Zi:

- 1) përfaqëson Malin e Zi në vend dhe në botën e jashtme;
- 2) komandon Ushtrinë, në bazë të vendimeve të Këshillit të Mbrojtjes dhe të Sigurisë;
- 3) shpall me dekret ligjet;
- 4) shpall zgjedhjet për Kuvend;
- 5) i propozon Kuvendit: mandatorin për formimin e Qeverisë, pas bisedës së zhvilluar me përfaqësuesit e partive politike të përfaqësuara në Kuvend; kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Mbrojtësin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;

- 6) cakton dhe revokon ambasadorët dhe shefat e përfaqësive diplomatike dhe përfaqësive të tjera të Malit të Zi në botën e jashtme, në bazë të propozimiti të Qeverisë dhe të mendimit të Këshillit të Kuvendit, me kompetencë për marrëdhënie ndërkombëtare;
- 7) pranon letrat akreditive dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatikë;
- 8) ndanë dekorata dhe mirënjohje të Malit të Zi;
- 9) jep amnisti;
- 10) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Zgjedhja

Neni 96

Presidenti i Malit të Zi zgjedhet në bazë të së drejtës së përgjithshme dhe të barabartë të votimit, me vota të drejtpërdrejta dhe të fshehta.

President I Malit të Zi mund të zgjedhet shtetasi malazias, i cili ka vendbanim në Mal të Zi në kohëzgjatje të paktën 10 vite në 15 vitet e fundit.

Zgjedhjet për Presidentin e Malit të Zi shpallen nga kryetari i Kuvendit.

Mandati

Neni 97

Presidenti i Malit të Zi zgjedhet me mandat prej pesë vitesh.

I njëjti person nuk mund të jetë më shumë se dy herë president i Malit të Zi.

Presidenti i Malit të Zi merr detyrën ditën e dhënies së betimit para deputetëve në Kuvend.

Në qoftë se mandati i Presidentit skadon gjatë kohës së gjendjes së luftës apo gjendjes së jashtëzakonshme, mandati vazhdohet jo më shumë se 90 ditë pas zhdukjes së rrethanave që e kanë shkaktuar këtë gjendje.

Presidenti i Malit të Zi nuk mund të ushtrojë funksion tjetër publik.

Pushimi i mandatit

Neni 98

Mandati i Presidentit të Malit të Zi pushon me skadimin e afatit për të cilin është zgjedhur, me dorëheqje, nëse është penguar përgjithmonë për të ushtruar detyrën e Presidentit dhe me shkarkim.

Presidenti përgjigjet për shkeljen e Kushtetutës.

Procedura për konstatimin nëse Presidenti i Malit të Zi e ka shkelur Kushtetutën ngrihet nga Kuvendi, me propozimin e të paktën 25 deputetëve.

Propozimin për ngritjen e procedurës Kuvendi ia dërgon Presidentit të Malit të Zi për t'u deklaruar.

Vendimin mbi ekzistimin apo mosekzistimin e shkeljes së Kushtetutës e merr Gjykata Kushtetuese, të cilin e publikon menjëherë dhe ia dërgon Kuvendit dhe Presidentit të Malit të Zi.

Kuvendi mund ta shkarkojë Presidentin e Malit të Zi kur Gjykata Kushtetuese konstaton se ka shkelur Kushtetutën.

Ushtrimi i funksionit në rast të pengimit apo të pushimit të mandatit

Neni 99

Në rast të pushimit të mandatit të Presidentit të Malit të Zi, si dhe në rast të pengimit të përkohshëm të Presidentit për ta ushtruar funksionin, këtë funksion deri me zgjedhjen e presidentit të ri, e ushtron kryetari i Kuvendit.

3. QEVERIA E MALIT TË ZI

Kompetenca

Neni 100

Qeveria:

1. ndjek politikën e brendshme dhe të jashtme të Malit të Zi;
2. zbaton ligjet, dispozitat e tjera dhe aktet e përgjithshme;
3. nxjerr dekrete ligje, vendime dhe akte të tjera për zbatimin e ligjeve;
4. lidh traktetatet ndërkombëtare;
5. propozon planin zhvillimor dhe planin hapësinor të Malit të Zi;
6. propozon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit;
7. propozon strategjinë e sigurisë kombëtare dhe strategjinë e mbrojtjes;
8. vendos për njohjen e shteteve dhe për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore me shtetet e tjera;
9. propozon ambasadorët dhe shefat e përfaqësive të tjera diplomatike të Malit të Zi në botën e jashtme;
10. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me liigj.

Dekretet me fuqi ligjore

Neni 101

Gjatë kohës së gjendjes së luftës apo të gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria mund të

nxjerrë dekrete me fuqi ligjore, nëse Kuvendi nuk ka mundësi për t'u mbledhur.

Qeveria është e detyruar që dekretet me fuqi ligjore t'ia paraqesë për konfirmim Kuvendit, posa Kuvendi të ketë mundësi për t'u mbledhur.

Përbërja e Qeverisë

Neni 102

Qeveria përbëhet nga kryeminsitri, nga një apo disa nënkryetarë dhe nga ministrat. Kryeministri përfaqëson Qeverinë dhe udhëheq punën e saj.

Zgjedhja

Neni 103

Presidenti i Malit të Zi propozon mandatorin brenda 30 ditëve nga data e konstituimit të Kuvendit.

Mandatori për formimin e Qeverisë paraqet në Kuvend programin e vet dhe propozon përbërjen e Qeverisë.

Kuvendi vendos në të njëjtën kohë për programin e mandatorit dhe për propozimin për përbërjen e Qeverisë.

Mospërputhja e funksionit

Neni 104

Kryeministri dhe anëtari i Qeverisë nuk mund të ushtrojnë funksionin e deputetit apo ndonjë funksion tjetër publik, as të ushtrojnë në mënyrë profesionale ndonjë veprimtari tjetër.

Dorëheqja dhe shkarkimi

Neni 105

Qeveria dhe anëtari i Qeverisë mund të paraqesin dorëheqje.

Dorëheqja e kryeministrit konsiderohet dorëheqje e Qeverisë.

Kryeministri mund t'i propozojë Kuvendit shkarkimin e anëtarit të Qeverisë.

Çështja e votëbesimit

Neni 106

Qeveria mund të paraqesë në Kuvend çështjen e votëbesimit të vet.

Çështja e mosbesimit

Neni 107

Kuvendi mund të votojë mosbesimin ndaj Qeverisë.

Propozimin për votimin e mosbesimit ndaj Qeverisë mund ta paraqesin të paktën 27 deputetë.

Në qoftë se Qeveria ka marrë votëbesimin, nënshkruesit e propozimit nuk mund të paraqesin propozim të ri për votimin e mosbesimit para skadimit të afatit prej 90 ditëve.

Interpelanca

Neni 108

Interpelanca për shqyrtimin e çështjeve të caktuara lidhur me punën e Qeverisë mund të paraqitet nga të paktën 27 deputetë.

Interpelanca paraqitet në formë shkresore dhe duhet të jetë e arsyetuar.

Qeveria kthen përgjigjen brenda afatit prej 30 ditëve nga data e marrjes së interpelancës.

Hetimi parlamentar

Neni 109

Kuvendi, me propozimin e të paktën 27 deputetëve, mund të formojë këshillin anketues për grumbullimin e informacioneve dhe fakteve për ngjarjet që kanë të bëjnë me punën e organeve shtetërore.

Pushimi i mandatit

Neni 110

Qeverisë i pushon mandati: me skadimin e mandatit të Kuvendit, me shpërndarjen apo me shkurtimin e mandatit të Kuvendit; me paraqitjen e dorëheqjes, kur e humbë votëbesimin dhe nëse nuk e propozon buxhetin deri më 31 mars të vitit buxhetor.

Qeveria të cilës i ka pushuar mandati vazhdon punën deri në zgjedhjen e Qeverisë në përbërje të re.

Qeveria të cilës i ka pushuar mandati nuk mund ta shpërndajë Kuvendin.

Administrata shtetërore

Neni 111

Punët e administratës shtetërore kryhen nga ministrinë dhe organet e tjera të administratës.

Kalimi dhe të besuarit e punëve

Neni 112

Disa nga punët e administratës shtetërore me ligj mund t'i kalohen vetëqeverisjes lokale apo personit tjetër juridik.

Disa nga punët e administratës shtetërore me aktin e Qeverisë mund t'i besohen vetëqeverisjes lokale apo personit tjetër juridik.

4. VETËQEVERISJA LOKALE

Mënyra e vendosjes

Neni 113

Në vetëqeverisjen lokale vendoset drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

E drejta për vetëqeverisje lokale përfshin të drejtën e qytetarëve dhe të organeve të vetëqeverisjes lokale për të rregulluar dhe administruar punë publike dhe punë të tjera, në bazë të përgjegjësisë vetjake dhe në interes të popullatës lokale.

Forma e vetëqeverisjes lokale

Neni 114

Komuna është forma themelore e vetëqeverisjes lokale.
Mund të themelohen edhe forma të tjera të vetëqeverisjes lokale.

Komuna

Neni 115

Komuna ka cilësinë e personit juridik.
Komuna nxjerr statutin dhe aktet e përgjithshme.
Organe të komunës janë kuvendi dhe kryetari.

Autorizimet pronësore dhe financimi

Neni 116

Komuna ushtron autorizime të caktura pronësore mbi sendet në pronësi shtetërore, në përputhje me ligjin.

Komuna ka pasurinë e vet.
Komuna financohet nga të ardhurat e veta dhe nga mjetet e shtetit.
Komuna ka buxhetin e vet.

Pavarësia Neni 117

Komuna është e pavarur në ushtrimin e kompetencave të veta.
Qeveria mund ta shpërndajë kuvendin e komunës, përkatësisht ta shkarkojë kryetarin e komunës vetëm në qoftë se kuvendi i komunës, përkatësisht kryetari i komunës, brenda një periudhe më të gjatë se gjashtë muaj nuk i ushtrojnë autorizimet e veta.

5. GJYKATA

Parimet e gjyqësisë

Neni 118

Gjykata është e pavarur në punën e vet.
Gjykata gjykon në bazë të Kushtetutës, të ligjit dhe të traktateve ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara.
Ndalohet themelimi i gjykatave ushtarake dhe të jashtëzakonshme.

Kolegji gjyqësor Neni 119

Gjykata gjykon në kolegji, përpos atëherë kur me ligj është caktuar që të gjykojë gjyqtari individ.
Në gjykim marrin pjesë edhe gjyqtarët-porotnikë, kur një gjë e tillë është përcaktuar me ligj.

Transparenca e gjykimit Neni 120

Shqyrtimi para gjykatës është publik.
Përjashtimisht, gjykata mund të përjashtojë publikun nga shqyrtimi apo nga një pjesë e tij, nga shkaqet që janë të domosdoshme në shoqërinë demokrtike, vetëm në vëlimin që është i nevojshëm: në interes të moralit, rendit publik, kur gjykohen të miturit; me qëllim të mbrojtjes së jetës private të palëve, në konteset bashkëshortore; në proceset në lidje me kujdestarinë apo birësimin; me qëllim të ruajtjes së sekretit ushtarak, afarist ose zyrtar dhe të mbrojtjes dhe sigurisë së Malit të Zi.

Përhershmeria e funksionit

Neni 121

Funksioni i gjyqtarit është i përhershëm.

Gjyqtarit i pushon funksioni me kërkesën e tij, kur t'i ketë plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë dhe në qoftë se është dënuar me burg pa kusht.

Gjyqtari shkarkohet nga detyra: në qoftë se është gjykuar për vepër që e bën të padentë për ta ushtruar funksionin e gjyqtarit; nëse e ushtron në mënyrë joprofesionale apo të pandërgjegjshme funksionin e gjyqtarit apo në qoftë se ka humbur përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit.

Gjyqtari nuk mund të transferohet apo të dërgohet në një gjykatë tjetër kundër vullnetit të tij, përpos me vendimin e Këshillit Gjyqësor në rast të riorganizimit të gjykatave.

Imuniteti funksional

Neni 122

Gjyqtari dhe gjyqtari-porotnik gëzon imunitet funksional.

Gjyqtari dhe gjyqtari-porotnik nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e shprehur dhe për votimin gjatë dhënies së vendimit gjyqësor, përveç nëse është fjala për veprën penale.

Në procedurën e ngritur për shkak të veprës penale të kryer gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit gjykatësi nuk mund të paraburgoset pa lejimin e Këshillit Gjyqësor.

Mospërputhja e funksionit

Neni 123

Gjyqtari nuk mund të ushtrojë funksionin e deputetit apo ndonjë funksion tjetër publik, as të ushtrojë në mënyrë profesionale ndonjë veprimtari tjetër.

Gjykata Supreme

Neni 124

Gjykata Supreme është instanca më e lartë gjyqësore në Malin e Zi.

Gjykata Supreme siguron zbatimin unik të ligjeve nga ana e gjykatave.

Kryetarin e Gjykatës Supreme e zgjedh dhe nga ky funksion e shkarkon Kuvendi, në bazë të propozimit të prëbashkët të Presidentit të Malit të Zi, kryetrit të Kuvendit dhe Kryeministrit.

Në qoftë se propozimi për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese nuk paraqitet brend 30 ditëve, kryetri i Gjykatës Supreme zgjedhet në bazë të propozimit të forumit kompetent të punës të Kuvendit.

Zgjedhja e gjyqtarëve

Neni 125

Këshilli Gjyqësor emëron dhe shkarkon gjyqtarin dhe kryetarin e gjykatës. Kryetari i gjykatës zgjedhet me mandat prej pesë vitesh. Kryetari i gjykatës nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Gjyqësor. Këshilli Gjyqësor

Neni 126

Këshilli Gjyqësor është organ i përhershëm dhe i pavarur i cili siguron pavarësinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve.

Përbërja e Këshillit Gjyqësor

Neni 127

Këshilli Gjyqësor ka kryetarin dhe nëntë anëtarë. Kryetari i Këshillit Gjyqësor është kryetari i Gjykatës Supreme. Anëtarë të Këshillit Gjyqësor janë: katër gjyqtarë që i zgjedh dhe i shkarkon Konferenca e Gjyqtarëve; dy deputetë që i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi nga radhët e shumicës parlamentare dhe opozitës; dy juristë me renome që i zgjedh dhe i shkarkon Presidenti i Malit të Zi; Ministri i Drejtësisë. Përbërjen e Këshillit Gjyqësor e shpall Presidenti i Malit të Zi. Mandati i Këshillit Gjyqësor është katër vjet.

Kompetenca e Këshillit Gjyqësor

Neni 128

Këshilli Gjyqësor:

- 1) zgjedh dhe shkarkon gjyqtarin, kryetarin e gjykatës dhe gjykatësin – porotnik;
- 2) përcakton pushimin e funksionit të gjyqtarit;
- 3) përcakton numrin e gjyqtarëve dhe të gjyqtarëve-porotnikë në gjykatë;
- 4) shqyrton raportin mbi punën e gjykatës, parashtrësit dhe ankesat në punën e gjykatave dhe merr qëndrime lidhur me to;
- 5) vendos për imunitetin e gjyqtarit;
- 6) i propozon Qeverisë shumën e mjeteve për punën e gjykatave;
- 7) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Këshilli Gjyqësor vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Në proceset e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, ministri i Drejtësisë nuk voton.

6. USHTRIA E MALIT TË ZI

Parimet

Neni 129

Ushtria mbron pavarësinë, sovranitetin dhe territorin shtetëror të Malit të Zi, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare mbi përdorimin e dhunës.

Ushtria është nën kontrollin demokratik dhe civil.

Pjesëtarët e Ushtrisë mund të hyjnë në përbërje të forcave ndërkombëtare.

7. KËSHILLI I MBROJTJES DHE SIGURISË

Kompetenca

Neni 130

Këshilli i Mbrojtjes dhe Sigurisë:

merr vendime lidhur me komandimin e Ushtrisë së Malit të Zi;

analizon dhe vlerëson gjendjen e sigurisë në Mal të Zi dhe merr vendime për marrjen e masave përkatëse;

cakton, gradon dhe shkarkon oficerët e Ushtrisë;

i propozon Kuvendit shpalljen e gjendjes së luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme;

propozon përdorimin e Ushtrisë në forcat ndërkombëtare;

kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë ose me ligj.

Përbërja

Neni 131

Këshilli i Mbrojtjes dhe Sigurisë i Malit të Zi përbëhet nga Presidenti i Malit të Zi, nga kryetari i Kuvendit, dhe nga Kryeministri.

Presidenti i Malit të Zi është kryetar i Këshillit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Shpallja e gjendjes së luftës

Neni 132

Gjendja e luftës shpallet kur ekziston rreziku i drejtpërdrejtë nga lufta për Malin e Zi apo kur Mali i Zi të jetë sulmuar apo t'i jetë shpallur luftë.

Në qoftë se Kuvendi nuk ka mundësi të mbledhet, vendimin për shpalljen e gjendjes së luftës e merr Këshilli i Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe ia paraqet për konfirmimin Kuvendit, posa Kuvendi të ketë mundësi për t'u mbledhur.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme

Neni 133

Gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet në tërë territorin apo në një pjesë të territorit të Malit të Zi, në rast:

- të fatkeqësive të mëdha të natyrës
- të fatkeqësive tekniko-teknologjike, ekologjike dhe epidemive;
- të prishjes në shkallë të lartë të rendit dhe qetësisë publike;
- të rrezikimit apo tentimit të përmbusjes së rendit kushtetues.

Në qoftë se Kuvendi nuk ka mundësi për t'u mbledhur, vendimin për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme e merr Këshilli i Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe ia paraqet për konfirmim Kuvendit, posa Kuvendi të ketë mundësi për t'u mbledhur.

Gjendja e jashtëzakonshme zgjatë dersia të zhduken rrethanat për shkak të të cilave është shpallur.

8. PROKURORIA E SHTETIT

Statusi dhe kompetenca

Neni 134

Prokuroria e Shtetit është organ shtetëror unik dhe i pavarur i cili kryen punët e ndjekjes së autorëve të veprave penale dhe veprave të tjera të dënueshme që ndiqen sipas detyrës zyrtare.

Emërimi dhe mandati

Neni 135

Punët e Prokurorisë së Shtetit i kryen prokurori i shtetit.

Prokurori i shtetit ka një ose disa zëvendës.

Kryeprokurori i Shtetit dhe prokurorët e shtetit emërohen me mandat prej pesë vitesh.

Këshilli i Prokurorisë

Neni 136

Këshilli i Prokurorisë siguron pavarësinë e Prokurorisë së Shtetit dhe të prokurorëve të shtetit.

Këshillin e Prokurorisë e zgjedh dhe e shkarkon Kuvendi.

Zgjedhja, mandati, kompetencat, struktura organizative dhe mënyra e punës së Këshillit të Prokurorisë rregullohen me ligj.

Imuniteti funksional

Neni 137

Prokurori i shtetit dhe zëvendësprokurori i shteti gëzojnë imunitet funksional dhe nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e dhënë apo për vendimin e marrë gjatë ushtrimit të funksionit, përpos nëse është fjala për vepër penale.

Mospërputhja e funksionit

Neni 138

Prokurori i shtetit dhe zëvendësprokurori i shtetit nuk mund të ushtrorjnë funksionin e deputetit apo ndonjë funksion tjetër publik dhe as të ushtrorjnë në mënyrë profesionale ndonjë veprimtari tjetër.

P J E S A E K A T Ë R T

RREGULLIMI EKONOMIK

Parimet

Neni 139

Rregullimi ekonomik mbështetet në tregun e lirë dhe të hapur, në lirinë e sipërmarrjes dhe të konkurrencës, në pavarësinë e subjekteve ekonomike dhe në përgjegjësinë e tyre për detyrimet e marra përsipër në qarkullimin juridik, në mbrojtjen dhe barazinë e të gjitha formave të pronësisë.

Hapësira ekonomike dhe barazia

Neni 140

Territori i Malit të Zi është hapësirë ekonomike unike.
Shteti nxit zhvillimin ekonomik të baraspeshuar të të gjitha rajoneve të tij.
Ndalohet cenimi dhe kufizimi i konkurrencës së lirë dhe nxitja e pozitës së pabarabartë, monopoliste apo dominante në treg.

Pronësia e shtetit

Neni 141

Sendet në pronësi të shtetit i takojnë shtetit të Malit të Zi.

Detyrimi tatimor

Neni 142

Shteti financohet nga tatimet, tagrat e tjera.
Çdokush është i detyruar për t'i paguar tatimet, tagrat dhe të ardhurat e tjera.
Tatimet dhe tagrat e tjera mund të caktohen vetëm me ligj.

Banka Qendrore e Malit të Zi

Neni 143

Banka Qendrore e Malit të Zi është organizatë e pavarur, përgjegjëse për stabilitetin monetar dhe financiar dhe për funksionimin e sistemit bankar.
Bankën Qendrore të Malit të Zi e administron Këshilli i Bankës Qendrore.
Bankën Qendrore të Malit të Zi e udhëheq Guvernatori i Bankës Qendrore.

Institucioni Revizor i Shtetit

Neni 144

Institucioni Revizor i Shtetit të Malit të Zi është organ i pavarur dhe i lartë i revizionit të shtetit.

Institucioni Revizor i Shtetit ushtron revizionin e ligjshmërisë dhe të suksesit të administrimit të pasurisë shtetërore, të detyrimeve, buxheteve dhe të gjitha punëve financiare të subjekteve, burimet financiare të cilëve janë publike apo fitohen me anë të shfrytëzimit të pasurisë shtetërore.

Institucioni Revizor i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor.

Institucionin Revizor të Shtetit e qeveris Senati.

PJESA E PESTË

KUSHTETUTSHMËRIA DHE LIGJSHMËRIA

Përputhshmëria e normave juridike

Neni 145

Ligji duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe me traktatet e ratifikuara ndërkombëtare, kurse dispozita tjetër duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin.

Publikimi i dispozitave juridike dhe hyrja e tyre në fuqi

Neni 146

Ligji dhe dispozita tjetër publikohen para hyrjes së tyre në fuqi, kurse hyjnë në fuqi jo më parë se ditën e tetë nga data e publikimit.

Përfundimisht, kur për një gjë të tillë ekzistojnë arsyet e përcaktuara në procedurën e miratimit, ligji dhe akti tjetër juridik mund të hyjnë në fuqi jo më parë se ditën e publikimit.

Ndalimi i efektit prapaveprues

Neni 147

Ligji dhe akti tjetër juridik nuk mund të kenë efekt prapaveprues.

Përfundimisht, dispozita të veçanta të ligjit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga interesi publik i përcaktuar në procedurën e nxjerrjes së ligjit, mund të kenë efekt prapaveprues.

Dispozita e ligjit penal mund të ketë efekt prapaveprues vetëm nëse është më e butë për autorin e veprës penale.

Ligjshmëria e akteve të veçanta

Neni 148

Akti juridik i veçantë duhet të jetë në përputhje me ligjin.

Aktet juridike të veçanta të formës së prerë gëzojnë mbrojtje gjyqësore.

PJESA E GJASHTË

GJYKATA KUSHTETUESE E MALIT TË ZI

Kompetenca

Neni 149

Gjykata Kushtetuese vendos:

për përputhshmërinë e ligjit me Kushtetutën dhe me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara;

për përputhshmërinë e dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme me Kushtetutën dhe me ligjin;

rreth ankesës kushtetuese për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike efektive;

nëse Presidenti i Malit të Zi ka shkelur Kushtetutën;

për ndeshjen e kompetencave midis gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore, midis organeve shtetërore dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe midis organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale;

për ndalimin e punës së partisë politike apo të organizatës joqeveritare;

për konfliktet elektorale dhe konfliktet në lidhje me referendumin, që nuk janë në kompetencën e gjykatave të tjera;

për përputhshmërinë me Kushtetutë të masave dhe veprimeve të organeve shtetërore, të ndërmarra gjatë kohës së gjendjes së luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme;

kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Në qoftë se dispozita është shfuqizuar gjatë zhvillimit të procedurës, kurse nuk janë zhdukur pasojat e zbatimit të saj, Gjykata Kushtetuese me vendimin e vet konstaton nëse kjo dispozitë në kohën e vlefshmërisë së saj ka qenë në përputhje me Kushtetutën, respektivisht me ligjin.

Gjykata Kushtetuese ndjek realizimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë dhe e informon Kuvendin për dukuritë e vërejtura antikushtetuese dhe antiligjore.

Ngritja e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë

Neni 150

Çdokush mund të paraqesë iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë.

Procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë para Gjykatës Kushtetuese mund ta ngrejë gjykata, organi tjetër shtetëror, organi i vetëqeverisjes lokale dhe pesë deputetë.

Gjykata Kushtetuese edhe ajo vetë mund të ngre procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë.

Gjatë zhvillimit të procesit, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që të pezullohet zbatimi i aktit apo veprimit të veçantë që janë ndërmarrë në bazë të ligjit, të dispozitës tjetër apo të aktit të përgjithshëm, kushtetutshmëria apo ligjshmëria e të cilëve vlerësohet, në qoftë se me zbatimin e tyre do të mund të lindnin pasoja të dëmshme të paevitueshme.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

Neni 151

Gjykata Kushtetuese vendos me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese publikohet.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm dhe i ekzekutueshëm.

Qeveria, në rast nevoje, siguron ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Shfuqizimi i dispozitave

Neni 152

Kur Gjykata Kushtetuese konstaton se ligji është në mospërputhje me Kushtetutën dhe me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara, apo se dispozita tjetër është në mospërputhje me Kushtetutën dhe me ligjin, ky ligj dhe dispozita tjetër shfuqizohen ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Ligji apo akti tjetër, respektivisht dispozitat e tyre të veçanta për të cilat me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është konstatuar se nuk janë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin, nuk mund të zbatohen për raportet që janë krijuar para publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në qoftë se deri me atë ditë nuk janë zgjidhur në formë të prerë.

Përbërja dhe zgjedhja Neni 153

Gjykata Kushtetuese ka shtatë gjyqtarë.

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese zgjedhet me mandat prej nëntë vitesh.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjedhet nga radhët e gjyqtarëve, me mandat prej tri vitesh.

Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjedhet personi që gëzon autoritet të ekspertit juridik të spikatur, që ka të paktën 15 vite përvojë punë në profesion.

Kryetari dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ushtrorjnë funksionin e deputetit dhe funksionin tjetër publik, as të ushtrorjnë në mënyrë profesionale ndonjë veprimtari tjetër.

Pushimi i funksionit Neni 154

Kryetarit dhe gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon funksioni edhe para skadimit të periudhës për të cilën është zgjedhur, nëse vetë kërkon një gjë të tillë, kur i plotëson kushtet për pension pleqërie apo në qoftë se është gjykuar me dënim me burg pa kusht.

Kryetari dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese shkarkohet nga detyra në qoftë se është dënuar për vepër penale që e bën të padenjë për të ushtruar profesionin, apo në qoftë se humbë përgjithmonë aftësinë për ushtrimin e funksionit, në qoftë se shfaq publikisht bindjet e veta politike.

Paraqitjen e shkaqeve për pushimin e funksionit apo për shkarkim e përcakton Gjykata Kushtetuese në seancë gjyqësore dhe e njofton Kuvendin lidhur me këtë.

Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që kryetari, respektivisht gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese kundër të cilit është ngritur proces penal, të mos e ushtrorjë detyrën derisa të zgjasë ky proces.

PJESA E SHTATË

NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Propozimi për ndryshimin e Kushtetutës Neni 155

Propozimin për ndryshimin e Kushtetutës mund ta paraqesë Presidenti i Malit të Zi, Qeveria apo të paktën 25 deputetë.

Me propozimin për ndryshimin e Kushtetutës mund të propozohet ndryshimi apo plotësimi i dispozitave të veçanta të Kushtetutës apo miratimi i Kushtetutës së re.

Propozimi për ndryshimin e dispozitave të veçanta të Kushtetutës duhet të përmbajë shënimin e dispozitave që kërkohet të ndryshohen dhe arsyetimin.

Propozimi për ndryshimin e Kushtetutës miratohet në Kuvend, nëse në favor të tij votojnë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Në qoftë se propozimi për ndryshimin e Kushtetutës nuk është miratuar, i njëjti propozim nuk mund të përsëritet para se të ketë kaluar një vit nga data e refuzimit të propozimit.

Akti për ndryshimin e Kushtetutës

Neni 156

Ndryshimi i dispozitave të caktuara të Kushtetutës bëhet me amendamente.

Projektakti për ndryshimin e Kushtetutës përpilohet nga forumi kompetent i punës i Kuvendit.

Projektakti për ndryshimin e Kushtetutës quhet i miratuar në Kuvend, nëse për të votojnë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Projektaktin e miratuar për ndryshimin e Kushtetutës Kuvendi e hedh në diskutim publik, i cili nuk mund të zgjasë më pak se një muaj.

Pas përfundimit të diskutimit publik, forumi kompetent i punës i Kuvendit përcakton propozimin e aktit për ndryshimin e Kushtetutës.

Akti për ndryshimin e Kushtetutës quhet i miratuar në Kuvend, në qoftë se për të votojnë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Ndryshimi i Kushtetutës nuk mund të bëhet gjatë kohës së gjendjes së luftës dhe të gjendjes së jashtëzakonshme.

Konfirmimi në referendum

Neni 157

Ndryshimi i neneve 1, 2, 3, 4, 12, 13, 15, 45 dhe 157 të Kushtetutës është definitiv, në qoftë se në referendumin shtetëror për ndryshim deklarohen të paktën tri të pestat e të gjithë zgjedhësve.

PJESA E TETË

DISPOZITA KALIMTARE DHE E FUNDIT

Baza kushtetuese për zbatimin e Kushtetutës

Neni 158

Për zbatimin e Kushtetutës miratohet Ligji kushtetues.

Ligjin kushtetues për zbatimin e Kushtetutës e miraton Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve.

Ligji kushtetues shpallet dhe hyn në fuqi njëkohësisht me Kushtetutën.

SU-SK NR. 01-514/21
Podgoricë, 19 tetor 2007

KUVENDI KUSHTETUES I REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

KRYETARI
Ranko Krivokapiq, d.v.

Në mbështetje të nenit 15, paragrafit 1, të Ligjit mbi procedurën për mirtimin dhe shpalljen e Kushtetutës së re të Malit të Zi ("Gazeta zyrtare e RMZ, nr 66,06), Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në seancën e tretë të sesionit të dytë të rregullt në vitin 2007, më 22 tetor të vitit 2007, mori këtë

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E KUSHTETUTËS SË MALIT TË ZI

Shpallet KUSHTETUTA E MALIT TË ZI, të cilën e miratoi Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në seancën e tretë të sesionit të dytë të rregullt në vitin 2007, më 19 tetor të vitit 2007.

SU - SK Nr. 01 - 514/22
Podgoricë, më 22 tetor 2007-11-12

KUVENDI KUSHTETUES I REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

KRYETARI
Ranko Krivokapiq d.v.

LIGJI KUSHTETUES PËR ZBATIMIN E KUSHTETUTËS SË MALIT TË ZI

Neni 1

Kushtetuta e Malit të Zi (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), zbatohet ditën e shpalljes nga Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në qoftë se përkitazi me zbatimin e dispozitave të saj të veçanta me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Neni 2

Organet e pushtetit në Mal të Zi dhe organet e tjera shtetërore, organizatat, shërbimet dhe organet e vetëqeverisjes lokale vazhdojnë punën deri me skadimin e mandatit për të cilin janë zgjedhur, në suazat e të drejtave dhe të detyrave të përcaktuara me Kushtetutë, në qoftë se me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Neni 3

Prokurori i shtetit vazhdon punën si Prokurori e Shtetit, deri me nxjerrjen e ligjit me të cilin do të rregullohet pozita, struktura organizative dhe puna e Prokurorisë së Shtetit.

Neni 4

Këshilli i Mbrojtjes dhe Sigurisë do të konstituohet jo më vonë se brenda dhjetë ditëve nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 5

Dispozitat e traktateve ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, në të cilat Mali i Zi ka aderuar pas datës 3 qershor 2006, do të zbatohen ndaj raporteve juridike të krijuara pas nënshkrimit.

Neni 6

Ligjet dhe dispozitat e tjera mbeten në fuqi deri me harmonizimin e tyre me Kushtutën, brenda afateve të caktuara me këtë ligj.

Neni 7

Brenda dy muajve nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi, do të miratohen:
Ligji mbi shtetësinë malazeze;
Ligji mbi dokumentet e udhëtimit të shtetasve të Malit të Zi;
Ligji mbi vendbanimin dhe vendqendrimin e qytetarëve;
Ligji mbi letërnjoftimin;

Ligji mbi Këshillin Social;
Brenda afatit prej gjashtë muajve nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi do të miratohen:
Ligji mbi Këshillin Gjyqësor dhe
Ligji mbi organizimin territorial të Malit të Zi.

Neni 8

Brenda tre muajve nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi, do të harmonizohen me Kushtetutën:

Ligji mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve
Ligji mbi zgjedhjen e presidentit të Malit të Zi
Ligji mbi regjistrat e zgjedhësve;
Ligji mbi gjykatat;
Ligji mbi prokurorin e shtetit;
Ligji mbi administratën shtetërore;
Ligji mbi pasurinë e Republikës së Malit të Zi;
Ligji mbi shpronësimin;
Ligji mbi të drejtat dhe liritë e pakicave.

Neni 9

Ligjet dhe dispozitat e tjera do të harmonizohen me Kushtetutën jo më vonë se brenda dy viteve nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi, kurse aktet juridike për zbatimin e ligjeve, brenda afateve të përcaktuara me këto ligje.

Neni 10

Kuvendet e njësisve të vetëqeverisjes lokale do t'i harmonizojnë dispozitat e veta me Kushtetutën jo më vonë se brenda një viti nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 11

Deri me nxjerrjen e akteve juridike përkatëse të Malit të Zi do të zbatohen në mënyrë analoge dispozitat e Bashkësisë shtetërore Serbia dhe Mali i Zi, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me rendin juridik dhe me interesat e Malit të Zi.

Neni 12

Secili qytetar i Malit të Zi, i cili krahas shtetësisë malazeze më datë 3 qershor 2006 ka pasur edhe shtetësi të ndonjë shtetit tjetër, ka të drejtë ta mbajë edhe shtetësinë malazeze.

Shtetasi i Malit të Zi i cili pas datës 3 qershor 2006 ka fituar ndonjë shtetësi tjetër, mund ta mbajë edhe shtetësinë malazeze deri me nënshkrimin e marrëveshjes dypalëshe me vendin, shtetësinë e të cilit e ka fituar, por për një kohë jo më të gjatë se një vit nga data e miratimit të Kushtetutës së Malit të Zi.

Neni 13

Ditën e shpalljes së Kushtetutës dhe të këtij ligji, Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi vazhdon punën si Kuvend i Malit të Zi, kurse Këshilli Kushtetues pushohet nga puna.

Neni 14

Zgjedhjet për deputetë në Kuvendin e Malit të Zi do të mbahen jo më vonë se deri në fund të vitit 2009.

Neni 15

Ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, emërtimi i gazetës zyrtare të Republikës së Malit të Zi ndryshohet dhe do të quhet: “Gazeta zyrtare e Malit të Zi”.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes.

SU-SK, Nr. -01523/7
Podgoricë, më 19 tetor 2007.

KUVENDI KUSHTETUES I REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

KRYETARI
Ranko Krivokapiq, d.v.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit mbi procedurën për miratimin dhe shpalljen e Kushtetutës së re të Malit të Zi (“Gazeta Zyrtare e RMZ” nr.66/06), Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në seancën e tretë të sesionit të dytë të rregullt në vitin 2007, më 22 tetor 2007, mori këtë

VENDIM
PËR SHPALLJEN E LIGJIT KUSHTETUES PËR ZBATIMIN E
KUSHTETUTËS SË MALIT TË ZI

Shpallet LIGJI KUSHTETUES PËR ZBATIMIN E KUSHTETËS SË MALIT TË ZI, të cilin e miratoi Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në seancën e tretë të sesionit të dytë të rregullt në vitin 2007, të mbajtur më 19 tetor 2007.

SU-SK Nr. 01-523/8
Podgoricë, më 22 tetor 2007

KUVENDI KUSHTETUES I REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI

KRYETARI
Ranko Krivokapiq, d.v.

Përktheu: Fran Gjokaj

Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, tekstin e plotë të së cilës po e botojmë në faqet që vijojnë. Mbas këtij akti historik, Asambleja ftoi të gjitha shtetet anëtare që ta shpallin tekstin e Deklaratës dhe të përpiqen që të përhapet, paraqitet, lexohet dhe të shpjegohet, sidomos në shkolla dhe institucione të tjera edukuese, në të gjitha vendet dhe shtetet pa marrë parasysh statusin e tyre politik.

Teksti zyrtar i Deklaratës mund të gjindet në gjashtë gjuhë zyrtare të Kombeve të Bashkuara: angleze, frënge, kineze, ruse, spanjolle dhe arabe.

DEKLARATA E PERGJITHSHME MBI TE DREJTAT E NJERIUT

HYRJE

Mbasi njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë;

mbasi mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut ka çuar drejt akteve barbare, të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit, dhe mbasi krijimi i botës në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, të besimit dhe lirinë nga frika e skamja është proklamuar si dëshira më e lartë e çdo njeriu;

mbasi është e nevojshme që të drejtat e njeriut të mbrohen me dispozita juridike, kështu që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit t'i përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes;

mbasi është e nevojshme që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve;

mbasi popujt e Kombeve të Bashkuara vërtetuan përsëri në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personit të njeriut dhe barazinë midis burrave dhe grave dhe mbasi vendosën që të nxitin përparimin shoqëror dhe të përmirësojnë nivelin e jetës në liri të plotë;

mbasi shtetet anëtare u detyruan që, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, të sigurojnë respektimin e përgjithshëm dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;

mbasi kuptimi i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive është më i rëndësishëm për realizimin e plotë të këtij detyrimi;

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME shpall Këtë DEKLARATE TE PERGJITHSHME MBI TE DREJTAT E NJERIUT si ideal të përgjithshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm shoqëror, duke pasur parasysh gjithmonë këtë Deklaratë, të përpiqet që, me anë të mësimin dhe edukimit, të ndihmonte në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe që, me anë të masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare, të sigurohej njohja dhe zbatimi i tyre i përgjithshëm dhe i vërtetë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare , ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që janë nën administrimin e tyre.

Neni 1.

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.

Neni 2.

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjindet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.

Neni 3.

Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.

Neni 4.

Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose çifçi; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

Neni 5.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet mundimit, veprimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtërues.

Neni 6.

Gjithkush ka të drejtë që t'i njihet kudo personaliteti juridik.

Neni 7.

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

Neni 8.

Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.

Neni 9.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose internimit.

Neni 10.

Gjithkush gëzon njëllë të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

Neni 11.

1. Kushdo që është i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet.

2. Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë një veprë penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset një dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale.

Neni 12.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

Neni 13.

1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti.

2. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

Neni 14.

1. Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet.

2. Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 15.

1. Gjithkush ka të drejtën e një shtetësie.

2. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij si dhe as nga e drejta që të ndërrojë shtetësinë.

Neni 16.

1. Burrat dhe gratë në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurrorëzimi.

2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen.

3. Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Neni 17.

1. Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët.

2. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

Neni 18.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

Neni 19.

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

Neni 20.

1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.
2. Asnjëri nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.

Neni 21.

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.
3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Neni 22.

Si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

Neni 23.

1. Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.
2. Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë.
3. Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.
4. Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë and të bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta.

Neni 24.

Gjithkush ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës dhe pushimin e paguar periodik.

Neni 25.

1. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

2. Nënata dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martesë, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.

Neni 26.

1. Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet e arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë.

2. Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

3. Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në rradhë të parë prindërit.

Neni 27.

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobisë të tij.

2. Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.

Neni 28.

Gjithkush ka të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë.

Neni 29.

1. Gjithkush ka detyrime vetëm ndaj asaj bashkësie në të cilën është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

2. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, gjithkush do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve e që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.

3. (3)Këto të drejta dhe liri nuk mund të zbatohen në asnjë rast kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.

Neni 30.

Asgjë në këtë Deklaratë nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për të kryer çfarëdo veprimtarie ose për të bërë një akt drejtuar kundër çdo të drejte ose lirie të shpallur në këtë Deklaratë.